

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE

NUMËR 370 • VITI 35 • SHTATOR 2021 • MUHARREM - SAFER 1443 • ÇMIMI 1 €



Bashkësia Islame e Kosovës
Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame



KONFERENCË SHKENCORE



Shkencëtarët Kombëtarë
Amriqë
Shteteve të Bashkuara
u dedikohet.

NJË SHEKULL NGA BOTIMI I PËRKTHIMIT TË KURANIT PREJ I. M. QAFËZESIT

Prishtinë, 21 shtator 2021




“Betohem në Atë, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, se asnjëherë nuk i është dhënë besimtarit mirësi më e madhe sesa mendimi i mirë për Allahun e Madhëruar. Betohem në Atë, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, se sa herë që njeriu mendon mirë për Allahun e Madhëruar, Allahu ia jep njeriut atë që dëshiron, sepse në dorën e Tij është e tërë mirësia.”

Ibën Mesudi r.a.

Në këtë numër:

Editorial	4
Fjala e Myftiut Tërnavë në Konferencë	5
Fjala e drejtorit të IHSl-së, z. Bajgora në Konferencë	7
Sabri Bajgora Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (5)	9
Dr. Ajni Sinani Muhamedi a.s. i besueshëm dhe besnik	12
Muhamed B. Sytari Ai ka bezdi nga ezani, unë lutem për të!	14
Hfz. Mehas Alija Sihariqe hyjnore për durimtarët	16
Argjent Xheladini Liria e fesë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (1)	17
Mr. Driton Arifi Vakëfet, këto thesare të çmueshme të civilizimit islam	20
Prof.ass.dr. Rexhep Suma Kategoritë e të ftuarve në komunikimin e daves	23
Gary Miller Kurani i mrekullueshëm (3)	28
Nexhmi Hoxha Madhështia e durimit në Kuranin fisnik (2)	32
Ibrahim Iljazi Junusi a.s., simbol i dënimit dhe i faljes hyjnore	36
Bajram Zeqiri Dituria, stoli e besimtarit	38
Prof. dr. Xhenana Efendiq - Semiz¹ Reforma dhe kolonizimi agrar serb në vitin 1918	42
Agron M. Rexhepi, MD, PhD Morfologjia e kokës (2)	46
Amire Prebreza – Sopjani Shtatori i dytë	48
Dita Botërore e Farmacistëve - 25 shtator	49
Elez Osmani Në vend të lamtumirës!	51
Aktivitete	53

**DITURIA ISLAME**

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Mendimi i mirë për Allahun xh.sh.



“Askush prej jush mos të vdesë ndryshe vetëm se duke pasur mendim të mirë për Allahun, sepse me të vërtetë mendimi i mirë për Allahun është çmimi i Xhenetit.”

(Hadith)

Në jetën tonë, kohë pas kohe na godasin sprova të ndryshme: fatkeqësi, vdekje, humbje të pasurisë, sëmundje të ndryshme etj. Në situata të tilla duhet të kemi mendim të mirë për Allahun xh.sh. Mendimi i mirë është shenjë e kënaqësisë sonë me caktimin e Tij. Kjo e qetëson shpirtin, e lehtëson dhimbjen dhe e shton sabrin.

Nga adhurimet e mëdha të zemrës është edhe mendimi i mirë për Allahun, që është edhe nga gjendjet dhe shkallët më të larta të fesë. Xhabiri r.a. ka thënë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, tri ditë para se të ndërronte jetë, duke thënë: “Askush prej jush të mos vdesë, vetëm se duke pasur mendim të mirë për Allahun.” (Muslimi 2877, Ebu Davudi 3113).

Pejgamberi a.s. thotë: “Allahu ka thënë: “Unë jam ashtu siç më mendon robi Im. Ndaj, le të mendojë çfarë të dojë.” (Buhariu dhe Muslimi). Gjithashtu Ebu Hurejre r.a. tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Allahu i Lartësuar thotë: “Unë jam ashtu si mendon robi Im për Mua, pra le të mendojë për Mua si të dojë. Nëse mendon mirë, do jetë në dobi të tij, por nëse mendon keq, do jetë në dëm të tij.” (transmeton Ahmed)

Allahu tregon se disa njerëz u shkatërruan për shkak të mendimit të tyre të keq për Allahun e Madhëruar: “Mendimi juaj i gabuar, të cilin e patët ndaj Zotit tuaj është ai që ju shkatërroi dhe tani jeni më të dëshpëruarit.” (Fussilet, 23)

Prandaj, prej mëkateve të mëdha është edhe mendimi i keq për Zotin, mëkat për të cilin në Kuran është përmendur një dënim që nuk është përmendur për mëkatet e tjera. Allahu i Madhëruar thotë: “Gjithashtu, (Ai e bëri këtë) për t'i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtare, që mendojnë keq për Allahun. Radha e fatkeqësisë do t'i godasë ata! Allahu është zemëruar me ta, i ka mallkuar dhe u ka përgatitur Xhebenemin; sa vend i keq që është ai.” (El-Fet'h, 6).

Enesi r.a. tregon se Pejgamberi a.s. kishte hyrë te një djalë i ri që ishte në prag të vdekjes dhe e kishte pyetur: “-Si ndihesh? -Shpresoj në Allahun dhe kam frikë nga mëkatet e mia – i përgjigjet djaloshi.” Atëherë Pejgamberi a.s. tha: “Këto dy gjëra nuk bashkohen në zemrën e robit dhe, në një situatë të këtillë, Allahu si të mos ia japë atë që shpreson dhe ta mbrojë nga ajo që frikësohet.” (Ahmedi, Ibën Maxheh dhe Tirmidhiu, 983).

Ibën Mubareku ka shënuar fjalët e Ibën Abbasit r.a. ku thotë: “Kur ta shihni ndonjë person që është në prag të vdekjes, përgëzojeni, në mënyrë që ta takojë Zotin e tij duke pasur mendim të mirë për Allahun, e nëse është akoma i vetëdijshëm, këshillojeni ta ketë frikë Allahun e Lartësuar.”

Ibën Ebi Dunja ka transmetuar nga Ibrahim Nehaiu se ky ka thënë: “E kanë konsideruar punë të pëlqyeshme që njeriut në momentin e vdekjes t'i përmenden veprat e tij të mira, në mënyrë që të ketë mendim të mirë për Zotin e tij.” Enesi r.a. tregon se Muhamedi s.a.u.s. ka thënë: “Askush prej jush mos të vdesë ndryshe vetëm se duke pasur mendim të mirë për Allahun, sepse me të vërtetë mendimi i mirë për Allahun është çmimi i Xhenetit.” (Ibën Asakir). Ibën Mesudi r.a. se ka thënë: “Pasha Allahun, i Cili është Një dhe nuk ka tjetër, askush nuk do të ketë mendim të mirë për Allahun e që Allahu të mos ia japë atë që mendon.” (Ibën Ebi Shejbeh). Allahu nuk e zhgënjën askënd që mendon mirë për Të, nuk ia humb shpresën askujt që iu mbështet Atij dhe nuk ia humb askujt veprën e mirë: “...s'ka dyshim Allahu nuk e humb shpërblimin e punëmirëve.” (Jusuf, 90)

Mendimi i mirë për Allahun është rrjedhojë e njohjes dhe e diturisë për Allahun dhe për emrat dhe cilësitë e Tij të përsosura, e bindjes se mëshira e Allahut ka përfshirë gjithçka dhe se Allahu është Mëshirëplotë e Bujar që e pranon pendimin dhe i fal mëkatet.

Mendimi i mirë për Allahun është nga begatitë më të mëdha që njeriut i dhurohen nga Zoti i tij. Ibën Mesudi r.a. ka thënë: “Betohem në Atë, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, se asnjëherë nuk i është dhënë besimtarit mirësi më e madhe sesa mendimi i mirë për Allahun e Madhëruar. Betohem në Atë, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, se sa herë që njeriu mendon mirë për Allahun e Madhëruar, Allahu ia jep njeriut atë që dëshiron, sepse në dorën e Tij është e tërë mirësia.”

Mendimi i mirë për Allahun nuk shoqërohet me neglizhencë dhe pasimin e epsheve, por me devotshmëri dhe largim nga mëkatet, sepse ato janë pengesë ndërmjet njeriut dhe mendimit të mirë për Zotin. Hasan El-Basri thotë: “Besimtari kur mendon mirë për Zotin e tij e përmirëson edhe veprën, ndërsa mëkatari ka menduar keq për Zotin, prandaj edhe ka vepruar keq.”

Muadh ibën Xhebeli r.a. tregon se i Dërguari i Allahut s.a.u.s., një ditë, u kishte thënë sahabëve: “A dëshironi t'ju tregoj se cila do të jetë gjëja e parë që do t'ju thotë Allahu xh.sh. besimtarëve Ditën e Kiametit? - Po, o i Dërguar i Allahut – u përgjigjëm ne. I Dërguari i Allahut tha: “Në Ditën e Gjykimimit, Allahu i Lartësuar u thotë besimtarëve: “A e dëshiruat takimin me Mua? Ata thonë: – Po, o Zoti ynë. – Përse? – i pyet Allahu. – Kemi shpresuar në mëshirën dhe faljen Tënde, – përgjigjen ata. Atëherë Allahu u thotë: “Falja Ime është bërë obligim për ju.” (Abdullah ibën Mubareku, Taberaniu dhe Ahmedi, 5/238)

Dr. Ajni Sinani

Fjala përshëndetëse e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Ternava, në hapjen e Konferencës Shkencore “Një shekull nga botimi i përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi”

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka qenë, është dhe do të mbetet paluhatshëm në shërbim të Kuranit dhe vlerave të tij

I nderuari kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu

I nderuari reis i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, Hfz. Shaqir ef. Fetahi

I nderuari kryetar i Kuvendit të BI-së së Kosovës, Ajni ef. Sinani

I nderuari drejtor i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, z. Sabri Bajgora,

Ju përfaqësues të institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës, bashkëpunëtorë të mi, pedagogë, e posaçërisht ju studiues që sot jeni këtu me kontribute,

Të nderuar të pranishëm!

Fillimisht më lejoni t'ju përshëndes e t'ju falënderoj në emrin e Bashkësisë Islame të Kosovës, institucioneve të saja dhe në emrin tim personal për kohën që keni ndarë që të jeni sot me ne në këtë aktivitet që i kushtohet një përvjetori të rëndësishëm për kulturën dhe historinë tonë.

Zoti në Kuranin fisnik na urdhëron duke na thënë:

وَقُلْ اَعْمَلُوا فَسَيَرَى اللّٰهُ عَمَلَكُمْ وَرَسُولُهُ
وَالْمُؤْمِنُونَ

“Punoni, se vërtet punën tuaj do ta shoh Allahu, Pejgamberi dhe besimtarët” (Et Tevbeh, 105), prandaj më lejoni që me këtë rast të përgëzoj e falënderoj Institutin për Hulumtime e Studime Islame (IHSI) në krye me drejtorin, z. Sabri Bajgora që kanë ndërmarr këtë hap për të shënuar 100 vjetorin e daljes në dritë të përkthimit të Kuranit nga rilindësi ynë i shquar, Ilo Mitkë Qafëzezi, në



formën më të mirë, duke organizuar Konferencë shkencore kushtuar kësaj veprë.

Siç dihet, këtu e një shekull më parë, falë punës e angazhimit të bashkatdhetarit tonë në mërgim, Ilo Mitkë Qafëzezi, më konkretisht në Ploeshi të Rumanisë, më 1921, e pa dritën e botimit edhe një pjesë e Kuranit e përkthyer në gjuhën shqipe, duke shënuar kështu hapin e parë për përkthimin e Kuranit në gjuhën tonë dhe kështu u dëshmuar konkretisht se populli ynë, gjuha jonë dhe qarqet tona intelektuale janë të zotët e të gatshëm që edhe vepra, siç janë Libri Hyjnor, Kurani t'i bëjnë pronë të kulturës tonë dhe t'ua mundësojnë njerëzve tanë që t'i kuptojnë ata dhe

të iluminohen me kuptimin dhe mësimet e tyre.

Përkthimi i Kuranit në cilindo gjuhë, në çdo kohë e në çdo rrethanë paraqet një akt të rëndësishëm së veçantë, aq më tepër kur kjo bëhet për herë të parë dhe aq më shumë kur dihet se Kurani është libër i shenjtë i myslimanëve, është themeli i fesës së tyre dhe burim i dinit islam e me ndikim të pakontestueshëm në jetën e tyre.

Populli ynë, ka shekuj të tërë që bashkëjeton me Kuranin, jeton e vepron me mësimet e mirësitë e tij, edukohet, ndërgjegjësohet e fisnikërohet me porosinë e këshillat e Kuranit të Madhëruar. Dhe jo vetëm kaq, por shqiptarët që herët u



përfshinë në dinamikën kuranore, duke dalë nga radhët e shqiptarëve personalitete të shquara që e kanë njohur, e kanë komentuar, e kanë studiuar e interpretuar Kuranin ndër shekuj.

Mirëpo, për shumë arsye, shqipërimi i Kuranit, krahasuar me popujt e tjerë, është relativisht i vonë. Është i vonë edhe për shkaqet dhe rrethanat e njohura të cilat e vonuan edhe botimin e literaturës së përgjithshme në gjuhën shqipe.

Botimi i përkthimit të Kuranit nga Ilo Mitkë Qafëzezi, sikurse e theksuam, vjen në duart e shqiptarëve në vitet e '20 të shekullit të kaluar, pothuajse një dekadë pas pavarësisë së shtetit shqiptar dhe në kohën kur konsolidohen, themelohen dhe fillojnë veprimtarinë e tyre institucionet kryesore shtetërore, arsimore, kulturore e fetare.

Vepra e Qafëzezit, megjithëse një vepër e rëndësishme e botuar dhe realizuar në një kohë delikate e plotë kthesa për popullin tonë; një vepër e realizuar nga një bashkëkombës i ynë ortodoks për vëllezërit e tij myslimanë, për çudi, as dje e as sot, nuk ka marrë vëmendjen e duhur të studiuesve dhe as vendin meritues në historinë e literaturës shqipe.

Edhe kur është përmendur, ç'është e drejta, është përmendur fare kalimthi, sa kohë që, një vepër e tillë, pavarësisht se në fushën e përkthimeve të Kuranit në gjuhën

shqipe tashmë është tejkaluar, ajo pa diskutim mbetet një ndër veprat më të rëndësishme për kohën kur është botuar dhe për qëllimin që ka mbartur si vazhdimësi e frymës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Prandaj, është detyrë e studiuesve tanë, që këtë vepër ta trajtojnë shkencërisht dhe me kompetencë.

Në këtë rrafsh, e vlerësoj dhe e quaj me vend, organizmin e kësaj Konference nga Instituti për Hulumtime e Studime Islame. Kjo Konferencë, jam i bindur, se do të (ri)sjell në vëmendje të studiuesve dhe të interesuarve veprën e Qafëzezit dhe do të shënojë një hap të parë, por domethënës, për trajtime të mëtejshme të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi.

Pa dashur që të zgjatëm më shumë, më lejoni që të them edhe këtë, se vepra e Ilo Mitkë Qafëzezit ka edhe një dimension tjetër, ajo në kohën kur u botua, provokoi debate, por mbi të gjitha përshpejtoi përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe nga teologët kompetentë myslimanë të kohës, siç ishin dijetarët dhe prijësit e shquar Hafiz Ali ef. Korça, Hfz. Ibrahim ef. Dalliu, Hfz. Vehbi ef. Dibra etj.

Të nderuar të pranishëm!

Të nderuar studiues!

Konferenca e sotme është aktiviteti i parë shkencor i organizuar nga Instituti për Hulumtime e Studime

Islame i cili është themeluar rishtazi, prandaj më lejoni që ta përgëzojë edhe një herë për këtë nismë, me shpresën se Instituti do të vazhdojë me organizime të tilla jo vetëm për të vlerësuar përkthimin e Qafëzezit por edhe të përkthyesve të tjerë të Kuranit në gjuhën shqipe dhe po ashtu edhe për ndriçimin e trashëgimisë dhe kulturës tonë shqiptare islame.

Bashkësia Islame e Kosovës do të mbështesë dhe përkrahë çdo iniciativë, projekt dhe aktivitet, jo vetëm në kuadër të institucioneve të saja, por edhe në bashkëpunim me bashkësitë tona simotra – në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi, sepse njohja e të kaluarës sonë të begatë, është obligim yni, ngase na garanton një të ardhme më të sigurt.

Në fund, dua të rikonfirmoj edhe një herë se Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka qenë, është dhe do të mbetet paluhatshëm në shërbim të Kuranit dhe vlerave të tij, sepse ajo punon me Kuran dhe aty mbështetet.

Duke ju dëshiruar sukses dhe punë të mbarë në këtë Konferencë, ju falënderoj dhe lus Allahun xh.sh. që t'ju shpërblejë dhe t'ju begatojë për kontributin tuaj!

Prishtinë, 21 shtator 2021 Myftiu i Kosovës

Naim ef. Tërnav

Fjala e drejtorit të IHSI-së, Sabri ef. Bajgora, në hapjen e Konferencës Shkencore “Një shekull nga botimi i përkthimit të Kuranit nga Ilo Mitkë Qafëzezi”

Popujt e qytetëruar kanë ecur përpara në saje të vëmendjes që kanë treguar për të kaluarën e tyre

*Të nderuar pjesëmarrës,
Të nderuar studiues,
Mysafirë dhe kolegë të dashur,
Zonja dhe zotërinj,*

Në veprimtarinë e secilit institucion ka data, ngjarje dhe personalitete të cilat e begatojnë dhe i japin kuptim edhe më të plotë atij institucioni. Një rëndësi të këtillë, në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, sigurisht që do ta ketë edhe Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, i cili, falë angazhimit të Kryesisë së BI të Kosovës, në krye me Myftiun Naim ef. Tërnavë, muaj më parë u themelua dhe nisi punën e tij.

Prandaj, më lejoni që sot para jush të shpreh gëzimin tim të madh për këtë vendim të rëndësishëm të Kryesisë së BIK, por edhe për faktin se në kuadër të këtij Instituti, sot, për herë të parë, po organizohet një aktivitet shkencor për një datë dhe për ngjarje po ashtu historike dhe të shënuar në historinë e literaturës islame në gjuhën shqipe, pra po mbahet Konferenca shkencore për të shënuar 100-Vjetorin e botimit të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi.

Në të vërtetë, shënimi i këtij përvjetori është po ashtu një gëzim në vetvete, sepse nuk do të mund të nisnim organizimin e një aktiviteti shkencor në kuadër të Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, më mirë se sa me një konferencë për Kuranin, e aq më tepër për përkthimin e tij në gjuhën shqipe.

Këtë aktivitet tonin, të parin në



kuadër të IHSI me praninë e tyre e kanë nderuar edhe tre prijësit e bashkësive tona islame, prandaj dhe më lejoni që t'i përshëndes dhe t'i falënderojë posaçërisht e veç e veç:

Myftiun e Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavën,

Kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, Bujar ef. Spahiun, dhe

Reisin e BFI-së të Maqedonisë së Veriut, hfz. Shaqir ef. Fetahun.

Po ashtu, në mënyrë të veçantë i përshëndes dhe ju shpreh mirënjohjen time të gjithë pjesëmarrësve me kumtesa që kanë ardhur nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut, pa të cilët ky aktivitet nuk do të mund të mbahej

dot.

Përshëndes po ashtu edhe Këshillin Drejtues të Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, që e miratoi propozimin tonë për shënimin e këtij përvjetori.

Dhe në veçanti ju përshëndes të gjithë juve që me pjesëmarrjen tuaj na keni begatuar dhe e keni bërë më madhështorë këtë aktivitet.

Të nderuar të pranishëm

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame ka për objekt veprimtarie të tij punën kërkimore-shkencore nga fushat e shkencave islame, si dhe nga kultura dhe trashëgimia islame te ne. Veprimtarinë e tij, Instituti do ta



zhvillojë duke studiuar dhe hulumtuar çështjet që kanë të bëjnë me islamologjinë dhe me kulturën tonë shpirtërore e materiale islame dhe duke i botuar e publikuar rezultatet e arritura shkencore.

Instituti do të bëjë edhe mbledhjen e materialeve arkivore dhe muzeore nga ekspeditat hulumtuese nga terreni dhe nga hulumtimet në arkiva dhe biblioteka dhe ato do të ruhen në Arkivin, përkatësisht në Bibliotekën dhe në Muzeun e Institutit.

Instituti po ashtu do të organizojë sesione, simpoziume, konferenca e tryeza në të cilat do të trajtohen çështje të ndryshme nga islamologjia dhe nga kultura jonë shpirtërore e materiale islame.

Veprimtarinë e vet, Institutit është paraparë që ta zhvillojë nëpërmes punës kërkimore-shkencore me bashkëpunëtorë të jashtëm, përmes projekteve të propozuara dhe të miratuara nga Instituti ku kemi për synim këto objektiva:

- Studimin, prezantimin dhe pasqyrimin e vlerave të fesë, kulturës e traditës islame te ne;

- Ruajtjen e vlerave të kulturës shpirtërore dhe materiale islame te ne;

- Hulumtimin, evidentimin, pasqyrimin dhe publikimin shkencor të këtyre vlerave;

- Vendosjen e urave lidhëse dhe njohjeve ndërmjet kulturave dhe vlerave të përbashkëta ndërmjet popullit shqiptar dhe popujve të tjerë të Ballkanit dhe me gjerë, si dhe ndërmjet shqiptarëve myslimanë me të tjerët;

- Bashkëpunimin e ngushtë me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, që për fokus të interesimit kanë ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore shqiptare dhe islame;

- Bashkëpunimin me institucionet dhe me individët që merren me punë të ngjashme brenda ose jashtë vendit tonë;

- Organizimin e punës në bibliotekën e vet të specializuar, duke mbledhur edhe materiale të tjera dokumentare;

- Organizimin e punës në arkivin shkencor, duke mbledhur, rregulluar, përpunuar dhe duke ruajtur lëndën arkivore të mbledhur në terren etj.

Të nderuar të pranishëm

Në kuadër të objektivave dhe punës së IHSI bënë pjesë edhe organizimi i Konferencës shkencore “Një shekull nga botimi i përkthimit të Kuranit nga Ilo Mitkë Qafëzezi”, që po i hap punimet e saj.

Ç’është e drejta, kjo Konferencë, do të synojë që ta trajtojë sa më gjithanshëm aspekte të ndryshme të përkthimit të Kuranit në gjuhën

shqipe të Kuranit nga Ilo Mitkë Qafëzezi. Gjithsesi 100 vjet të nismës dhe botimit të parë të Kuranit në gjuhën shqipe është një ngjarje që meriton të shënohet e të analizohet me qëllimin e përbashkët që të ofrohen përgjigje sa më të qëndrueshme lidhur me këtë nismë dhe me këtë botim të parë të Kuranit në gjuhën shqipe.

Popujt e qytetëruar kanë ecur përpara në saje të vëmendjes që kanë treguar për të kaluarën e tyre dhe mirënjohjes për kontributin e pararendësve të tyre.

Të nderuar pjesëmarrës,

Duke dashur që fjalën për çështjet që lidhen me përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi, t’ua lë studiuesve kompetentë pjesëmarrës në këtë Konferencë, më lejoni që edhe një herë t’ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe po ashtu t’ju ftojë të gjithëve që t’i dilni krahu punës dhe mbarëvajtjes shkencore të Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame.

Na qoftë një fillim i mbarë dhe një punë e hairit, frytet e së cilës, lusim Allahun xh.sh., që të jenë të bollshme dhe të përhershme.

Ju faleminderit!

Wes-selamu aljekum!

Sabri Bajgora

Drejtor i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (5)

Mirësjellja ndaj prindërve

وَوَصَّيْنَا الْإِنْسَانَ بِوَالِدَيْهِ إِحْسَانًا حَمَلَتْهُ أُمُّهُ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ كُرْهًا
وَحَمْلُهُ وَفِصَالُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا حَتَّىٰ إِذَا بَلَغَ أَشُدَّهُ وَبَلَغَ أَرْبَعِينَ
سَنَةً قَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَىٰ
وَالِدَيَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي إِنِّي تُبْتُ إِلَيْكَ
وَإِنِّي مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿15﴾ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ نَتَقَبَّلُ عَنْهُمْ أَحْسَنَ مَا
عَمِلُوا وَتَتَجَاوَزُ عَنْ سَيِّئَاتِهِمْ فِي أَصْحَابِ الْجَنَّةِ وَعَدَّ الصَّدَقِ الَّذِي
كَانُوا يُوعَدُونَ ﴿16﴾

“Njeriun e kemi urdhëruar-porositur të jetë i sjellshtëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqebet me gjë për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e pjekurisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: “O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti m’i ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! M’i bën të mirë pasardhësit e mi, unë te Ti pendohem dhe Ty të dorëzohem!”. Këta janë ata njerëz, të cilëve do t’ua pranojmë veprat e tyre më të mira e nuk do t’ua vëmë re veprat e tyre të këqija. Ata do të jenë banorë të Xhenetit; ky është premtimi i vërtetë, që u është premtuar” – (El-Ahkaf, 15-16).

Lidhja e këtyre ajeteve me ato paraprake

Ajetet paraprake, dëftuan se mëshirën e Allahut e meritojnë vetëm ata njerëz që e pranojnë Njëshmërinë e Tij, ashtu të pastër siç Ai ka urdhëruar e pastaj “qëndrojnë vendosmërisht në rrugën e drejtë”, ndërkohë që tash në ajetet vijuese, shohim shembullin e mirësjelljes kulmore të një fëmije të kujdesshëm ndaj prindërve të tij besimtarë, duke e falënderuar Allahun e gjithëmëshirshëm për nimetet dhe begatitë e mëdha ndaj tij në këtë botë.

Shkaku i zbritjes së ajetit 15

Në lidhje me zbritjen e një pjese të ajetit të 15 të kësaj sureje, Vahidiu transmeton nëpërmjet Merdevejhrit e ky nga Ibn Abasi se ky ajet ka zbritur për Ebu Bekrin r.a. Ibn Abasi thekson



se Ebu Bekri e kishte shoqëruar të Dërguarin e Allahut qysh në moshë të re. Kur kishin marrë rrugën për tregti në Sham, Ebu Bekri ishte 18 vjeç kurse e i Dërguari a.s. 20 vjeç. Gjatë rrugës për në Sham, ishin ndalur të pushonin nën hijen e një peme të Sidrit. I Dërguari a.s. kishte ndenjur nën hijen e pemës kurse Ebu Bekri kishte shkuar deri tek faltorja

që gjendej afër për t’ia drejtuar murgut disa pyetje rreth fesë. Murgu e kishte pyetur Ebu Bekrin se kush ishte ai njeri që po qëndronte nën hijen e asaj peme, ndërsa Ebu Bekri ishte përgjigjur se ai ishte Muhamedi i biri i Abdullahut të Abdulmatalibit, prijësit të kurejshëve. Atëherë murgu i kishte thënë: “Betohem se ky është i dërguar i Allahut, sepse pas Isait të

Arsyeja e veçimit të nënës, duke përmendur mundimet e saj e cila me mundime e vështirësi na bart për nëntë muaj në barkun e saj, e pastaj edhe na lind me vështirësi, është për të na vetëdijesuar se sa jemi borxhli ndaj saj, gjatë jetës sonë.

birrit të Merjemes, askush nuk ka kërkuar freskim nën hijen e asaj peme, pos një të ngjashmi me të. Ky pra qenka Muhamedi, i Dërguari i Allahut”. Prej atij momenti, në zemrën e Ebu Bekrit u shtua besimi dhe bindja në të Dërguarin a.s., dhe nuk iu nda më për asnjë çast. Kur Muhamedit i erdhi shpallja në moshën 40 vjeçe, Ebu Bekri kishte 38 vjet, dhe menjëherë e përqafoi Islamin, e kur Ebu Bekri arriti moshën 40 vjeçe, tha fjalët të cilat i përjetësoi ky ajet: “dhe, kur arrin në moshën e pjekurisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: “O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti m’i ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur!”¹

Koment:

15. Njeriun e kemi urdhëruar-porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gjë për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e pjekurisë e i mbush dyzet

vjet, ai thotë: “O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti m’i ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! M’i bën të mirë pasardhësit e mi, unë te Ti pendohem dhe Ty të dorëzohem!”

Mirësjellja ndaj prindërve, është një prej porosive më madhore në Kuranin famëlartë dhe prej veprave më fisnike të cilat mund t’i bëjë njeriu, ndërkohë që mospërfillja dhe moskujdesi ndaj prindërve, apo fyerja dhe maltretimi i tyre përbën njërin prej mëkateve më të mëdha. Në lidhje me mirësjelljen dhe kujdesin ndaj prindërve, na porosisin shumë ajete kuranore po edhe hadithe të Pejgamberit a.s.. I Madhërishti në ajetin 23 të sures El-Isra’ë thotë: “Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuronit tjetër përveç Atij dhe të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve...”, duke e sjellë kështu pas urdhrin për besimin në Zotin Një, urdhëresën tjetër për bamirësi dhe kujdes ndaj prindërve. Nëpërmjet këtij ajeti dhe shumë të ngjashmëve në Kuran, Allahu i Plotfuqishëm na jep shenjë se respekti ndaj prindërve duhet të jetë i përhershëm, sepse ata ishin shkaktarë të ardhjes sonë në këtë botë, andaj kur ata t’i arrijë pleqëria, ne ndaj tyre duhet të sillemi butësisht e me dhembshuri, duke treguar ngrohtësi e dashuri ndaj tyre, ashtu siç ata u kujdesën për ne, kur ishim të vegjël.

Arsyeja e veçimit të nënës, duke përmendur mundimet e saj e cila me mundime e vështirësi na bart për nëntë muaj në barkun e saj, e pastaj edhe na lind me vështirësi, është për të na vetëdijesuar se sa jemi borxhli ndaj saj, gjatë jetës sonë. Mbase kjo është edhe arsyeja, pse i Dërguari a.s. na porosit të jemi të kujdesshëm e të sjellshëm ndaj nënës, kur një beduin e pati pyetur: “O i Dërguar i Allahut: Cili njeri është më meritori për shoqërimin tim? I Dërguari a.s. i tha: “Nëna jote!” - Po pastaj? - pyeti ai. I tha: “Nëna jote!” - Po pastaj? I tha: “Nëna jote!” - Po

pastaj? - pyeti ai sërish dhe i Dërguari a.s. tha: “Babai yt!”²

Jeta e njeriut ndahet në disa etapa: Etapa e foshnjërisë, e fëmijërisë, e rinisë, e pjekurisë dhe e pleqërisë. Ashtu siç na e ka përshkruar Allahu xh.sh. në këtë ajet, moshë 40 vjeçare është moshë kur arrihet pjekuria kulmore e të menduarit dhe të logjikuarit. Kjo ishte moshë kur Pejgamberit a.s. i zbriti shpallja për herë të parë, e ashtu siç e pamë edhe nga shkak i zbritjes, të cilin e ka përmendur vetëm Vahidiu, Ebu Bekri ishte ai që kur e arriti këtë moshë e falënderoi Allahun për nimetet e dhe begatitë e Tij.

Sipas Hasan el Basriut, kuptimi i këtij ajeti është i përgjithshëm,³ e që duket të jetë mendimi më i saktë, sepse secili prej nesh, duhet ta falënderojë Allahun për begatitë e Tij ndaj nesh dhe ndaj prindërve tanë më parë, e pastaj edhe ta lusë që të na dhurojë pasardhës të denjë e të mirë, duke qenë plotësisht të dorëzuar para Teje me bindje, si myslimanë të vërtetë.

Respektimi i prindërve hyn në sferën e veprimeve më të larta e më fisnike në jetën tonë, dhe këtij veprimi Islami si fe, i ka dhënë një pozitë tejet të lartë. Mirësjellja jonë ndaj prindërve është moral me të cilin mburremi, sepse në një mënyrë reflekton humanizmin e kësaj feje dhe përkushtimin e saj për familjen dhe mbajtjen e lidhjeve familjare në përgjithësi. Prindi në Islam ashtu siç theksuam më parë është shkaktar i ardhjes së njeriut në këtë jetë. Atij i takon një respekt i përhershëm. Respekti për të duhet të shoqërohet edhe me dashuri dhe sakrificë. Pra, jo vetëm t’i respektosh në kuptim të përmbushjes së nevojave të tyre materiale, por edhe të shfaqësh anën emocionale duke i dashur, duke iu thënë fjalë të mira, duke u kujdesur për ata, mu ashtu siç ata janë përkujdesur për ne kur ishim të vegjël.

Pas sqarimit se si duhet të jetë mirësjellja jonë ndaj prindërve, dhe nënshtrimi ndaj Allahut, në ajetin

vijues. Allahu sqaron shpërblimin e këtyre njerëzve mirënjohës dhe të nënshtruar ndaj Allahut kur thotë:

16. Këta janë ata njerëz, të cilëve do t'ua pranojmë veprat e tyre më të mira e nuk do t'ua vëmë re veprat e tyre të këqija. Ata do të jenë banorë të Xhenetit; ky është premtimi i vërtetë, që u është premtuar”

Shpërblimi më i madh tek Allahu për këtë njerëz që i binden Allahut me besim të plotë, duke qenë njëkohësisht të sjellshëm e bamirës edhe ndaj prindërve të tyre, do të jetë Xheneti, sepse veprat e tyre të mira do të jenë të pranuar e të vlerësuara. I Lartmadhërishtëmi, këtyre njerëzve, do t'ua fshijë ndonjë vepër të keqe që eventualisht mund ta kenë pasur, për hir të besimit dhe mirësjelljes së tyre ndaj prindërve. Të tillët do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të shijojnë kënaqësitë e përgatitura për ta, ashtu siç ju është premtuar.

Porosia e ajeteve (15-16)

- Allahu i Madhërishtëmi e ka bërë mirësjelljen dhe respektimin e prindërve si një prej obligimeve parësore në Islam. Madje respekti ndaj tyre, në disa ajete kuranore, ka

**Allahu i
Madhërishtëmi e ka
bërë mirësjelljen
dhe respektimin e
prindërve si një
prej obligimeve
parësore në Islam.
Madje respekti
ndaj tyre, në disa
ajete kuranore, ka
ardhur edhe si
detyrim i
domosdoshëm
menjëherë pas
besimit në
Allahun fuqiplotë.**

ardhur edhe si detyrim i domosdoshëm menjëherë pas besimit në Allahun fuqiplotë. Hidhërimi i tyre nënkupton se mbi vete kemi tërhequr hidhërimin e Allahut, kurse me respektin ndaj tyre, e arrijmë kënaqësinë e Allahut.

- Ndaj nënës duhet të kemi kujdes të veçantë, sepse ajo na ka mbartur në kohën e shtatzënisë për nëntë muaj në barkun e saj, pastaj na ka ushqyer me gjirin e saj, duke e lodhur e sflitur veten, vetëm që të na rrisë e edukojë.

- Njeriu që e arrin moshën 40 vjeçe, ka arritur kulmin e pjekurisë së tij fizike dhe mendore. Pikërisht për këtë arsye duhet ta falënderojë Allahun për mirësitë e dhuruara, dhe t'i lutet atij për prindërit e tij, e njëkohësisht edhe t'i bëjë pasardhësit e tij të denjë dhe të devotshëm.

- Njeriu sado që të përpiqet, është vështirë ta falënderojë Allahun ashtu siç Ai e meriton, për shkak të mirësisë së Tij të pakufishme ndaj nesh.

- Besimtari i vërtetë, zemra e të cilit pulson vetëm për dashurinë ndaj Krijuesit, duhet të ndjekë rrugën e njerëzve të devotshëm, duke u penduar tek Allahu e pastaj duke e lutur atë duke kërkuar istigfar, sepse me këtë arrihet kënaqësia e Allahut në këtë dhe në botën tjetër.

- Xheneti, është vendshpërblim për të devotshmit dhe besimtarët e sinqertë. *(vijon)*

1. Imam Vahidij en-Nisaburi, Esbabu-n-nuzul, ff. 605-606 (Redaktuar nga Argijaniu). 2. Buhariu (2/8) nr. 5971; Muslimi (4/1974) nr. 2548. 3. Tefsiru-l Munir, vëll. 26, f. 348



Dr. Ajni Sinani

Muhamedi a.s. i besueshëm dhe besnik

Morali, sinqeriteti, thjeshtësia, modestia, vendosmëria, burrëria, guximi, bujaria, falja dhe trajtimi i krijesave me dhembshuri, mëshirë, drejtësi e ndershmëri, janë cilësitë me të cilat është shquar Muhamedi a.s. që nga fillimi.

Muhamedi a.s. që s'kishte gënhyer kurrë për njerëzit dhe për çështjet e kësaj bote, si do të gënjente për Zotin?!

Si do të gënjente kur ai kishte thënë: "Mos iu shmangni drejtësisë dhe ndershmërisë, sepse ato të çojnë në të mirë, dhe e mira dhe mbarësia të çojnë në xhenet. Për aq sa njeriu ta thotë të drejtën dhe ta kërkojë të drejtën, ai shkruhet në grupin e besnikëve tek Allahu. Kurrë mos gënje! Sepse gënjeshtër të çon në të keqe dhe e keqja të shtyn në xhehenem. Për aq sa njeriu vazhdon të gënjejë, ai më në fund do të shkruhet në defterin e gënjeshtarëve tek Allahu."¹

Morali, sinqeriteti, thjeshtësia, modestia, vendosmëria, burrëria, guximi, bujaria, falja dhe trajtimi i krijesave me dhembshuri, mëshirë, drejtësi e ndershmëri, janë cilësitë me të cilat është shquar Muhamedi a.s. që nga fillimi. Këto cilësi të tij janë pohuar dhe pranuar edhe nga të gjithë banorët e Mekës, para pranimit të shpalljes dhe pas pranimit të shpalljes. Prandaj ata e quanin Muhamed el-Emin, Muhamedi i besueshëm.²

Ibni Abasit tregon: Kur Zoti e urdhëroi Pejgamberin a.s. t'i thërrasë në rrugën e drejtë fisin e tij të afërt, Pejgamberi u ngjiti në bregun Safa dhe i thirri me emër fiset e kurejshëve. Kush mundi, shkoi ta dëgjojë atë kumtesë, e dikush dërgoi dikë për të kuptuar se si qëndron çështja. U tubuan kurejshitë si edhe xhaxhai i

Vërtetësinë dhe besueshmërinë e Muhamedit a.s. e kanë pohuar të gjithë, si miqtë ashtu edhe armiqtë.

Pejgamberit, Ebu Lehebi. Ata i thanë: "Pse na thirrre?" Pejgamberi u tha: "Nëse ju them se disa kalorës, atje pas bregut në luginë, kanë ndërmend t'ju sulmojnë, a më besoni?" Ata i thanë: "Po, sepse ti nuk ke gënhyer kurrë në jetën tënde!" Pejgamberi tha: "Pra, unë po ju them se jeni pranë një ndëshkimi shumë të ashpër!"

Vërtetësinë dhe besueshmërinë e Muhamedit a.s. e kanë pohuar të gjithë, si miqtë ashtu edhe armiqtë. Muhamedi a.s. nuk ka qenë mendjemadh, e as lajkatar.

El Buhari shënon nga Abdullah b. Abasi se i Dërguari i Allahut shkroi një letër dhe ja dërgoi perandorit të Biznantit, Herakliut, me anë të së cilës e thërriste në Islam. Herakliu pasi kishte ngadhënjyer ndaj ushtrisë persiane shkoi në Jeruzalem për t'i shprehur falënderimin Zotit.

Kur Heraklitit i erdhi letra e të Dërguarit të Allahut, që Dihja ia kishte çuar Herakliut nëpërmjet guvernatorit të Busras (në Siri), pasi që e lexoi tha: më gjeni një njeri prej

popullit të tij që të pyesim për këtë Pejgamber.³

Ibn Abbasi r.a. tregon: "Një herë Ebu Sufjan Ibn Harbi më tregoi se Herakliu i kishte çuar atij një lajmëtar, kur ky kishte qenë duke shoqëruar një karvan të kurejshëve. Ata ndodheshin për tregti në Sham (Siri, Liban, Palestinë, Jordani - të gjitha ishin një vend me këtë emër) në kohën kur i Dërguari i Allahut a.s. ishte në paqe të përkohshme me Ebu Sufjanin dhe idhujtarët kurejshë. Kështu, Ebu Sufjani dhe shoqëruesit e tij shkuan te Herakliu në Ilija (Jeruzalem). Ai i ftoi ata në oborrin mbretëror të mbushur me fisnikë romakë rreth vetes dhe thirri përkthyesin e tij. Pastaj pyeti (nëpërmjet përkthyesit): "Cili prej jush është më i afërti i këtij burri që pretendon të jetë Pejgamber?" Ebu Sufjani u përgjigj: "Unë jam më i afërti i tij nga ne këtu." Herakliu tha: "Silleni atë (Ebu Sufjanin) pranë meje, kurse të tjerët afrojeni këtu, pas shpinës së tij." Pastaj Herakliu i tha përkthyesit që t'u thoshte atyre se ai donte t'i bënte Ebu Sufjanit disa pyetje në lidhje me Pejgamberin a.s. dhe, në qoftë se do të gënjente, atëherë ata ta përgënjeshtrojnë atë.

Ebu Sufjani më ka thënë: "Për Allahun! Po të mos kisha turp nga shoqëruesit e mi se do të më vinin etiketën e gënjeshtarit, unë nuk do të kisha treguar të vërtetën për Pejgamberin a.s. Pyetja e parë që ai më bëri për Pejgamberin, ishte: "Cila është shkalla shoqërore e familjes së

tij ndër ju?" Iu përgjigja: "Ai i përket një familjeje të shquar ndër ne." (Herakliu) pyeti më tej: "A e ka thënë ndonjëri nga ju më parë atë që thotë ai (pra, se është i Dërguar i Zotit)?" Iu përgjigja: "Jo." Herakliu pyeti: "A ka qenë ndokush nga paraardhësit e tij mbret?" Iu përgjigja: "Jo." Herakliu pyeti: "A e pasojnë atë njerëzit e lartë nga ju apo vegjelia?" Iu përgjigja: "Është vegjelia ajo që e pason." Pyeti përsëri: "A shtohen apo pakësohen (pasuesit e tij)?" Iu përgjigja: "Përkundrazi shtohen." Pastaj ai pyeti: "A ka ndonjë nga ata të cilët përqafojnë fenë e tij që më pas të pakënaqur ta braktisin fenë?" Thashë: "Jo."

Herakliu tha: "A e keni akuzuar ndonjëherë për gënjeshtar para këtij pohimi të tij?" Iu përgjigja: "Jo."

Herakliu tha: "A ka tradhtuar apo shkelur ndonjëherë marrëveshjet e tij?" Iu përgjigja: "Jo. Tani ne jemi në armëpushim me atë, por nuk e dimë se çdo të bëjë ai me të." Nuk munda të gjej rast tjetër të them gjë kundër tij, përveç asaj fjale. Herakliu pyeti: "A keni luftuar me të?" Iu përgjigja: "Po." Pastaj tha: "Cili ka qenë përfundimi i luftërave kundër tij?" Iu përgjigja: "Lufta mes nesh ka qenë e këmbyer, disa herë ka qenë ai fitues dhe disa herë ne." Herakliu tha: "E çfarë ju urdhëron ai?" I thashë: "Ai na urdhëron të adhurojmë vetëm Allahun Një e të Vetëm dhe të mos i bëjmë Atij shokë, duke adhurar tjetërkënd në vend të Tij apo përkrah Tij; të heqim dorë nga çfarë adhuronin baballarët tanë dhe na urdhëron për faljen e namazit, për drejtësi e për të folur drejt, për dëlirësi dhe për respekt me farefis."

Pastaj Herakliu e urdhëroi përkthyesin të më thoshte në vazhdim: "Në të vërtetë, unë të pyeta për familjen e tij dhe ti përmende se ai vjen nga familjet më të mira. Zoti i zgjedh të dërguarit e Tij nga njerëzit dhe familjet më të nderura".⁴

Të pyeta nëse ndokush tjetër mes jush ka pretenduar një gjë të tillë (profecinë) para tij dhe përgjigja qe mohuese. Po të kishte qenë përgjigja

pohuese, do të mendoja se ai pason fjalët e paraardhësit të tij. Pastaj të pyeta nëse kishte qenë ndonjë nga paraardhësit e tij mbret dhe përgjigja qe mohuese. Po të kishte qenë përgjigja pohuese do të thosha se është njeri i cili kërkon mbretërinë e të parëve të vet. Pastaj të pyeta nëse ishte akuzuar ndonjëherë për gënjeshtria para se të nxirrte këtë pretendim (për pejgamberi) dhe përgjigja qe mohuese. Kështu që unë e kuptoj qartë se ai që nuk ka folur kurrë gënjeshtria ndaj njerëzve, nuk mundet që të gënjejë kurrë ndaj Allahut. Të pyeta nëse e ndjekin atë të pasurit apo të varfrit, ndërsa ti përmende se pasuesit e tij janë të varfrit. Dhe vërtet, gjithnjë janë ata pasuesit e të dërguarve. Pastaj të pyeta nëse ata shtohen apo pakësohen, ndërsa ti përmende se ata veçse shtohen. E tillë është çështja e imanit (besimit të vërtetë) derisa ai të plotësohet e të përmbushet në çdo pjesë të tij. Të pyeta nëse ndonjë prej atyre e braktis fenë e tij, pasi e ka përqaftuar atë duke qenë i pakënaqur me të, ndërsa përgjigja jote qe



mohuese. I tillë është besimi i vërtetë, kur ëmbëlsia e tij hyn në zemra dhe shkrihet plotësisht në to. Të pyeta nëse ka tradhtuar ndonjëherë dhe ti u përgjigje që jo. Vërtet kështu është: të Dërguarit nuk tradhtojnë kurrë. Pastaj të pyeta se çfarë ju urdhëron dhe ti përmende se ju urdhëron të adhuron vetëm Allahun Një e të Vetëm dhe të mos i bashkoni gjë Atij në adhurim, jua ndalon adhurimin e idhujve; pastaj ju urdhëron të falni namazin, të flisni drejt dhe të jeni të dëlirë. Në qoftë se gjithë çfarë ke thënë është e vërtetë, atëherë shumë shpejt ai do ta pushtojë këtë vend që është nën këmbët e mia. Dhe unë e dija (nga Shkrimet e Para) se ai do të dilte, por nuk e dija se ai do të ishte prej jush dhe, nëse do të isha i sigurt për të shkuar tek ai, atëherë do të shkoja menjëherë për ta takuar e, po të gjendesha pranë tij, padyshim që do t'ia laja këmbët."

Duke lexuar për sinqeritetin e Muhamedit a.s. historiani i njohur Tomas Karlajl do të shprehej: "Unë e dua Muhamedin a.s. për shkak të pastërtisë së natyrës së tij dhe të qenët të tij larg nga hipokrizia dhe shtirja. Ai ishte i pavarur në gjykimin dhe mendimin e tij. Ai nuk është mbështetur tek askush (përveç Zotit) dhe asnjë herë nuk ka pohuar për vete atë që nuk është."⁵

Jetëshkrimi i Pejgamberit, paqja qoftë mbi të, ka shumë dëshmi dhe prova që vërtetojnë sinqeritetin dhe besueshmërinë e Muhamedit a.s. dhe se ajo që ai ka thënë dhe vepruar është e vërtetë nga Zoti i plotfuqishëm, Krijuesi i gjithësisë.

1. Buhari, Muslimi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.
2. Kadir Misiroglu, Botëkuptimi Islam, Progresi, Shkodër 2008, f. 442. 3. Ky tregim është transmetuar në shumë libra të sunetit: Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Ahmed; Shih: Sulltan Ahmed Kureshi, Letrat e Muhammedit a.s., Logos-A, Shkup Prishtinë Tiranë, 204, f. 109; Tregimi i mbretit romak Herakliut me Ebu Sufjanin, <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php>; Hadith Hirakl ve Ebu Sufjan, shih: <https://www.alukah.net/spotlight/0/124608/?fbclid=IwAR1R1Y3LHSHGbcOCsdGKh6qiklOtpcREU00sVr0sd3pyJJuMS-wKeza2xEmg>. 4. Dr. Mustafa Sibai, Profeti Muhamed - vlera dhe urtësi, SHB Nektari, Tiranë, 2005, f. 41. 5. Tomas Karlajl, shih: Dituria Islame, revistë mujore fetare, shkencore e kulturore, nr. 358, viti 34, shtator 2020 safer 1442, f. 43- 44.

Muhamed B. Sytari

Ai ka bezdi nga ezani, unë lutem për të!

Dialogu dhe hapja me tjetrin, mund të ishte një mundësi e mirë e ballafaqimit të mendimeve, ideve, besimeve e vokacioneve të ndryshme shpirtërore e kulturore, në rrugën e qartësimit të interesave të ndershme e të shëndosha kombëtare.

Islami nuk është "ideologji obskure reaksionare", siç shkruan përçart Mustafa Nano, që natyrshëm nuk është as fillimi, as fundi i botës, e që herë pas here merr shkas nga ndodhi banale në provincialitetin e metropolit shqiptar, për të rindezur debate jointelektuale, që në thelb kanë goditjen e esencës së tabanit tonë kombëtar, Islamit.

Po e ri sjellë në vëmendjen tuaj një vështrim që pata publikuar para ca kohësh, që gjithsesi ka të bëjë edhe me shfaqjet e dhunshme të afetarizmit me kahje islamofobe te ne në Shqipëri.

Më tërheq jashtë mase personaliteti i hoxhës së nderuar shkodran, Hafiz Ali Kraja (1898-1974). Shkrimet e tij periodike, sidomos në revistën "Zani i Naltë", janë objekt studimi për teologët e rinj, studiuesit e filozofisë, intelektualët e përtej tyre.

Sot, dua të ndalem te kritika që i bën Hafiz Ali Kraja, afetarizmit, si një dëm i madh individual dhe rrezik ekstrem për shoqërinë.

Duke parë degradimin e realiteteve shqiptare, si pasojë e politikave afetare dhe islamofobe, si dhe deformimin e shumë koncepteve mbi fenë, moralin, demokracinë, lirinë, drejtësinë, paqen, harmoninë, trashëgiminë shpirtërore e kulturore etj., mendoj se fjalët e hoxhës së nderuar, vazhdojnë të jenë akoma në koherencë me këto zhvillime për kombin dhe të ardhmen e tij.


Kjo do të thotë se detyra e myslimanëve shqiptarë karshi fesë dhe kombit të tyre është shumë më e

Afetarizmi është një rrezik si për shoqërinë ashtu për pjesëtarët e saj që janë fetarë.

Besimi, pra, është gurra e cila ia bën të këndshme jetën njeriut dhe i jep atij shpresa për lumturi.

madhe, sesa përfaqësimi me paterica dhe jo dinjitoz, izolimi në jetën e xhamisë, fetarizmi i fjetur e i rëndomtë dhe partishmëria parazite ndaj erërave të ndryshme, që fryjnë sa andej-këndej, pa pasur paraprakisht një bosht të mirëfilltë strategjik dhe një shtyllë kurrizore identitare.

"Besimi mban rregullimin dhe harmoninë e shoqërisë njerëzore. Shoqëria paraqet një trup, pjesëtarët e të cilit janë në harmoni me atë vend ku respektohen rregullat e moralit. Në pikëpamje morale, kjo harmoni e ka burimin në përbashkësinë e ndjenjave, si fetare ashtu edhe të



tjera, të personave që përbëjnë shoqërinë. Po ta heqim besimin prej mjedisit, kjo harmoni shuhet vetvetiu.

...

Afetarizmi është një rrezik si për shoqërinë ashtu për pjesëtarët e saj që janë fetarë. Besimi, pra, është gurra e cila ia bën të këndshme jetën njeriut dhe i jep atij shpresa për lumturi. Ai që është larg kësaj gurre është fatmjerë dhe sikur t'i zotërojë të gjitha mjetet materiale që i duhen në këtë jetë; ai është i mjerë se i mungojnë ndjenjat e larta morale të cilat do ta bënin atë të lumtur.

...

Afetarizmi nuk është vetëm një mjet shkatërrues për veten dhe për shoqërinë, por njëherazi edhe për familjen. Vetëm interesi e lidh afetarin me familje...

Se besimi është një nevojë për shoqërinë njerëzore dhe se njerëzit pa besim nuk mund të jetojnë në formë të shoqërisë, u tregua edhe në manifestimet tragjikomike në kohën e revolucionit të madh francez...

Me të vërtetë, atë ditë që të fiket ideja e besimit, po atë ditë njerëzimi është plandosur në humnerë të shkatërrimit." - (Hafiz Ali Kraja, "A duhet Feja, a e pengon bashkimin kombëtar", ribotimi i KMSH-së, Tiranë, 2010, f. 18-21. Botimi i parë, Shkodër, 1934.)

Dialogu dhe hapja me tjetrin, mund të ishte një mundësi e mirë e ballafaqimit të mendimeve, ideve, besimeve e vokacioneve të ndryshme shpirtërore e kulturore, në rrugën e

Me të vërtetë, atë ditë që të fiket ideja e besimit, po atë ditë njerëzimi është plandosur në humnerë të shkatërrimit."

- (Hafiz Ali Kraja)

qartësisht të interesave të ndershme e të shëndosha kombëtare.

Për fund, iu riktheva shënimeve të shkrimtarit të shquar egjiptian me famë botërore Mustafa Sadik Er-Rafii (1880-1937), që teksa shkruan për botëkuptimin e thirrjes: Allahu ekber, (që i dashtuni Mustafa Nano nuk e kupton), rreshton: "Allahu ekber! A e di se çfarë thonë engjëjt, kur e dëgjojnë tekbinin (shprehjen: Allahu ekber)? Këndojnë këtë himn:

Kohë pas kohe, gjatë ditës bie ora e Islamit me këtë tingull: Allahu ekber, Allahu ekber, siç bie ora në një vend, për të folur koha me tingullin e saj.

Allahu ekber! Orë pas ore, gjatë ditës, jeta dërgon thirrjen e saj në këtë fjalë, thërret: O besimtar! Nëse ke vepruar mirë në orët që kaluan, përkushtohu në orët që pasojnë! E

nëse ke gabuar, shlyeje dhe fshije orën me orë, sepse koha e fshin kohën, vepra e ndryshon veprën dhe një minutë e ngelur nga jeta, është shpresë e madhe në mëshirën e Allahut.

Orë pas ore, besimtari merr matësin e vetvetes, teksa dëgjon thirrjen: Allahu ekber, për të mësuar shëndetin dhe sëmundjen në njetin e tij, njësoj siç i vendos mjeku të sëmurit të tij, orë pas ore, matësin e temperaturës.

Një ditë e vetme, në natyrën e kësaj bote është jetë e gjatë për të keqen, gati-gati çdo minutë me të keqen e saj është sa një ditë me natë të zezë. Prandaj duhet që njerëzimi ta ndajë ditën e vet në numrin e pesë kontinenteve të kësaj dynjaje; sepse dita e kësaj bote, është imazh i vetë botës dhe në çdo pjesë të saj, nga sabahu, mesdita, iqindia, akshami dhe jacia, njerëzimi besimtar thërret me të madhe: Allahu ekber, Allahu ekber, duke i tërhequr vëmendjen vetvetes.

...

Kohë pas kohe, gjatë ditës dhe natës bubullon fjala e shpirtit: Allahu ekber! Njerëzit i përgjigjen: Allahu ekber! Për t'u mësuar masat si të udhëhiqen drejt të mirës me lehtësi; dhe si të realizojnë në humanizmin e tyre kuptimet e tubimit të një familjeje të vetme, duke u rrënjësuar përgjigjja e tyre para çdo thirrjeje shoqërore, në natyrën e tyre, pa dhunë."

Ai ka bezdi nga ezani, unë lutem për të! Me gjithë zemër lutem për të!



Hfz. Mehas Alija

Sihariqe hyjnore për durimtarët

"Gjëja më e mirë dhe më e madhe që mund t'i jepet dikujt është durimi."
(Muhamedi a.s.)

Vëlla dhe motër e nderuar, nëse mendon se jeta të është ngushtuar, e qielli të ka arritur një pëllëmbë mbi kokë për shkak të problemeve, shqetësimeve, sprovave, telasheve, mërzive, etj., atëherë duro dhe mos e shiko botën dhe jetën vetëm bardh e zi.

Kur populli i Faraonit kishte humbur shpresën se ai do të kthehej e do të pendohej, teksa ndërtonte edhe piramidat, dhe mendonte se bota ka arritur në fund, dikush tjetër, pak më larg tyre, në luginën e Mekës, ndërtonte shtëpinë e Zotit, Qabenë e madhërishtme, ndërsa ishte plot shpresë, e ai ishte Ibrahim i a.s. dhe djali i tij, Ismaili a.s..

Ashtu njëjtë edhe nëna e Musait a.s., hodhi djalin e saj në lum, nga frika e Faraonit, ndërkohë që Zoti, vetëm për pak kohë, ia ktheu djalin në kraharorin e saj, nga vetë Faraoni. Në momentin që mendoi se e humbi të birin, vetëm se duroi, dhe, ja, iu gëzua zemra e syri i lotoi nga gëzimi, kur pa djalin sërish në duart e veta. Eh, ky është shpërblimi i durimit!

Shiko tani se sa sihariqe të bukura na paraqet Kurani për ata që janë të kalitur me durim dhe ecin në jetë përmes këmbënguljes me durim. Nuk është problem ngadalësia, me rëndësi është mos ndalja dhe mos demoralizimi.

Zoti i Madhërishtëm i përgëzon durimtarët, sabërlijtë, me tetë sihariqe:

1. Dashurinë: "Allahu i do durimtarët." (Ali Imran, 146).
2. Ndhimën: "Me të vërtetë Allahu është me durimtarët." (El-Enfal, 46)



3. Shpërblime të larta në Xhenet: "Për ata që duruan, do të kenë si shpërblim Xhenetin..." (El-Furkan, 75).
4. Shpërblim kolosal, pa hesap: "Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë." (Ez-Zumer, 10).
5. Përgëzim: "Dhe ti përgëzoji durimtarët." (El-Bekare, 155).
6. Bekim, falje.
7. Mëshirë.
8. Udhëzim.

Tre sihariqet e fundit i gjejmë te ajeti i sures El-Bekare: "Të tillët, (pra, durimtarët) janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë." (El-Bekare, 175).

Nga ana tjetër, Pejgamberi i Zotit, Muhamedi a.s. na jep një sihariq dhe përgëzim të madh në lidhje me durimin, kur thotë: "Gjëja më e mirë dhe më e madhe që mund t'i jepet dikujt është durimi." (Buhariu, Muslimi).

I Dërguari i Zotit durimin e ka krahasuar me dritën apo llambën që e ndezim kur bie errësira. Kur njeriun e rëndojnë dertet e sprovat, është durimi ai i cili i ndihmon dhe i bënë dritë për të parë urtësinë dhe shtegun. Ai i bekuar, paqja dhe nderimet e Zotit qofshin mbi të, ka thënë: "Durimi është dritë". (Muslimi, Ahmedi).

Të nderuar vëllezër e motra, ruajtja e qetësisë, ruajtja e gjakftohësisë, pritja për ta dëgjuar tjetrin, matja e fjalëve, vetëkontrolli në raste të vështirësive, të gjitha këto kërkojnë durimin e bukur (sabrun xhemil). Jo durim prej zori, por një të tillë që konsiston me razi dhe qetësi, si pajtim me Zotin dhe me fatin.

Njeriu e mëson durimin nga jeta, përvoja, etj., por e mëson edhe nga mesazhet dhe edukata hyjnore. Në raport me durimin, njerëzit mund t'i ndajmë siç vijon: Njerëz që durojnë vetëm kur sprovohen me fatkeqësi, e ky është durimi fizik, dhe njerëz që, përveç që janë të kalitur me durimin fizik, ata durojnë edhe ndaj ndalesave hyjnore, gjegjësisht me durim realizojnë edhe detyrimet fetare, shoqërore e familjare, e ky është durimi psikologjik, imanor.

E, pra, lumët për ata që janë të veshur me petkun e durimit. E si të mos jetë kështu, kur fjala e urtë thotë: "Durimi është i hidhur, por frytin e ka të ëmbël."

Allahu është më i madhi dhe Ai di më së shumti dhe më së miri!

Argjent Xheladini

Liria e fesë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (1)

Liria e fesë është një e drejtë universale e njohur nga ligji ndërkombëtar dhe nga traditat fetare kudo në botë. Rëndësia më e madhe e saj qëndron në faktin se në momentin e konfrontimit të mendimeve të ndryshme në marrëdhëniet e brendshme të një vendi, me qëllim të zgjidhjes sa më të drejtë të problemit, vëmendje i kushtohet pikërisht standardeve ndërkombëtare.

Liria e fesë

Edrejta për lirinë e fesë është një prej të drejtave më të vjetra të njohura ndërkombëtarisht dhe është subjekt i dispozitave kryesore në secilin prej instrumenteve më të rëndësishme ligjore ndërkombëtare që ndalon diskriminimin.¹

Kjo e drejtë ia jep çdo individ lirinë për ta zgjedhur ndonjë fe ose besim tjetër të zgjedhur prej tij. Gjithashtu ajo ia jep të drejtën çdo personi që vetëm ose në shoqëri me persona të tjerë ta manifestojë fenë me lutje, predikim, rite ose mësim, në mënyrë publike ose private. Përveç zgjedhjes së lirë të fesë dhe mënyrës së manifestimit të saj, kjo e drejtë siguron mbrojtje për njerëzit nga çdo lloj force që do ta kufizonte lirinë e shprehjes, përveç në rastet dhe në kufizimet e parapara me ligj, me qëllim të mbrojtjes së sigurisë së përgjithshme dhe të të drejtave të të tjerëve.²

E drejta e lirisë së fesë ka shtrirje jashtëzakonisht të gjerë. Ajo i referohet të menduarit për të gjitha gjërat dhe fenomenet. Në të drejtën ndërkombëtare, liritë religjioze mbrohen si liri të mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit. Këto tri liri themelore aplikohen njësoj ndaj bindjeve teistike dhe religjioze, si dhe përfshijnë të gjitha besimet me pikëpamje të jashtëzakonshme ndaj universit dhe një kod normativ të sjelles.³

Në kuptimin e ngushtë, liria e religjionit dhe e besimit përfshijnë lirinë e religjionit dhe besimit dhe lirinë nga religjioni dhe besimi, të cilat mund të kuptohen si të drejta për të pranuar ose për të mos pranuar një rregull ose sjellje religjioze. Liria e mendimit dhe ndërgjegjes është e mbrojtur njësoj sikurse edhe liria e religjionit dhe besimit. Kjo përfshin lirinë e mendimit në të gjitha çështjet dhe bindjet personale, si dhe përkushtimet ndaj religjionit ose besimit, qoftë përmes manifestimit individual ose së bashku me tjerët.⁴

Ashtu siç tregon numri i madh i “të burgosurve të ndërgjegjes” në gjithë botën, liria e ndërgjegjes shkalet mjaft shpesh. Këta të burgosur, në të shumtën e rasteve u takojnë minoritetëve religjioze të një regjioni dhe burgosen për shkak të besimeve të tyre religjioze. Liria e mendimit dhe ndërgjegjes, si dhe liria për të zgjedhur dhe ndryshuar religjionin ose besimin, janë të mbrojtura pa rezervë. Askush nuk mund të detyrohet t’i zbulojë mendimet e tij ose të saj, e as t’i bashkohet ndonjë religjioni ose besimi.⁵

Liria fetare në Kosovë

Historikisht populli shqiptar në Ballkan ka qenë shembull i tolerancës ndërfaqetare dhe respektues i ushtrimit

të lirisë fetare ndaj atyre që kanë respektuar rregullat fetare, pavarësisht se cilës fe i kanë takuar. Me të përfunduar lufta edhe shoqërinë tonë e ka përfshirë modeli i lirisë së pakufizuar (tejkalimi i kufijve të lirisë në përgjithësi dhe rrënimi i sistemit të vlerave dhe kriterëve për vlera, ashtu siç është duke u keqpërdorur edhe koncepti i demokracisë si trajtë e regjimit politik, ku shoqëria jonë po funksionon sipas modelit të tejkalimit të kufijve të veprimit që i parasheh korniza ligjore) dhe në këtë drejtim po ndodhë edhe me shfrytëzimin e të drejtave dhe lirive themelore, siç është rasti i disa besimtarëve të fesë myslimane, të cilët me kërkesa euforike po tentojnë të realizojnë kërkesën e tyre për kushte më të mira për t’i kryer ritet e tyre fetare.⁶

Ligji për Liritë Fetare në Kosovë ka paraparë në mënyrë shprehimore se Çdo njëri ka të drejtë të gëzojë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetarë. Kjo e drejtë përfshinë lirinë për të pasur ose për të mos pasur fe, për të mbajtur apo për të ndërruar fenë ose besimin, dhe lirinë për të manifestuar fenë ose besimin, çoftë si individ ose në bashkësi me të tjerët, publikisht ose privatisht, përmes adhurimit, predikimit, praktikimit dhe ceremonive.⁷

E drejta për lirinë fetare dhe të besimit përfshinë, mes tjerash, edhe liritë në vijim:

- Lirinë e adhurimit ose tubimit në lidhje me një fe ose besim, dhe krijimin dhe mirëmbajtjen e vendeve për këto qëllime;
 - Lirinë për të themeluar dhe qeverisur institucione humanitare dhe bamirëse;
 - Lirinë për të prodhuar, siguruar dhe për të përdorur gjësende dhe materiale të nevojshme për kryerjen e riteve ose zakoneve të fesë ose besimit;
 - Lirinë e shkrimit, nxjerrjes dhe shpërndarjes së publikimeve relevante në këto lëmi;
 - Lirinë për mësim të një feje apo besimi në vendet e destinuara për këto qëllime;
 - Lirinë për të kërkuar dhe pranuar kontribute financiare dhe kontribute të tjera vullnetare nga individët dhe institucionet;
 - Lirinë për t'u aftësuar, emëruar, zgjedhur ose caktuar pasardhës, sipas kushteve dhe standardeve të religjionit ose besimit përkatës;
 - Lirinë e respektimit të ditëve të pushimit dhe festimit të festave dhe ceremonive sipas normave fetare të fesë ose besimit përkatës;
 - Lirinë e krijimit dhe ruajtjes së komunikimit me individë dhe bashkësi për çështjet e fesë dhe besimit në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.⁸
 - Liria për të manifestuar fenë ose besimin duhet t'i u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve që janë të parashkruara me ligj dhe janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit dhe moralit, dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të tjerëve.⁹
- LLF i Kosovës ka përcaktuar se askush nuk duhet të jetë i diskriminuar ose i privilegjuar në çfarëdo mënyre në bazë të besimit fetarë, përkatësisë ose jopërkatësisë së një Bashkësie fetare, ose për kryerjen e ceremonive dhe ritualeve fetare. Askush nuk duhet të pengohet ose të detyrohet të marrë pjesë në ceremonitë fetare, ose në forma të tjera të



manifestimit të besimit fetar.¹⁰ Të gjithë personat, pavarësisht nga besimi ose bindja e tyre, pavarësisht nga përkatësia në ndonjë bashkësi fetare ose pjesëmarrja në ndonjë ceremoni fetare janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë të drejta të njejta në jetën civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Të gjithë personat juridik dhe fizik gëzojnë mbrojtje të njëjtë para ligjit.¹¹

Garantimi i lirisë së fesë

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut çdo njeriu ia garanton të drejtën e mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit fetar.¹² Në kushtetutat e demokracive kushtetuese detyrimisht garantohet e drejta e qytetarëve për shprehje të lirë të besimeve të tyre fetare apo të shprehin bindjet e tyre ateiste apo që fare të mos deklarohen për raportin e tyre ndaj fesë. E vështruar në kuptimin negativ, liria e shprehjes së besimit përjashton çdo obligim të qytetarëve që ta pranojnë religjionin e caktuar dhe pranimin e dogmës së tij. Liria e besimit fetar është në kundërshtim me obligimin e njeriut që të pranojë “dogmat e religjionit zyrtar”.¹³

Shikuar gjatë historisë, obligimi fetar një kohë të gjatë ka qenë i përcjellë me dënime të vrazhda, torturë fizike dhe likuidime të tmerrshme. Periudha e tolerances fetare në Evropë fillon me reformën, kur gradualisht fitohet e drejta e njeriut që lirisht ta zgjedhë dhe ta ndërrojë qëndrimin ndaj religjionit, kështu që sot, në shumicën e shteteve, me kushtetutë është përcaktuar liria e shprehjes së besimit. Rasti i këtillë, madje, është edhe në të ashtuquajturat shtete konfesionale, përkatësisht në shtetet në të cilat shprehja e besimit ka status të privilegjuar, kur shteti, megjithatë, ua njeh qytetarëve të drejtën formale që t'i përkasin apo të mos i përkasin religjionit shtetëror.¹⁴

Duke pasur parasysh se shprehja fetare nuk mund t'i japë të drejtë pushtetit shtetëror për trajtim të pabarabartë të qytetarëve, po ashtu as qytetari nuk mund t'i japë të drejtë vetes që të vihet në një situatë më të volitshme vetëm sepse i takon ndonjë feje tjetër.¹⁵ Për këtë arsye numri më i madh i kushtetutave, në mënyrë plotësisht konsistente, parashikon që askush nuk mund të lirohet nga obligimet e tij shtetërore, duke iu referuar besimit të tij fetar apo rregullave të fesë së vet. E drejta e shprehjes së lirë fetare nuk shkon deri atje që mësimet fetare të vihen

mbi dispozitat ligjore pozitive. Në atë rast nuk do të mund të arrihej barazia para ligjit. Liria e shprehjes së besimit nënkupton lirinë e plotë të shprehjes së besimit fetar, por nuk nënkupton formimin e pozitës së individit në shoqëri sipas rregullave fetare, e në kundërshtim me dispozitat shtetërore. Veprimet e jashtme të besimtarëve, po ashtu, mund të kryhen sipas mësimave fetare, nëse ata nuk janë në konflikt me ligjet pozitive. Nëse ligjet urdhërojnë një sjellje, ndërsa feja një tjetër, qytetari duhet t'u nënshtrohet urdhëresave të shtetit.¹⁶

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e shprehjes së besimit, të bindjes dhe të ndërgjegjes, si një nga liritë më të rëndësishme shpirtërore.¹⁷ Kjo do të thotë se askush nuk është i obliguar që të deklarohej për bindjet e veta fetare apo të tjera. Në këtë mënyrë mbrohet e drejta e individit që në mënyrë të lirë ta zgjedhë bindjen e vet, përkatësisht pikëpamjen e vet ndaj botës. Kjo e drejtë është e garantuar edhe me Ligjin për Liritë Fetare në Kosovë (zbatohet së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij nr. 2006/48, të datës 24.08.2006), i cili përcakton që çdo person e ka të drejtën e mendimit, besimit dhe të fesë. Kjo e drejtë përfshin të drejtën e zgjedhjes së individit që të ketë fe apo jo, përkatësisht që të jetë besimtar apo ateist, që ta mbajë apo ndërrojë fenë e vet, qoftë si person apo në bashkësi me të tjetër, publikisht apo privatisht.¹⁸

Përmbajtja e lirisë së fesë

Kushtetuta nuk e parashikon veçanërisht përmbajtjen e garancive që përfshijnë liritë e ndërgjegjes dhe të besimit. Republika e Kosovës është shpallur si shtet laik, gjë që në mënyrë të theksuar thuhet në nenin 8 të Kushtetutës, ndërsa dispozita e nenit 39 në mënyrë edhe më të detajuar

precizon që bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti, sepse sipas paragrafit 1, Republika e Kosovës siguron dhe mbrohet autonominë e të gjitha bashkësive fetare brenda territorit të saj, ndërsa bashkësitë fetare janë të lira që në mënyrë të pavarur ta rregullojnë organizimin e tyre të brendshëm. Nga konteksti i përgjithshëm i paragrafit 2 mund të përmenden disa garanci kushtetuese, të cilat në masën më të madhe kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes së besimit dhe me të drejtat lidhur me këtë, ndër të cilat janë:

- e drejta e pranimit të fesë së vet;
- e drejta e manifestimit të fesë së vet;
- e drejta e manifestimit të bindjeve personale;
- e drejta e pranimit apo mospranimit të anëtarësisë në ndonjë bashkësi fetare apo grup.¹⁹

Siç mund të shihet, liria e ndërgjegjes dhe besimit përmendet në të katër paragrafët e nenit 38, prandaj ajo meriton që për të, të thuhet diçka. Në të vërtetë, e drejta e ndërgjegjes është një formë më e ngushtë e lirisë së përcaktimit të njeriut, lirisë së shpirtit dhe nënkupton të drejtën e njeriut për integritet të brendshëm moral. Njeriu është i lirë t'i manifestojë ndjenjat e veta, qëndrimet dhe pikëpamjet pa marrë parasysh autoritetet shpirtërore, ideologjike, të cilat në këtë mënyrë i kundërshton (së pari institucioni fetar, pastaj edhe shteti). Njerëzit janë të lirë vetëm nëse mund të veprojnë sipas ndërgjegjes së tyre, në pajtim me bindjet e veta.²⁰

Ndërgjegjja është kategori e lirisë shpirtërore dhe si e tillë nënkupton ekzistimin e vetëdijes për atë që, në pikëpamje morale, është një sjellje, jo vetëm e drejtë, por edhe obliguese. Esencës së lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit i përgjigjet edhe e drejta e njeriut që në mënyrë të pavarur ta zgjedhë "pikëpamjen për botën" në cilëndo sferë të jetës (jo vetëm religjioze dhe politike). Liria e ndërgjegjes dhe e bindjes më parë ka

qenë e lidhur, para së gjithash, me religjionin, ndërsa sot nënkupton, në rend të parë, mohimin e ideologjisë zyrtare shtetërore, (e cila, në masë të madhe, e ka marrë rolin e mëparshëm të fesë).²¹ Prandaj, kushtetutat bashkëkohore gjithnjë e më shumë kanë kujdes për atë që njeriu shpesh vjen në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, prandaj konfliktin ndërmjet bindjes dhe obligimit zyrtar, ata e zgjidhin me pranimin (në rastin konkret) e kundërshtimit të ndërgjegjes, për shembull, refuzimi i shërbimit ushtarak me armë, refuzimi i mjekut për ndërprerje të shtatzënisë e të tjera...²²

1. Shih Arsim Bajrami, *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011, fq. 204.

2. Po aty, fq. 205. 3. Shih http://www.etcgaz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETCHauptseite/manual/versionen/albanian/relig/relig.htm 4. Po aty.

5. Po aty. 6. Shih Arsim Bajrami, *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011, fq. 204.

7. Shih Ligji Nr. 02/L-31, për Liritë Fetare në Kosovë, neni 1 paragraf. 1. 8. Po aty, neni 1 paragraf. 2. 9. Po aty, neni 1 paragraf. 3. 10. Po aty, neni 2. 11. Po aty, neni 3. 12. Shih KEDNJ, neni 9.

13. Shih Enver Hasani, Ivan Čukalović, *vep. e cit.*, fq. 132..

14. Shih Enver Hasani, Ivan Čukalović, *vep. e cit.*, fq. 132..

15. Shih lëndën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, K136/11.

Në pikat 69-78 gjykata detajisht ka elaboruar që të drejtat fetare nuk mund të jenë bazë për rrëzimin e themeleve sekulare të shtetit dhe të shoqërisë në Republikën e Kosovës.

Krahaso: Aktvendimi për palejueshmëri i datës 30 shtator 2011 në rastin nr. K136/11 (Paraqitëse e kërkesës, Arjeta Halimi.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të aktgjykimit nr. 24/09, nga data 17 nëntor 2009 i Gjykatës së Qarkut në Gjiçan për kinse shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitësit të kërkesës).

16. Për shembull, dispozitat fetare thonë "mos vrit", ndërsa rregullat luftarake mësojnë se si të vritet armiku më lehtë. Këto rregulla të luftës, dhe jo dispozitat fetare, i obligojnë qytetarët.

17. Shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 38, paragraf. 1. 18. Shih Ligjin për Liritë Fetare në Kosovë, neni 1, paragraf. 1.

19. Shih Enver Hasani, Ivan Čukalović, *vep. e cit.*, fq. 134..

20. Po aty, fq. 135..

21. Krijuesit e ideologjive të tilla shtetërore kanë pasur pretendime të qarta që ato të jenë gjithëpërfshirëse, prandaj ideologjitë e këtuila shtetërore, me të drejtë, quhen "sekulare, përkatësisht religjione laike" (për shembull, një nga to ka qenë ideologjia komuniste e ishsheteteve socialiste).

Ndërkaq, qëndrimi i sotëm i shtetit liberal distancohet nga ky pretendim dhe e pranon pluralizmin e ideve për qasje kësaj çështjeje, përkatësisht në çështjet sekulare/laike.

22. Shih Zink, H., (1962), 'Modern Governments', D. Van Nostrand Company Inc.: New York; Strong, C.F., (1963), 'Modern Political Constitutions' Putnam: London dhe Wheare, K.C., (1966) 'Modern Constitutions', Oxford University Press: USA.

Mr. Driton Arifi

Vakëfet, këto thesare të çmueshme të civilizimit islam

Vakëflënia është shndërrim apo kalim i pronës private tek një titullar tjetër qoftë ai person fizik apo person juridik, por që kjo të bëhet me vullnetin e pronarit të saj.

Nuk mund të flitet për asnjë fushë të zhvillimit, lulëzimit dhe përparimit të shoqërisë islame, madje në cilëndo periudhë historike të saj, e të mos flitet për rolin dhe ndikimin që patën vakëfet në ato zhvillime mbarëshoqërore të myslimanëve. Vakëfet, për sytë e secilit studiues, do mbeten si një tregues i fuqishëm që rrëfen qartazi për humanizmin e rrallë, vizionin mbresëlënës dhe shpirtgjerësinë e myslimanëve gjithandej nëpër viset ku ata jetuan e gravituan. Ato do të rrëfejnë për gjeneratat, gatishmërinë e lartë të brezave të kaluar që me pasuritë më të çmueshme të tyre të ndriçojnë rrugën e atyre gjeneratave që do vijnë më pas. Shikuar në këtë këndvështrim, nuk është e habitshme pastaj edhe hapësira e gjerë që juristët islamë e ndanë në literaturën juridike islame për këtë kapitull, dispozitat e të cilit natyrisht se janë mjaft të detajuara dhe sigurisht interesante.

Determinimi juridik i vakëfit

Në një hulumtim rreth nocionit “vakëf” në të drejtën islame, gjejmë divergjenca meqenëse jo shumë substanciale, të juristëve islamë rreth definimit të vakëfit si nocion juridik. Ato divergjenca, kryesisht burojnë nga pikëpamjet e ndryshme që ata dijetarë kanë rreth kushteve të ligjshmërisë së vakëflënies dhe formave të realizimit të tij.

Në literaturën klasike hanefite e gjejmë që vakëfi është definuar si:

“Kurrë nuk do të arrini sinqeritetin e plotë me besim derisa të mos e jepni më të dhembshmen (më të dashurën) e pasurisë suaj. Çka do që jepni (për Zotin), Allahu atë e di.” (Ali Imran, 92).

“shpronësimi i një prone të caktuar nga pronari i saj, në mënyrë që ajo të lihet në shfrytëzim për bamirësi.”¹

Edhe dijetari i mirënjohur bashkëkohor, Muhamed Ebu Zehre, e definoi vakëfin me një definicion më përmbledhës duke thënë: “vakëfi është heqja dorë e pronarit nga prona e tij, në mënyrë që ajo të lihet në shfrytëzim e të përfitohet prej saj për qëllime bamirësie e humane.”²

Thënë ndryshe, vakëflënia është shndërrim apo kalim i pronës private tek një titullar tjetër qoftë ai person fizik apo person juridik, por që kjo të bëhet me vullnetin e pronarit të saj. E gjithë kjo duhet bërë duke specifikuar e dedikuar saktësisht pastaj edhe formën e shfrytëzimit e të përfitimit të asaj prone dhe kushtet e realizimit të atij vakëfi.

Ligjshmëria e vakëflënies në Islam dhe historiku i saj

Secili besimtar, për veprën e tij të mirë që dëshiron ta bëjë, e gjen motivin kryesor në fjalët e Allahut të Lartëmadhërishtëm e pastaj edhe në porosinë e Muhamedit a.s.. Edhe për lënien e vakëfeve, sigurisht se janë një mori ajetesh që motivojnë e nxisin besimtarët për shpenzim të pasurisë në rrugën e Zotit. Ato ajete, në fakt, e ndërlidhin shpenzimin e pasurisë me nivelin e besimit tonë, duke e konsideruar atë shpenzim pastaj edhe si një tregues të fuqishëm të përkushtimit tonë në rrugën e Allahut. Ai në një citat kuranor tha: “Kurrë nuk do të arrini sinqeritetin e plotë me besim derisa të mos e jepni më të dhembshmen (më të dashurën) e pasurisë suaj. Çka do që jepni (për Zotin), Allahu atë e di.” (Ali Imran, 92).

Ky ajet dhe të tjerët ngjashëm me të, nuk përmendin specifikisht shprehjen vakëf, ngase rëndom ajetet nuk bëjnë këso lloj specifikimesh, por gjejmë në të sinjal të fuqishëm për shpenzim të pasurisë për bamirësi, e vakëflënia pa dyshim se është e pjesë e kësaj kategorie.

Ndërsa, porosi specifike për vakëflënie, gjejmë në hadithet e Muhamedit a.s. dhe sugjerimet e tij fisnike.

Transmeton Ibën Umeri r.a. e thotë: “Umeri r.a. e përfitoi një pjesë toke në Hajber³ e pastaj shkoi tek i



Dërguari i Allahut a.s. që ta pyeste e të këshillohej se çfarë të bënte me atë tokë duke i thënë: “O i Dërguar i Allahut, unë kam përfituar tani një tokë në Hajber, që kurrë nuk kam përfituar ndonjë pasuri më të çmueshme se kjo. Çfarë po më urdhëron të bëjë me të? Ai (i Dërguari a.s.) i tha atij: “Nëse do, leje vakëf atë (heq dorë nga pronësia e saj) dhe dhuro për bamirësi-sadaka përfitimet e saja.” Ai (Ibën Umeri që ishte transmetues i këtij hadithi) tha: Umeri pastaj e dhuroi për bamirësi atë tokë, që të mos shitet ajo si patundshmëri, të mos blihet, të mos trashëgohet e të mos dhurohet. E dhuroi atë për të varfrit, të afërmit, për lirim të robërve, në rrugën e Allahut, për udhëtarët (që kanë mbetur në rrugë), për nderim të mysafirëve, dhe (tha që) s’ka mëkat për kujdestarin e atij vakëfi, që të hajë prej tij në formë korrekte, ose ta ushqejë me të ndonjë mik, por jo ta bëjë atë pronë të veten – në një transmetim tjetër thuhet “jo të grumbullojë pasuri prej saj”.⁴

Një praktikë e tillë, natyrisht që është zgjeruar dhe përhapur pastaj te një numër i madh i shokëve të të Dërguarit të Allahut a.s. për t’u bërë

më vonë edhe si një fenomen e dukuri që premtonte një lulëzim e prosperitet për mbarë shoqërinë e asaj kohe, dhe jo vetëm.

Megjithatë, duhet vënë theksin se vakëfi i parë i lënë nga ndokush në Islam, e që është evidentuar nga literature islame, është ai i të Dërguarit a.s. e më pas, vjen ai i Umerit r.a.. Transmeton Vakidiu dhe thotë: “Pasuria e parë e dhuruar si vakëf në Islam është toka e Muh’ajriik-ut, e cila, një herë i është dhuruar si testament të Dërguarit a.s., por ai të njëjtën nuk e ndali për vete, ngase e dhuroi dhe e la si vakëf për të tjerët. Ndërsa Sad ibën Muadhi thotë: “Ne pyetëm se cila është vakëflënia e parë në Islam, muhaxhirët na thanë se është pasuria që e dhuroi Umeri”.⁵

Këto dy transmetime sikur duken paksa kundërthënëse lidhur me atë se kush ishte i pari që la vakëf nga pasuria e tij. Megjithatë, mund të konstatojmë që s’ka kundërthënie në mes të këtyre dy transmetimeve, ngase i pari në cilësinë e tij si i Dërguar, ishte Muhamedi a.s. që la pas vetes vakëf, ndërsa nga njerëzit e tjerë të rëndomtë ishte Umeri i pari që e bëri një veprim të tillë.

Vakëflënia nuk u ndalë, e as nuk mbeti si fenomen i ngushtë brenda një grupi të paktë të sahabëve. Ndonëse jo në transmetime të konfirmuara e autentike, rrëfëhet nga Xhabiri r.a. se ka thënë: “Unë nuk di dikë që kishte pasuri nga sahabët, qoftë nga muhaxhirët apo ensarët, e që nuk kishte lënë pas vetes një hise si vakëf të përhershëm, që nuk shitet, nuk dhurohet e as nuk trashëgohet.”⁶ Vakëfet vazhdonin të zgjeroheshin e të rriteshin. Në periudhën e hershme, ishin gjykatësit ata që merreshin me përcaktimin e kujdestarëve të vakëfeve dhe shkarkimin e tyre nëse ata ishin të pakujdesshëm. Por më vonë, gjatë periudhës emevite, saktësisht në kohën e kalifit Hisham ibën Abdulmelik (684-705 g.) u themelua i ashtuquajtimi “Divani i Vakëfeve”.⁷ Ndonëse jo në të njëjtin kapacitet administrativ, por divanet e vakëfeve që u themeluan në periudhën emevite e abasite, edhe më vonë, mund të konsiderohen si ekuivalente me ministritë e vakëfeve që janë themeluar gjithandej nëpër botën islame gjatë dy shekujve të fundit.

Ekziston një konsensus i të gjithë dijetarëve për ligjshmërinë e vakëflënies, dhe se ajo është prej veprave më dashura tek Allahu i Lartëmadhërishtëm.

Roli dhe ndikimi i vakëfeve në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë islame

Shumë prej hulumtuesve dhe studiuesve të ndryshëm, qoftë myslimanë ose edhe të tjerë, mendojnë që sistemi i vakëfeve është njëri prej komponentëve më themelore të ngritjes së shoqërive e shteteve islame, gjatë gjithë historisë, si në aspektin arsimor, kulturor, fetar, ekonomik por edhe atë shoqëroro-politik.

Njëri prej argumenteve më të qarta për fuqinë e solidaritetit, edhe thellësinë e vlerave humane në historinë e ymetit tonë është edhe numri i madh i atyre institucioneve që merren me qëllime humanitare e solidarë që shërbejnë për të mirën e individit dhe të njerëzimit mbarë. Këtë e vëren edhe orientalisti i njohur Carl Brockelmann i cili thotë: “Realitet është se i gjithë ai zhvillim-prodhim i gjerë e gjigant që ka ndodhur në kohën e memalikëve, kishte bazën në sistemin e vakëfeve që ishte themeluar që nga koha e abasitëve dhe i cili përfundoi në Egjipt e Siri duke e formuar një pasuri që mund të llogaritet gati e paimagjinueshme. Kjo ngase tregtarët e të pasurit e mëdhenj nga Egjipti, Siria, por edhe ata nga Iraku më herët kishin lënë pasuritë e tyre në të gjitha sferat e bamirësisë edhe ato të përhapjes së diturisë.”⁸

Ajo që rrëfen realiteti i vakëfeve në Islam, është se ato nuk ishin të përkufizuara dhe nuk iu dedikoheshin vetëm xhamive, ndërtimit apo mirëmbajtjes së tyre, mirëpo përfshinin pothuajse çdo sektor të

"... i gjithë ai zhvillim-prodhim i gjerë e gjigant që ka ndodhur në kohën e memalikëve, kishte bazën në sistemin e vakëfeve..."

(Carl Brockelmann)

jetës kolektive e publike të shoqërisë islame. Duhet thënë troç një e vërtetë se vakëfet liheshin për ndërtimin e xhamive, shkollave, universiteteve, jetimoreve, spitaleve e shtëpive të shëndetit, rrugëve, urave e të ngjashme.

Është një studim goxha interesant që është prezantuar, në njërin prej seminareve të mbajtur në Kuvajt, e që për temë kishte vakëfet dhe rolin e tyre në zhvillimin njerëzor. Ky hulumtim nëse jo të gjitha, por sigurisht ka përfshirë shumicën vakëflënies të evidentuara nëpër vendet islame. Ai kishte për synim të rrëfente fushat apo sferat e jetës që janë përfshirë e mbuluar nga vakëfet. Ky hulumtim na ofron këto statistika domethënëse:

- 27% e vakëfeve janë lënë për të ushqyer të uriturit, apo ata që nuk kanë ushqim ditor;
- 11% të vakëfeve janë lënë për xhami (ndërtim e mirëmbajtje të tyre);
- 11% të tyre janë lënë për shkolla (ndërtim e mirëmbajtje të tyre);
- 9% për ndihmë udhëtarëve e të pastrehëve;
- 8% për mësonjëtorë të vogla;
- 5% për dy haremet e shenjta (Qabenë e Shenjtë në Mekë dhe Xhaminë e Muhamedit a.s. në Medinë);
- 5% për të varfrit e nevojtarët;
- ndërsa pjesa tjetër për qëllime të tjera.⁹

Ky studim shpërfaqë sheshazi universalitetin e vakëfit dhe përfshirjen e sferave të ndryshme

jetësore prej tij. Këtu vërejmë një laramani të mahnitshme të dedikimit të parasë private për të mirën kolektive, dhe duket një humanizëm fascionues i myslimanëve vizionarë, të cilët projektuan një të ardhme të ndritshme pa kursyer asgjë nga pasuria e tyre.

Këto të dhëna hedhin poshtë çdo hipotezë që pretendon se myslimanët dinë të shpenzojnë pasurinë e tyre dhe të dedikojnë atë për xhamitë, apo vendfaljet e tyre.

Madje mund të thuhet lirshëm se zhvillimi dhe progresi i vakëfeve sa herë që ai ndodhte, njëherësh tregonte edhe për zhvillimin dhe avancimin e shoqërive islame gjithandej nëpër botë. Dhe sa herë që shoqëria islame vuante nga dekadencia, e plogështia civilizuese, kjo gjithnjë reflektonte shpërfilljen dhe anashkalimin e rolit të vakëfeve në shoqëri. Pra, rendi dhe rregulli i mirëfilltë i vakëfeve tregonin njëkohësisht edhe për “shëndetin” e mirë të shoqërive islame.

Krejt në fund, është më vlerë të theksohet se vakëfet kanë qenë faktori kyç që përgjatë historisë e kanë ruajtur dhe i kanë garantuar pavarësinë ideore e institucionale ylemave- dijetarëve islamë, pastaj edhe të bashkësive fetare islame në të gjitha vendet ku jetuan myslimanët.


1. El Mevsilij El Hanefij, El Ih'tijar Li Ta'il El Muh'tar (3/40). Bot. i tretë. Daru El Kutub El Ilmijje. Bejrut. 2. Muhamed Ebu Zehre, Muhaderat fi El Vakf (fq.39). Bot. i dytë. Dar El Fikr El Arabij. Kajro, 1971. 3. Hajberi është vendbanim që jetonin në të hebreitët, në afërsi të Medinës që u morë nën kontroll nga myslimanët në kohën e Muhamedit a.s. pasi që ata thyen marrëveshjen me të. 4. Muttefak alejhi (Buhariu me numër të hadithit : 2737, dhe Muslimi me numër: 1632) e të tjerë. 5. Ibën Haxher, Fet'h El Barij Sherh Sahih El Buh'arij (5/453). Bot. i parë. Daru El Hadith. Kajro, 1998. 6. Oleh: M. Yamin, El Evkaf El Islamijje ve Etheruha ve devruha fil Muxhtema' El Muslim. 7. Muhamed El Kubejsi, Ahkam El Vakf Fi Esh Sheria' El Islamijje (1/39). Bot. i parë. Matbeat el Irshad. Bagdad, 1977. 8. Carl Brockelmann, Tarih 'Esh Shu'ub El Arabijje (fq.371). Bot. i pestë. Dar El Ilm Lil Melajitin. Bejrut. 2001. 9. Këto të dhëna janë marrë nga njëri prej hulumtimeve që janë përgatitur në seminarin e organizuar nga Ministria e Vakëfeve e Kuvajtit me temën: “Drejt një roli zhvillimor të vakëfeve”, mbajtur me 3-1 maj, 1993 në Kuvajt. Shih: Ahmed Rejsuni, El Vakf El Islamij mexhalatuhi ve Eb'aduhu (fq.64). Bot. i parë. Daru El Kelime, Kajro, 2014.

Prof.ass.dr. Rexhep Suma

Kategoritë e të ftuarve në komunikimin e daves

Gjatë predikimit të fesë kemi individë që dëgjojnë dhe binden në heshtje ashtu siç ka edhe grindavecë e polemizues e disa sosh shkojnë deri në shkallën e nënçmimit dhe poshtërimin të figurave fetare.

Duke u nisur nga fakti se njerëzimi nuk është në një natyrë dhe secili individë, shoqëri e mjedis ka specifikat dhe perceptimet e tij, psikologjia e masave është një art në vete që secili predikues i fesë duhet pasur parasysh. Qytetërimi i një populli bazohet në një numër të vogël idesh themelore. Nga këto ide burojnë institucionet, letërsia dhe artet. Duke u formuar shumë ngadalë, ato edhe zhduken shumë ngadalë. Ndërsa mendjet e njerëzve të emancipuar e kuptojnë se ato janë të gabuara, për turmat ato mbeten edhe për një kohë shumë të gjatë të vërteta e të pakundërshtueshme dhe vazhdojnë të ushtrojnë veprimet e tyre në masat popullore të kombit. Nëse është e vështirë të futësh një ide të re, është jo më pak e vështirë të asgjësosh një ide të vjetër. Njerëzimi kapet gjithmonë me dëshpërim pas ideve të shtrembra dhe ajo që është më e lehtë.¹ Andaj, nisur nga kjo ndjeshmëria e natyrës njerëzore është prezentë tek njerëzit, ka individë që për nga natyra janë të butë, tepër të ndjeshëm e emocional dhe u përgjigjen predikimeve dhe mesazhit të fesë, sikurse ekziston edhe kategori tjetër e njerëzimit të cilët për t'i bindur apo përqaftuar mesazhin e Islamit janë më meditativë dhe rationale dhe kërkojnë argumente shitesë në ndërtuar mbi logjikë. Në anën tjetër në strukturat shoqërore kemi po ashtu edhe njerëz të ngritur e të arsimuar sikurse ka edhe injorantë, të fuqishëm e të dobët, po ashtu ka edhe individë që



impresionohen nga joshja e ofertave për bukuritë e xhenetit dhe çka në to, e ndërsa të tjerë ndjejnë frikën dhe tmerrin nga ndëshkimi me zjarrin e Xhehenemit. Po ashtu gjatë predikimit të fesë kemi individë që dëgjojnë dhe binden në heshtje ashtu siç ka edhe grindavecë e polemizues e disa sosh shkojnë deri në shkallën e nënçmimit dhe poshtërimin të figurave fetare.

Andaj nisur nga ajo që u cek më lartë kategoritë e të ftuarve në dave ndahen në katër sosh:

1. Kategoritë e parë janë besimtarët
2. Hezitusit
3. Mohuesit si dhe
4. Kategoritë që shfaqin mosdurim e neveri ndaj predikuesve.

Kategoria e besimtarëve

Individët që kanë ka besuar në ftesën tonë (islamin) dhe ka ndjerë sinqeritet ndaj predikimeve tona dhe njëherit shfaq mahnitët me botëkuptimet tona dhe është i bindur se në të ka dobi e mirësi shpirti dhe zemra e tij në fe gjej qetësi e rehati. Ky njeri ftohet që të radhitet përkrah nesh dhe të veprojë me ne në mënyrë që kjo frymë të shpërndahet tek sa më shumë njerëz që zëri i së vërtetës të jehoj dhe të ngritet mbi zërin e të kotës dhe të pavërtetës. Zaten nuk ka kuptim besimi (imani) pa veprim dhe që nuk e shtyn drejt realizimit të objektivit, e që në këtë rrugë nëse e kërkon nevoja edhe të sakrifikoj nga

vetja e kapitali. Kështu kishin vepruar gjeneratat e më hershme duke pasur të Dërguarit e tyre dhe besuar në mesazhit e tyre. Mbi këtë edhe historia i regjistroi si gjeneratë e cila ishte më e vlefshme (sahabet), dhe se shpërblimi i tyre ende iu shkron duke mos na u pakësuar neve. Duke iu kthyer pakëz kreut të kësaj pike duhet të shtojmë se da'iu duhet njohur shkallën e besimit të njerëzve se sa njerëzit janë besimtarë dhe sa jo dhe në çfarë niveli arrin besimi (imani) i tyre, dhe mbi këtë njohuri ai ndërton edhe mënyrën dhe qasjen e tij ndaj kësaj mase sepse dihet fakti se çdo popull nuk ka të njëjtën shkallë besimi dhe për çdo situatë kemi predikime, ligjërime e derse të ndryshme komunikuese. Disa njerëz i kanë zemrat e mbushura me iman (besim) kurse disa sosh nuk kanë asnjë besim te Zoti dhe as te shenjtëria e Tij.

Kategoria e hezituesve

Një kategori tjetër që ndeshet predikuesi përgjatë misionit të thirrjes islame janë hezituesit. Kjo kategori apo ky individ nuk ka arritur ende të kuptoj mesazhin e islamit si shpirt dhe jetë, nuk ka arritur që të kuptoj fjalën e sinqeritetit e edhe dobisë dhe prandaj mbanë një qëndrim të tillë. Këtë individ e lëmë që të hezitojë, duke e këshilluar vazhdimisht që të mbajë kontaktin dhe komunikimin me ne për së afërmi, kohë pas kohe e furnizojmë me literaturë fetare, e ftojme që të vizitojë institucionet dhe qendrat apo klubet islame ku do të njihet për së afërmi dhe më mirë me vëllezërit e tjerë myslimanë dhe kjo do të ndihmonte që të largojë dyshimet dhe imazhet e këqija që i ka pa apo dëgjuar nga të tjerët në lidhje me Islamin dhe myslimanët. Kjo do të ndihmonte jashtë mase që ky person të hiqte dyshimet dhe hezitimet dhe t'i bashkohet radhëve të myslimanëve dhe do të angazhohej për ngritjen dhe fuqizimin e myslimanëve dhe qëndrimin të tyre.

Kategoria e interesaxhive (materialistëve)

Kjo kategori e njerëzve apo individëve janë të veçantë në ndërveprime pasi që çdo gjë e masin me terezinë e interesit. Ata nuk dëshirojnë të ofrojnë ndihmën e vet materiale po shpirtërore pa menduar dhe siguruar se kjo do të përkthehet në përfitime (interesaxhi). Me këtë kategori duhet të jemi të drejtpërdrejtë menjëherë, duke ia kumtuar atij se misioni ynë nuk pret shpërblim përveç atij nga Allahu xh.sh., nëse veprat e i bëjmë me sinqeritet e devotshmëri. Rruga jonë është sakrificë, dhënie nga pasuria e vetja dhe objektivi ynë është arritja e kënaqësisë së Tij, Ai është mbështetësi dhe Ndihmësi më i mirë. Nëse arrin që nga zemra e tij të heq dozën e lakmisë dhe dashurinë e tepruar për të mirat e kësaj bote, do ta kuptoj shpejt që ajo që është e Zotit është më e favorshme për të, pas këtij vendimi do t'i bashkëngjitet radhëve të umetit islamë, që të marrë edhe ai shpërblimin nga Dhuruesi i të gjitha botërave. Ky koncepti i bindjes do të kthjellonte mendjen e tij se ajo që bëhet për Zotin mbetet e të tjerat janë kalimtare dhe fluturuese. Jeta dhe vdekja janë për Krijuesin absolut të gjithësisë. Gjendja e tij e deritashme është sikurse e disa popujve të mëhershëm të cilët refuzuan t'i bindjes mesazhit të të dërguarve të mëparshëm sepse dëshironin interesa jashtë kornizës së mesazhit hyjnorë, porse atyre iu dha përgjigja e qartë dhe e prerë se toka është e Allahut xh.sh., dhe të mirat e tokës i trashëgon ai që dëshiron Zoti dhe se përfundimi i mirë është për të devotshmit.

Kategori që shfaqin mosdurim e neveri ndaj predikuesve

Kjo është kategoria më e rrezikshme e njerëzve të cilët tërë aktivitetin e tyre material dhe mendor e kaun

orientuar kundër predikimit dhe personalitetit të thirrësit. Ai ushqen mendim të keq për predikuesin, mbjell dhe shpërndanë dyshime në figurën dhe personalitetin e thirrësit por edhe të fesë islame dhe ai shikimin në ne e ka vetëm të zi. Predikuesi duhet të tregoj maturi e urtësi me të, tu përmbahet modeleve të Pejgamberit a.s. se si ka vepruar me këtë nivel njerëzish dhe vazhdoj ta lus Zotin që ai ta kuptoj të vërtetën dhe të largohet nga e kota dhe të qëndroj në rrugë të drejtë. Edhe me këtë kategori individësh nuk duhet këputur apo ndërprerë komunikimin me të, por kohë pas kohe të zhvillojmë takime ta ftojme në takimet tona ta duam dhe në të njëjtën kohë ta lusim Zotin që ta kuptoj realitetin dhe të bindet në thirrjen dhe vlerat tona. Me të duhet të veprojmë me këtë model që ka veprua ri dashuri ynë, Muhamedi a.s., duke thënë: "O Zot fale popullin tim se vërtetë ata nuk dinë"².

Disa dijetarë kaun klasifikuar në kuadër të Kategorive sipas besimit edhe disa nënkategori të mëposhtme siç mund të cekem.

1. Ateistët, ku kjo kategori nuk tregon shenja besimi në Zotin xh.sh., në profet, Libër të shenjtë dhe në asnjë fe.
2. Në nënkategorinë e dytë renditet idhujtarët, të cilët edhe sot vazhdojnë të adhurojnë statujat dhe idhujt me të gjitha grupet e tyre.
3. Ehlu-l-kitab (ithtarët e librit) çifutët dhe të krishterët, të cilat besojnë në Zotin si Krijues dhe të shumë Pejgamber, por rrëshqasin në idhujtari me disa sosh që nuk kanë qenë Pejgamber, dhe ajo që është më e rëndësishme ata nuk e njohin dhe besojnë Islamin.
4. Hipokritët (munafikët). Këta janë individë që janë me dy fytyra që shfaqen si myslimanë ndërsa e fshehin mosbesimin në zemrat e tyre edhe pse e quajnë veten myslimanë.
5. Ezoterikët (batinijët). Këta individ thonë që i përkasin Islamit, por Islami është larg prej tyre dhe janë armiq të islamit dhe synim kanë që

ta shkatërrojnë Islamin si fe.

6. Mëkatarët janë ajo kategori e myslimanëve që janë zhytur në mëkate gjynahe të cilat i kaun mundur ata dhe se iu kaun dhënë përparësi epsheve e pasioneve të egos së tyre, duke u bërë pjesë e pandashme e ngjarjeve ditore të tyre dhe se djalli i mallkuar ua ka zbukuruar atyre këto "kënaqësi" në mëkate duke ua verbuar sytë e tyre dhe nuk u shkon mendja për pendim dhe largim nga këto cilësi. Besimi i tyre është shumë i dobët dhe duhet një mund i veçantë me këtë kategori që të largohen nga mëkatet dhe t'i kthehen të vërtetës dhe dritës.

7. Të devijuarit. Kjo kategori beson në Allahun xh.sh., si Zot, Kuranin si Libër të Tij, Muhamedin si Pejgamber dhe Islamin si fe, por nuk e kanë kuptuar realitetin e fesë Islame ashtu siç duhet, ndaj dhe kanë devijuar në drejtime dhe në shkallë të ndryshme. Ka prej tyre që kanë rënë në shirk.., ka që janë zhytur në devijime dhe bidate.., ka që e kanë besimin shumë të dobët dhe janë larg zbatimit të fesë ashtu siç duhet. Shumë prej tyre janë njerëz që shkojnë pas dëshirave, e shumë të tjerëve u duket se janë duke vrapuar mirë.. si psh., havarixhët, mutezilijntë e shumë të tjerë të ngjashëm me këta. Në këtë kategori futen edhe liberalistët.

Myslimani vazhdimisht shikon dhe mediton për ata njerëz dhe kolos të mëdhenj të Islamit dhe formën e thellë të kuptimit të vlerave të fesë islame të kohës dhe mësimëve të saj, dhe me këtë shpreh falënderime për Zotin dhe e mbanë gjallë ndjenja pozitive rreth të ardhmes së ndritshme të Islamit. Islami mbetet Islam. Shpirt krijues dhe mendim i ndritshëm, qiri ndriçues dhe forcë e pamposhtur dhe e drejtë ilimuniste.

1. Të përparuarit. Në këtë kategori hyjnë të gjithë ata njerëz myslimanë që kryejnë si duhet detyrimet dhe shumë prej veprave fakultative, u rrinë larg ndalesave ose edhe nëse gabojnë pendohen sinqerisht dhe do të vijnë të pastë dhe pa barrën e mëkateve Ditën e gjykimit. Ku

Allahu xh.sh., thotë: Pastaj Ne u lamë në trashëgim librin robërve Tanë që Ne i kemi zgjedhur; e prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë, e ka prej tyre që janë më ndihmën e Allahut, të parët në punë të mira, kjo është ajo mirësia e madhe. (Fatir, 32).

2. Të kursyerit. Në këtë kategori futen të gjithë ata myslimanë që detyrimet dhe u largohen ndalesave, por nuk rendin për të bërë vepra të mira. Nëse bëjnë ndonjë gjynah, nuk thellohen në të, por shpejt pendohen. Kjo kategori nuk e kanë besimin të plotë dhe janë shkallë të ndryshme, në varësi të punëve që bëjnë.³

Secila nga këto kategori ka shpjegime të shumta, situata të larmishme e gjykime të ndryshme, ku për çdonjërin ka argumente fetare dhe dëshmi reale.

Pse kjo ndarje në këto kategori?

Kjo ndarje në këtë përbërje u bënë me arsyetim që thirrësi gjatë misionin të tij të ketë tablon e qartë për kategoritë e ndryshme të të thirrurve që kryesisht ka të bëjë me shkallën e besimit të tyre si dhe pozicionimet e ndryshme doktrinale ku secilës kategori duhet t'i gjendet kodi i ligjërimit si dhe shkalla e besimit duke përfshirë edhe kategorinë e ateistëve që atyre duhet ligjëruar dhe dialoguar me gjuhën e argumenteve logjike dhe bindëse.

Gjuha e Kuranit po ashtu na ka mësuar sesi duhet t'u ligjërojmë edhe ehlu-l-kitabit (të krishterëve dhe hebrenjve) duke ua shpjeguar dhe ofruar atyre porosinë e Islamit, dërgimin e Muhamedit a.s. s profet të fundit si dhe objektivin mbi të cilin duhet besuar të gjithë të dërguarit e Zotit.

Po ashtu në këtë vazhdë siç e përmendëm duhet ofruar edhe gjuhë e veçantë e bisedimit edhe me kategorinë e të devijuarve ku do tu ofrohet atyre besimi i saktë i referimit fetar, obligimin e të ndjekurit të rrugës së Muhamedit a.s., flakjen e unit dhe dëshirave personale si dhe ndjekjen dhe përmbajtjen e së vërtetës. Kurse kategorisë së mëkatarëve duhet shtruar me ta

bisedën mbi argumentet të cilat ua shtojnë besimin (iman), vlerën dhe dashurin e pastër për Allahun xh.sh, dhe Pejgamberin a.s., dhe të gjitha format e largimit të devijimit nga rruga e drejtë.

A u drejtohet gjuha e Kuranit të gjithë këtyre kategorive?

Një lexim me meditim i ajeteve të tëra kuranore do të gjejmë në të se gjuha e Kuranit famëlartë iu drejtohet të gjithë këtyre kategorive të tilla dhe jo vetëm, duke pasur parasysh nivelin e besimit të tyre apo edhe mohimit të tyre.

Në këtë aspekt duke shikuar ajetet që Allahu xh.sh iu drejtohet të krishterëve dhe çifutëve sipas bindjeve të tyre që e pranojnë Zotin, besojnë disa prej të Dërguarve dhe Librat e Tij, i Lartësuarit iu drejtohet duke iu thënë:

Thuaju (o i dërguar): "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos Allahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)!" (Ali Imran,64).

Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiqësi të fortë kundër kundër besimtarëve (kundër muslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët thanë: "Ne jemi nesarakrishterë". Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë (ulema) dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë. (El Maide,82).

Thuaj: "O ithtarët e Librit! Mos kaloni kufirin në besimin tuaj, në kundërshtimin me të vërtetën dhe mos ndiqni pasionin e një populli, që qysh më parë patën humbur dhe kanë nxjerrë prej udhës së drejtë shumë njerëz dhe vetë janë shmangur nga udha e drejtë". (El Maide,77).

Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit



tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj sesi i kthejnë shpinën të vërtetës! (El Maide,75).

Thuaj: “O ithtarë të librit, ju nuk jeni asgjë (në fe) derisa të mos zbatoni Tevratin, Inxhilin dhe atë që ju zbriti nga Zoti i juaj. E kjo që t’u zbrit ty nga Zoti yt do të shtojë te shumica prej tyre rezistencë e mohim. Po ti, mos u keqëso për popullin që nuk beson. (El Maide,68).

Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj sesi i kthejnë shpinën të vërtetës! (75) Thuaju: A adhuron pos Allahut atë që nuk mund t’ju sjellë as dëm as dobi? Allahu është që dëgjon (ç ‘thoni) që di (ç ‘veproni). (El Maide,74-6).

Por Libri ynë Kurani famë lartë po ashtu u drejtohet pjesëtarëve të fesë islame që kanë kryer mëkate varësisht nga niveli i tyre të besimit që shfaqin dhe ndjejnë për Krijuesin absolut.

Në disa raste në Kuran iu drejtohet atyre në këtë formë të ligjërimit i si p.sh.

Allahu ju këshillon që një e tillë të mos përsëritet kurrë, nëse jeni besimtarë të denjë. Allahu sqaron për ju argumentet, sepse Ai është i dijshtëm e i urtë. (Nur,17-18).

O ju që besuat, keni frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të sinqertë hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga

kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe të dërguarin e Tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve ju takon kryet e mallit tuaj - askë nuk dëmtoni, e as vetë nuk dëmtoheni. (El Bekare,278-279).

Atij që i ka ardhur këshillë (udhëzim) prej Zotit të tij dhe është ndalur (prej kamatës) i ka takuar e kaluar dhe çështja e saj mbetet te Allahu, e kush e përsërit (pas ndalimit), ata janë banues të zjarrit, ku do të mbesin përgjithmonë. (El Bekare,275).

Nga njëherë në ajet të caktuara me anë të mesazheve kuranore an drejtohet duke mbjellë shpresën por edhe frikën në një versët kuranor, ku thotë: Edhe ata që pos Allahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar Allahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi ditën e kiametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë. (Furkan,68-70).

Por, ka nga disa ajete kuranore të cilat u ligjëron duke iu dhënë motiv dhe shpresë.

Njoftoi robërit e Mi se vërtet Unë jam Ai që fal shumë dhe mëshirues i madh. (El Hixhr, 49)

Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e

keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!” (Ez-zumer,53).

O ju që keni besuar, pendohuni te All-llahu me një pendim të sinqertë në mënyrë që Zoti juaj t’i largojë prej jush të këqijat, t’u shpie në Xhenete, nën të cilat rrjedhin lumenj ditën kur All-llahu nuk e turpëron Pejgamberin e së bashku me të as ata që kanë besuar. Drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre, e ata thonë: “Zoti ynë, vazhdona dritën tonë, falna neve. Vërtet, Ti je i plotfuqishëm për çdo send”. (Tahrim,8).

Por shikuar gjithashtu edhe nga këndi profetik hasim në biografinë e Muhamedit a.s., se nuk del jashtë mesazheve dhe porosive kuranore sa i përket ligjërimeve të kësaj natyre me këto kategori të të thirrurish gjatë predikimit të vlerave fetare dhe kulturore të fesë islame, pra iu kanë përshtatur nivelit të tyre të besimit. Psh në këtë drejtim do të mjaftonin të cekim shembuj të kësaj natyre ku Muhamedi a.s. iu drejtohej chu-l-kitabve (të krishterëve dhe çifutëve) me gjuhë ligjërimiti në krahasim me gjuhën të cilën u drejtohej mosbesimtarëve kurejshit. Ai u drejtohej atyre të respektojnë dhe përmbahen mësimet e Tevratit gjegjësisht Biblës të vërtetë dhe në asnjë mënyrë mos ta deformonin at e as shtrembëronin mësimet e tyre, sepse vetëm duke ndjekur ata mësimet e tyre do të kishin besuar.. Në rastin kur disa çifutë iu paraqitën Muhamedit a.s. me një rast kurvërie dhe ai u tha: Të pyes në emër të Allahut, që zbriti Tevratin te Musai, a kështu e keni ndëshkimin për kurvërinë në Librin tuaj?⁴

Pejgamberi a.s.po ashtu kishte shfrytëzuar edhe raste të ndryshme që ata që vizitonin Medinën iu paraqiste mesazhin e Islamit, kështu ishte rasti me delegacionin të krishterët nga Nexhrani, pra, në mënyrë të drejtpërdrejtë për ta njësuar Allahun xh.sh., sepse ata e pranonin që Allahu është një dhe i

vetëm, andaj duke ua shpjeguar atyre mësimet e pastërta historike (islame) se Ibrahim a.s, nuk kishte çifutë e as krishterë, por ai kishte adhuruar Krijuesin Një dhe i ishte nënshtruar vetëm Atij. Andaj me këtë shkak gjejmë se i Dërguari a.s. u kishte shkruar atyre kështu: „Dhe unë ju ftoj në adhurimin e Allahut dhe jo në adhurimin e njerëzve. Ju ftoj të viheni nën pushtetin e Allahut dhe jo nën atë të njerëzve..”⁵

Po ashtu i Dërguari a.s. shfrytëzonte edhe formën e komunikimit me personalitetet botërore, duke iu shkruar atyre shkresa që tua komunikoj mesazhin e fesë islame. Kështu psh në vitin e 7 hixhri, Muhamedi a.s. dërgoi Abdullah ibën Hudhafa Es Sehmi me mesazh për ta ftuar në Islam mbretin pesian Kisraut (Khosroë Parviz sundoi nga 590-628) nga mbretëria e sasave. Ai nga mendjemadhësia i grisi shkresën e të Dërguarit dhe e përqeshi atë. Pas një kohe shumë të shkurtër, Allahu xh.sh., e shkatërroi Kisraun dhe e shpartalloi pushtetin e tij, për të mos u ngritur kurr më perandoria e tij. Por shkresat nuk ishin të njëjta, p.sh Kisrau ishte adhures i zjarrit, nuk i ngjante letrës së që i dërgoi mbretit të Abisinisë, Nexhashiut, që ishte i krishterë.⁶

Por edhe në këndin e brendshëm Muhamedi a.s. tregonte dhembshuri në ligjëratë dhe këshilla. Kur shokët e tij bënin ndonjë mëkat, u fliste për besimin (imanin) dhe ua kujtonte dashurin dhe mëshirën e të Gjithëmëshirshmit,

Abdullah bin Mugafel rrëfen se si një burë takoi në rrugë një grua që kishte qenë e përdalë në kohën e injorancës, para ardhjes së Islamit, dhe e filloi të argëtohej me të deri sa zgjati dorën drejt saj dhe ajo tha: “Mos! Allahu na e largoi shirkun (një variant tjetër: na e largoi injorancën) dhe na solli Islamit.” Burri u kthye, por u përplas me fytyrë pas murit dhe u plagos. Më pas ai shkoi te Muhamedi a.s. dhe i tha çfarë i kishte ndodhur. Muhamedi a.s. i tha: “Ti je një njeri që Allahu të do të mirën. Kur Allahu i do të mirën një njeriu, ia shpejton dënimin e gabimit të tij që në këtë

botë dhe kur nuk ia do të mirën, ia ruan gjynahun që t’ia japë hakun Ditën e Kiametit si të ishte një mal.”⁷

Jo vetëm kaq por Muhamedi a.s. na la mësim të vyeshëm për në tërë jetën sesi duhet tu drejtohem në komunikim njerëzve, duke pasur parasysh edhe materializmin e tyre por edhe besimin. Këtu historia islame ka regjistruar dy ngjarje me këtë përmbajtje. Suraka bin Malik kishte zemër të zbrazët (materialist) nga besimi, kurse Omeri r.a., kishte besim të plotë. Historia na ka regjistruar ngjarjen e Surrakës (vdiq më 24h, -645) i cili shkoi në ndjekje të Muhamedit a.s., në kohën kur emigroi për në Medinë, që të merrte shpërblimin që patën premtuar Kurejshët për kapjen e Muhamedit a.s.. Kur Surraka mbërriti Profetin, ai i kërkoi të mos tregonte për të dhe Ebu Bekrin dhe do t’i jepte si shpërblim material diçka që në atë kohë më shumë ishte një iluzion sesa reale... I Dërguari a.s., i tha: “Dhe ja unë e parashoh kur ti të kesh vënë byzlykët e Kisras.”⁸

Kurse për imanin e Omerit tregohet se ai njëherë hyri në dhomën e Muhamedit a.s., dhe vuri re se hasra mbi të cilin rrinte, i kishte lënë gjurmë në trup. Umerit i erdhi keq dhe filloi të qante, ndërsa Muhamedi a.s. i tha:

-Pse qan?

-O i Dërguar i Allahut, Kisrau dhe Çezari jetojnë si jetojnë, ndërsa ti je i Dërguar i Allahut dhe ..?

-A nuk je i kënaqur që atyre t’u përkasë kjo botë dhe ne bota tjetër?!- thotë i Dërguari a.s.,⁹

Përgjigja që i Dërguari a.s. i dha Surrakës, ndryshoi shumë nga ajo që i dha Omerit. Herën e parë ai bëri një premtim që i përket kësaj bote, ndërsa herën e dytë një premtim që i përket botës tjetër, pse ky ndryshim. Pse nuk i tha Surrakës se do të hysh në Islam dhe do të kesh si shpërblim Xhenetin?! Pse nuk i tha Umerit r.a., se do të jetë prijës i madh dhe pushtetar i fuqishëm që do të ketë në zotërim që çka sundon sot Cezari dhe Kisrau?!

Kjo rrjedhte në sajë të faktit se Muhamedi a.s. gjatë komunikimit

me njerëz kishte parasysh nivelin e besimit të atij që fliste. Në këtë rrjedhojë Surraka kishte dalë për ta gjurmuar Profetin për pasuri dhe nuk i kushtonte rëndësi besimit në atë kohë. Për të nuk kishte peshë të veçantë Xheneti, ndaj nuk ishte e volitshme që t’i thuhej: Do jesh besimtar dhe do të hysh në Xhenet. Shpirti i tij në atë kohë ishte i dhënë pas kësaj bote, që edhe qëllimi tij kur e ndoqi Muhamedin a.s. nga pas. Kështu i Dërguari a.s., i foli Surrakës duke i premtuar shpërblim material ”byzlykët e Kisras”, sepse kjo i përshtatej pikësynimit të tij kryesor në atë kohë dhe Surraka e njëjtte të Dërguarin a.s., si njeri të sinqertë dhe i mbante premtimet që jepte. Ndërsa Omeri kishte një shpirt besimtar, për të kjo botë nuk kishte asnjë vlerë përpara kënaqësisë së Allahut dhe Xhenetit të Tij, ndaj i duhej folur në përshtatje me shpirtin që kishte. Muhamedi a.s. i tha: “A nuk je i kënaqur që atyre t’u përkasë kjo botë dhe ne bota tjetër”.

Kështu ishin praktikatat e Muhamedit a.s. me sahabet, pabesimtarët, të krishterët, çifutët dhe të gjithë njerëzit.

Edhe në jetën tonë duhet të kemi parasysh këtë realitet që t’i jetësojmë këto veprime të arta që na i ka lënë i Dërguari a.s. veçantë duhet të tregojmë ndjesi më myslimanët e rinj të cilët posa kanë pranuar islamit apo kanë filluar ta praktikojnë Islamit në jetën e tyre. Të jepi të hapur me ta, të dimë dhe t’i radhisim gjërat sipas fikhut të prioriteteve duke vazhduar për më tej.

1. Gušlav le Bon, Psikologjia e popujve dhe e turmave, Tiranë, Fan Noli”, f.4. 2. Buhariu, kitabul-edebe, 28/8, nr. 6114 dhe Muslimi kitabul-birres-sileve-l- adab, 4/2021, nr.2609. 3. Adnan Al Araur, Menhexh ed-da’ ve fi dev’i el vaki el muasir, Tiranë, 2009, Tradita, f.99. 4. Muslimi, 1700. 5. Siretu Ibn Hisham, Dar Ihja, et-turaath el islami, Bejrut, bot.1, v.2, f.215, Bejrut, 1995. Ebi el Fida el Hafidh ibn Kethir Ed-dimeshki, El Bidaje ve nihaje, Dar el kutub el ilmije, bot. 1, v.5, f.52, Bejrut, 1994. 6. Siretu ibn Hisham, Ibid. 4/330. Ibn Kajim el Xhevzije, Zadu-l-mead, Muesetu errisale, bot.26, 1992, v.3, f.688. 7. Ahmedi, 4/87, Ibn Hibban 2911. 8. El Isabetu, 3/41, El Bejheki fu sunen el kubra, 6/357. 9. Buhariu 4913, Muslimi 1479.

Gary Miller

Kurani i mrekullueshëm (3)

“A nuk e konsiderojnë ata Kurantin? Nëse do të kishte qenë nga tjetërkush përveç Allahut, ata me siguri që aty do të kishin gjetur shumë mospërputhje.” (En-Nisa, 82).

Ashtu siç e kemi përmendur tashmë, Kurani përmban shumë informacione, i cili nuk mund t'i atribuohet kujt tjetër veç Allahut. Për shembull, kush i tha Muhamedit për murin e Dhul Karnejnit, - një vend me qindra kilometra në veri? Kush i tregoi atij për embriologjinë?

Kur njerëzit mbledhin fakte të tilla si këto, nëse ata nuk dëshirojnë t'ia atribuojnë ekzistencën e tyre një burimi hyjnor, ata menjëherë ia ngjisin automatikisht supozimin se dikush ia ka dhënë informacionin Muhamedit dhe se ai e përdori atë të marroste njerëzit. Sidoqoftë kjo teori mund të hidhet poshtë vetëm me një pyetje të thjeshtë: “Nëse Muhamedi do të ishte gënjeshtar, ku e gjeti ai këtë besim? Përse ai u tha disa njerëzve mu në sy atë që të tjerët nuk do ta kishin thënë kaq lehtësisht?” Ky lloj besimi varet krejtësisht mbi bindjen se ti ke me të vërtetë shpalljen hyjnore. Për shembull, Profeti Muhamed kishte një xhaxha që quhej Ebu Leheb. Ky njeri e urrente aq shumë Islamin, sa që ai e ndiqte Profetin a.s. gjithandej për ta diskredituar atë. Nëse Ebu Lehebi e shihte Profetin të fliste me një të huaj, ai do të priste sa Muhamedi të largohej dhe më pas do t'i shkonte të huajit dhe do ta pyeste: “Çfarë të tha ai? A të tha: E bardhë? E po është e zezë. A të tha: Mëngjes? E po është natë.” Ai thoshte krejtësisht të kundërtën të asaj çka thoshte Muhamedi a.s. dhe asaj që thonë myslimanët. Sidoqoftë rreth 10 vjet

përpara se të vdiste Ebu Lehebi, një kaptinë shumë e shkurtër iu shpall Muhamedit. Ajo në mënyrë të qartë shpall se Ebu Lehebi do të shkojë në zjarr (ferr). Me fjalë të tjera aty shpallet se ai nuk do të bëhet kurrë mysliman dhe prandaj ai do të dënohet përgjithmonë. Për 10 vjet rresht Ebu Lehebi pati mundësinë të thoshte: “Unë kam dëgjuar, se i është shpallur Muhamedit që unë nuk do të ndryshoj kurrë, që unë nuk do të bëhem kurrë mysliman dhe do të hyj në zjarrin e Xhehenemit. Epo unë do të bëhem mysliman tashti. Si do t'ju duket kjo? Çfarë keni për të thënë për Shpalljen Hyjnore tashti?” Por ai nuk e bëri kurrë atë dhe kjo është saktësisht ajo lloj sjellje që dikush pret prej atij që e kundërshton Islamin. Në thelb Muhamedi a.s. thotë: “Ti më urren mua dhe kërkon

të më zhdokësh mua? Ja, thuaji ato fjalë dhe unë jam i mbaruar. Jepi pra, thuaji!” Por Ebu Lehebi kurrë nuk i tha ato fjalë. Dhjetë vjet! Dhe gjatë gjithë kësaj kohe ai kurrë nuk e pranoi Islamin, apo edhe sikur të tregonte simpati për kauzën e Islamit. Si mund ta dinte Muhamedi me siguri, që Ebu Lehebi do të përmbushte profecitë kuranore, nëse ai nuk do të ishte me të vërtetë i Dërguari i Allahut? Si mund të ishte ai kaq i sigurt, sa t'i jepte dikujt dhjetë vjet për ta diskredituar pretendimin e tij të profecisë? Përgjigja e vetme që mund të jepet është se ai ishte i Dërguari i Allahut; me qëllim që dikush të jetë i sigurt në sfidën e tij, ai duhet të jetë krejtësisht i bindur që ka në dispozicion Shpalljen Hyjnore.

Një shembull tjetër i besimit të



Muhamedit a.s., që kishte në profecinë e tij dhe për pasojë edhe në mbrojtjen hyjnore për atë vetë dhe mesazhin e tij është kur ai u largua nga Meka dhe u fsheh në një shpellë me Ebu Bekrin gjatë shpërnguljes së tyre për në Medinë. Që të dy panë me sytë e tyre se si po kërkonin t'i vrisnin ata dhe Ebu Bekri u frikësua. Natyrisht që nëse Muhamedi a.s. do të ishte gënjeshtar, një falsifikues dhe dikush që përpiket t'i marrosë njerëzit që ta besojnë atë si profet, nga një njeri i tillë pritet që në rrethana të tilla t'i thotë shokut të vet: "Shih Ebu Bekër, se mos na nxjerr nga kjo shpellë!" ose "Vendosu në atë qoshe dhe mos u ndej më!" Ndërsa në fakt ajo që ai i tha Ebu Bekrit tregon qartë besimin e tij. Ai i tha atij: "Qetësohu! Allahu është me ne dhe Allahu do të na shpëtojë ne!"

Tashti, nëse ndokush e di që po e marros popullin, ku e gjen ai atë lloj qëndrimi? Kjo lloj mendje nuk është karakteristike për një gënjeshtar, apo për një falsifikues. Kështu siç edhe e kemi përmendur më sipër, jomyslimanët i shkojnë rreth e përqark një rrethi vicioz, duke kërkuar një rrugëdalje, ndonjë mënyrë për të shpjeguar zbulimet në Kuran pa ia atribuuar ato vetë burimit të tyre. Nga njëra anë ata ju thonë juve të hënën, të mërkurën dhe të premten: "Ai burrë është gënjeshtar!", nga ana tjetër të martën, të enjten dhe të shtunën ata të thonë: "Ai është i marrë!". Ajo që ata nuk pranojnë është se dikush nuk mund t'i ketë të dyja; tashmë refuzimi i tyre se dikush nuk mund t'i ketë të dyja këto cilësi; gjithashtu ata kanë nevojë për këto dy shfajësime që të shpjegojnë informacionet që gjenden në Kuran.

Rreth shtatë vjet më parë, unë kisha për vizitë në shtëpinë time një pastor protestant. Në dhomën ku ne po qëndronim kishte një Kuran mbi tavolinë, i përmbysur, kështu që pastori nuk e dinte se çfarë libri ishte. Në mes të diskutimit unë tregova Kuranin dhe thashë: "Unë besoj tek ai libër." Duke parë nga Kurani, por

pa e ditur se cili ishte ai libër, ai u përgjigj: "Epo, jua them unë, nëse ai libër nuk është Bibla, ai është shkruar nga një njeri." Në përgjigje të kësaj deklarate unë i thashë: "Më le të të them se çfarë ka në atë libër!" dhe vetëm në tre apo katër minuta unë i rrëfeva atij për pak gjëra që gjenden në Kuran. Pas atyre tre a katër minutave, ai ndërroi krejtësisht pozicion dhe deklaroi: "Ti ke të drejtë. Një njeri nuk mund ta ketë shkruar atë. Djalli e shkroi atë!" Në të vërtetë është për të ardhur keq për këtë lloj qëndrimi për shumë arsye. Veçanërisht për një gjë, ishte një justifikim i shpejtë dhe i varfër. Është një rrugëdalje e menjëhershme nga një gjendje e parehatshme. Faktikisht në Bibël gjendet një histori shumë e famshme që na tregon se si një ditë disa jehudi qenë dëshmitarë kur Jezusi ringjalli nga vdekja një burrë. Ky burrë kishte katër ditë që kishte vdekur dhe kur shkoi tek ai Jezusi, ai i tha thjesht: "Ngrihu!" dhe burri u ngrit e iku. Nga kjo skenë disa jehudi që po e ndiqnin me mosbesim thanë: "Ky është djalli. Ai që po e ndihmon është djalli." Tashti kjo histori përsëritet shpesh në të gjitha kishat e botës dhe njerëzit derdhin lot kur e dëgjojnë dhe thonë: "Ah sikur të kisha qenë unë atje, unë nuk do të isha treguar budalla sa jehuditë!" Çfarë ironie, këta njerëz bëjnë pikërisht atë që bënë jehuditë, kur ti në tre apo katër minuta ju tregon vetëm një pjesë të vogël të Kuranit dhe kur ti e bën ata thonë: "Ah, djalli e ka bërë këtë! Djalli e ka shkruar atë libër!", sepse ata janë rrasur në një qoshe dhe nuk gjejnë rrugë shpëtimi për t'u përgjigjur, e kështu ata gjejnë strehim në përgjigje të pamenduara dhe të varfra. Një shembull tjetër i qëndrimeve të dobëta të njerëzve mund ta gjesht shpjegimet e mekasve për burimet e mesazhit të Muhamedit. Ata thoshin vazhdimisht: "Djali ia solli Muhamedit atë Kuran!", por për çdolloj sugjerimi të bërë Kurani jep përgjigjen. Një ajet veçanërisht shpall: "Dhe ata thonë: Sigurisht që

ai është i mbizotëruar nga xhinët, por ai (Kurani) është një përkujtues për botën."

Kështu na jepet një argument për teori të tilla. Në fakt ka shumë përgjigje të tilla në Kuran në përgjigje të këtyre sugjerimeve, që djalli ia solli Muhamedit mesazhin e tij:

"Askush nga shejtanët e zbriti atë (Shpalljen). Ajo nuk u shkon për shtat atyre, as nuk janë të aftë për të. Në të vërtetë ata janë shumë larg bindjes." (Esh Shuara, 210-212).

Dhe në një vend tjetër në Kuran Allahu na udhëzon ne: "Kështu që kur të lexoni Kuranin kërkoni mbrojtjen e Allahut nga shejtani i përbuzur." (En-Nahl, 98).

Atëherë a mund të më thoni, se kështu e shkruan djalli – shejtani librin? A mund t'i thotë ai ndonjërit nga ju: "Përpara se të lexoni librin tim kërkoni Zotit t'ju ruajë prej meje?...". Ky është me të vërtetë një veprim shumë dredharak. Me të vërtetë që dikush mund ta shkruante një gjë të tillë, por a do ta bënte një gjë të tillë shejtani? Shumë njerëz na thonë se ata nuk mund të dalin në një përfundim për këtë temë. Nga njëra anë ata thonë se shejtani nuk mund ta ketë bërë këtë gjë, edhe sikur ta kishte pasur mundësinë ta bënte, Zoti nuk do ta lejonte ta bënte një gjë të tillë; dhe nga ana tjetër ata gjithashtu besojnë se shejtani është diçka më pak se Zoti. Në thelb ata pohojnë, se ndoshta shejtani mund të bëjë atë që e bën edhe Zoti. Dhe si rezultat kur e marrin Kuranin, edhe pse mbeten të befasuar ngaqë ai është i mrekullueshëm, ata vazhdojnë të këmbëngulin: "Djali e ka bërë këtë!" Falënderimet e posaçme i takojnë vetëm Allahut, myslimanët janë larg këtij qëndrimi. Megjithatë shejtani ka aftësitë e veta, ato janë jashtëzakonisht larg dhe ndryshe nga ato të Allahut të Lartësuar. Dhe asnjë mysliman nuk mund të jetë mysliman, nëse nuk beson kështu. Është diçka shumë e njohur edhe ndërmjet jomyslimanëve, se djalli shumë lehtësisht është i gabueshëm dhe nga ai pritet që ta kundërshtojë

vetveten, nëse ai do të shkruante një libër.

Me të vërtetë që në Kuran shpallet: “A nuk e konsiderojnë ata Kurandin? Nëse do të kishte qenë nga tjetërkush përveç Allahut, ata me siguri që aty do të kishin gjetur shumë mospërputhje.” (En-Nisa, 82).

Në lidhje me justifikimet që jomyslimanët nxjerrin në përpjekjet e kota për t’u justifikuar me ajetet e pashpjegueshme në Kuran është një sulm tjetër i tyre që bëhet duke i kombinuar që të dyja teoritë, se Muhamedi a.s. ishte i marrë dhe gënjeshtar. Në themel, këta njerëz propozojnë se Muhamedi ishte i papërgjegjshëm dhe si rezultat i zhgënjimit që pësoi ai gënjeu dhe i mashtroi njerëzit. Në psikologji ky lloj fenomeni emërtohet ndryshe dhe atij i referohet si mitomani. Me këtë nënkuptohet thjesht, se dikush thotë gënjeshtër dhe pastaj i beson ato vetë. Kjo është ajo gjë prej së cilës vuajti Muhamedi a.s., thonë jomyslimanët. Por i vetmi problem që shkakton ky propozim është se ai që vuan nga mitomania absolutisht nuk është në gjendje të merret me faktet reale, ndërsa Kurani i gjithi është i ndërtuar krejtësisht mbi fakte të vërteta. Çdo gjë që ai përmban mundet që ta hulumtosh dhe ka për të dalë e vërtetë. Meqë faktet reale janë një problem për mitomanin, kur një psikolog përpiqet ta trajtojë atë që është në këtë gjendje, ai vazhdimisht e ballafaqon atë me faktet. P.sh., nëse ndonjëri është i sëmurë mendërisht dhe pretendon se: “Unë jam mbreti i Anglisë!”, një psikolog i vërtetë nuk i thotë atij: “Jo, ti nuk je. Ti je i marrë.” Ai thjesht nuk e bën një gjë të tillë. Më mirë ai e ballafaqon atë me faktet duke i thënë: “Në rregull, ti thua se je mbreti i Anglisë. Atëherë më thuaj ku e ke mbretëreshën sot? Ku e ke kryeministrin? Ku i ke rojet e tua?” Kur ky burrë përpiqet me vështirësi t’i japë përgjigje këtyre pyetjeve, ai përpiqet të gjejë shfajësim si fjala vjen: “Hëm,... mbretëresha,... ajo ka shkuar te nëna e vet. Hëm,... kryeministri, ... ai ka vdekur.”

Mundësisht ai ka për t’u kuruar për mungesën e aftësisë së pranimit të fakteve reale. Nëse psikologu vazhdon ta ballafaqojë atë me fakte të mjaftueshme më në fund ai do ta shohë realitetin dhe do të thotë: “Them se nuk jam mbreti i Anglisë!” Qasja e Kuranit ndaj kujtdo që e lexon atë në pjesën më të madhe është e njëjta mënyrë, se si e trajton një psikolog pacientin e vet mitoman. Në Kuran gjendet një ajet, i cili shpall: “O ju njerëz, ju ka ardhur juve një paralajmërim (Kurani) nga Zoti juaj dhe një shërim për atë që keni në zemër, dhe udhëzim e mëshirë për besimtarët.” (Junus, 57).

Në një shikim të parë kjo shpallje duket e mjegullt, por kuptimi i këtij ajeti është i qartë, kur dikush e shikon nën dritën e shembullit të sipërpërmendur. Në thelb kjo do të thotë se dikush shërohet nga deziluzionet e tij kur lexon Kurandin, pra, një terapi për atë që e lexon. Ai, fjalë për fjalë i kuron njerëzit nga deziluzioni, duke i ballafaquar ata me faktet reale.

Një qëndrim mbizotërues përgjatë të gjithë Kuranit është ai ku thotë: “O ju njerëz, ju thoni kështu e ashtu për këtë gjë, por çfarë për kështu e ashtu; si mund të thoni kështu ju, kur ju e dini?” e kështu vazhdon. Ai e detyron lexuesin të konsiderojë se cila është e përshtatshme dhe kush ka vlerë, ndërsa në të njëjtën kohë shëron njerin nga deziluzionet, që faktet e paraqitura nga Allahu njerëzimit mund t’i shpjegohen lehtësisht me teori bindëse dhe justifikime. Është pikërisht kjo gjë – ballafaqimi i njerëzve me faktet – që ka tërhequr vëmendjen e shumë jomyslimanëve. Në fakt kemi edhe një referencë shumë interesante për këtë subjekt në “Enciklopedinë e Re Katolike”.

Nën zërin e titulluar Kuran, Kisha Katolike shpall: “Gjatë shekujve, shumë teori na janë ofruar si origjina e Kuranit... Sot asnjë njeri i arsyeshëm nuk do të pranonte ndonjë nga këto teori.” Ja, ku kemi këtu Kishën e vjetër Katolike, e cila është përpjekur



kaq shekuj të mohojë këto përpjekje të kota për të interpretuar Kurandin. Me të vërtetë që Kurani është një problem për Kishën Katolike. Ai deklaron se është Shpallje Hyjnore, prandaj ju duhet ta studioni atë. Natyrisht që ata do të kërkonin të gjenin prova për jo, por ata nuk mund të gjejnë. Ata nuk mund të gjejnë një shpjegim të përshtatshëm, por të paktën janë të ndershëm në kërkimet e tyre dhe ata nuk e pranojnë interpretimin e parë të pathemeltë që iu ofrohet. Natyrisht njerëzit e tjerë janë shumë më pak të ndershëm. Ata menjëherë të thonë: “Oh, Kurani vjen prej këndeje; apo Kurani vjen andej!” dhe kështu ata nuk e shqyrtojnë vërtetësinë e asaj që thonë në pjesën më të madhe të kohës. Së fundmi një njeri i kishës me emrin Hans dhe ai dha mendimin e tij për atë që kishte lexuar. Ky njeri kishte qenë rreth botës lart e poshtë dhe gëzonte edhe respekt të madh në Kishën Katolike. Pas një shqyrtimi të kujdesshëm ai raportoi për gjetjet e tij duke konkluduar: “Zoti i ka folur një njeriu nëpërmjet një njeriu, Muhamedit!” Përsëri ky është një konkluzion i arritur nga një burim jomysliman, nga një intelektual i krishterë.

Ashtu siç na u bë e qartë nga informacionet e sipërpërmendura, të gjitha mundësitë e mundshme u



shteruan, prandaj shansi për të gjetur një mundësi tjetër për ta nxjerrë nga loja Kuranin është jo-ekzistente. Por nëse nuk do të ishte shpallje, atëherë do të ishte një mashtrim; dhe nëse do të ishte një mashtrim, atëherë me të drejtë dikush do të pyeste: “Cila është origjina e tij?” dhe “Ku na mashtron ai neve?” në fakt përgjigjet e sakta të këtyre pyetjeve hedhin dritë në autenticitetin e Kuranit dhe i bëjnë të heshtin pretendimet e pathemelta të hidhura të jobesimtarëve. Natyrisht që nëse ka njerëz që vazhdojnë të këmbëngulin se Kurani nuk është i vërtetë, atëherë ata duhet të sjellin fakte për ta mbështetur këtë pretendim. Barra e provave mbetet mbi ta e jo mbi ne. Nuk mund të supozojmë që dikush të paraqesë një teori pa pasur fakte të mjaftueshme, kështu që ne i themi këtyre njerëzve: “Na tregoni një të pavërtetë! Na tregoni se ku gënjën Kurani! Na tregoni, përndryshe mos thoni se ai ka të pavërtetë!”

Një karakteristikë interesante e Kuranit është se si ai merret me fenomenet befasuese, të cilat lidhen jo vetëm me të shkuarën, por po aq edhe me të tashmen. Në thelb Kurani nuk është një problem i vjetër. Ai mbetet një problem edhe sot e kësaj dite, një problem për të gjithë jomuslimanët. Për çdo ditë, për çdo javë, për çdo vit, ai sjell përherë e më

tepër fakte, që Kurani është një forcë me të cilën nuk hahesh dot, se autenticiteti i tij nuk mund të sfidohet më. Për shembull, një ajet në Kuran thotë: “A nuk e dinë jobesimtarët se qiejt dhe toka ishin të bashkuara, pastaj ne i ndamë veçmas dhe Ne i bëmë prej uji të gjitha gjallesat? A nuk besojnë më pas ata?” (El-Enbija, 30).

Çfarë ironie, për këtë informacion të saktë ata shpërblyen me çmimin Nobel në vitin 1973 një dyshe jobesimtarësh. Kurani na zbulon origjinën e universit, se si ai nisi nga një copëz, dhe njerëzit vazhdojnë të verifikojnë këtë zbulim edhe tashti. Veç kësaj fakti se e gjithë jeta e ka origjinën nga uji nuk ka qenë një gjë e lehtë për t'i bindur njerëzit e 14 shekujve më parë. Sigurisht që nëse ju do të qëndronit në mes të shkretëtirës 1400 vjet më parë dhe t'i thoshit dikujt: “E gjitha kjo (dhe të tregojë nga vetja) në pjesën më të madhe është e përbërë nga uji.”, askush nuk do t'ju besonte. Kjo gjë u provua pasi u shpik mikroskopi. Atyre iu desh të prisnin derisa të zbulonin se citoplazma, substanca themelore e qelizës është e përbërë nga 80% ujë. Megjithatë ky fakt doli në dritë, edhe një herë Kurani i bëri ballë testit të kohës. Në lidhje me testet e falsifikimit që i përmendëm më sipër është me të vërtetë interesante që të vërejmë se edhe ato gjithashtu i referohen të shkuarës dhe të ardhmes. Disa prej tyre janë përdorur për të ilustruar plotfuqishmërinë dhe dijen e Allahut, ndërsa disa të tjerë vazhdojnë të qëndrojnë si sfida edhe sot e kësaj dite. Një shembull i gjallë i kësaj është shpallja që i bëhet në Kuran Ebu Lehebit. Aty na ilustron qartësisht, se Allahu njohësi i së padukshmes, e dinte se Ebu Lehebi nuk do të ndërronte mendje dhe të pranonte Islam. Kështu Allahu e kishte vendosur, që ai do të qëndronte i dënuar përgjithmonë në zjarrin e Xhehenemit. Një sure e tillë tregon kthjellësisht, edhe për urtësinë hyjnore të Allahut të Madhëruar,

edhe njëkohësisht është një paralajmërim i vazhdueshëm për ata që janë si Ebu Lehebi.

Një shembull tjetër interesant i këtij tipi testi falsifikimi që gjendet në Kuran është ajeti, ku përmenden marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve dhe jehudive. Ajeti është i kujdesshëm të mos e kufizojë qëllimin e tij në marrëdhëniet individuale të anëtarëve të secilës fe, por më tepër ai përmbledh marrëdhëniet ndërmjet dy grupeve të njerëzve në total. Në thelb Kurani shpall se të krishterët do t'i trajtojnë gjithnjë më mirë myslimanët, se sa do t'i trajtonin jehuditë, myslimanët. Në fakt, efekti i plotë i kësaj deklarate mund të ndjehet pasi të merret me kujdes në konsideratë kuptimi real i këtij ajeti. Është e vërtetë që shumë të krishterë dhe shumë jehudi janë bërë myslimanë, por në total komuniteti jehudi duhet parë si një armik i ashpër i Islamit. Veç kësaj shumë pak njerëz e dinë, se për çfarë të fton një deklaratë e tillë në Kuran. Në thelb ai është një shans shumë i kollajshëm për jehuditë që ata të provojnë se Kurani është fals dhe që nuk është shpallje hyjnore. E gjithë ajo çka duhet të bëjnë ata është të organizojnë vetveten, t'i trajtojnë myslimanët mirë për pak vjet dhe pastaj të thonë: “Tashti ç'mund të na thotë libri juaj i shenjtë, se kush janë miqtë tuaj më të mirë: jehuditë apo të krishterët? Shikoni se çfarë kemi bërë ne jehuditë për ju!” Kjo është ajo çka duhet të bëjnë për të përgënjeshtruar autenticitetin e Kuranit, por ato edhe pas 1400 vjetësh nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Por si gjithmonë oferta vazhdon të mbetet e hapur!

Të gjithë shembujt e dhënë deri tani që kanë të bëjnë me këndet e ndryshme që dikush i qaset Kuranit pa dyshim kanë qenë të natyrës subjektive; megjithatë ekziston një kënd tjetër ndërmjet të tjerash, i cili është objektiv dhe baza e tij është në matematikë...

Përkthyer: Eni Tahiri dhe Roald A. Hysa.

Nexhmi Hoxha

Madhështia e durimit në Kuranin fisnik (2)


“Ti bën durim, se premtimi i Allahut është i vërtetë, kërko falje për mëkatin tënd, lartësoje me falënderim Zotin tënd mbrëmje e mëngjes.” (Gafir, 55)

Pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi a.s. krahas vështirësive të thirrjes, ai vazhdimisht u motivua dhe u shoqërua nga ajetet e durimit nga ana e Allahut xh.sh.. Ndonëse misioni i tij po haste në vështirësi, njëkohësisht rritej edhe numri i urdhëresave drejtuar atij që të jetë i durueshëm. Ajetet e tilla që urdhërojnë për durim drejtuar Pejgamberit a.s., në Kuranin fisnik mund t'i gjejmë në njëzet vende, e që në tetëmbëdhjetë vende prej tyre, shprehja “duro” vjen në formë të udhëzimit.¹

Ajetet kuranore drejtuar Pejgamberit a.s. që të jetë i durueshëm

Vështruar nga aspekti kronologjik, këto ajete i gjejmë në këtë formë: “Ti ec pas asaj që të shpallet dhe bëhu i durueshëm derisa Allahu të gjykojë. Ai është më i miri i gjykatësve.” (Junus, 109)

Në kaptinën Hud, Allahu e urdhëroi Pejgamberin a.s. që të jetë i durueshëm, pasi që paraprakisht e informoi me atë se çfarë ka ndodhur me Nuhun a.s. dhe me të birin e tij: “Këto janë disa nga rrëfimet e panjohura (për ty), që po t'i shpallim, e që para këtij (Kuranit) nuk i ke ditur as ti as populli yt. Pra, të jesh i durueshëm se përfundimi (i lavdishëm) është për të devotshmit.” (Hud, 49)



Allahu xh.sh. i drejtohet Pejgamberit a.s., që përveçse ai të jetë i durueshëm, Ai kërkon po ashtu që edhe thirrja e tij të jetë me mirësi, dialog dhe me urtësi.

“Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.” (En-Nahl, 125)

Në suren El-Kehf: “Përkuftizoje veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote...” (El-Kehf, 28)

Në suren Ta Ha: “Prandaj, ti bëhu i durueshëm ndaj asaj që thonë ata, dhe duke falënderuar Zotin tënd, falu para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij, falu edhe në orët e natës dhe në skajet e ditës, ashtu që të gjesh kënaqësi (me shpërblim).” (Ta Ha, 130)

Në ajetin e fundit të sures Er-Rrum:

“Ti pra bën durim, pse premtimi i Allahut është i saktë, e kurrsesi të mos luhatin ty ata që janë të dyshimtë.” (Er-Rrum, 60)

Në suren Sad: “Ti duro ndaj asaj që thonë ata, dhe përkufto robin Tonë, Davudin, të fuqishëm (në fe e në trup), vërtet ai gjithnjë i drejtohej Allahut.” (Sad, 17)

Urdhrin për durim e gjejmë të përmendur dy herë në suren Gafir: “Ti bën durim, se premtimi i Allahut është i vërtetë, kërko falje për mëkatin tënd, lartësoje me falënderim Zotin tënd mbrëmje e mëngjes.” (Gafir, 55); “Ti pra bëhu i durueshëm, premtimi i Allahut është i vërtetë. E Ne ose do të bëjmë të shohësh diçka nga ajo që u premtojmë atyre, ose do ta marrim jetën (pa parë asgjë), e ata vetëm te Ne do të kthehen.” (Gafir, 57)

Allahu i Madhëruar nuk e ka urdhëruar të Dërguarin a.s. që të marrë shembëlltyrë nga pejgamberët e mëparshëm në ndonjë etikë morale, përveçse në durim, gjë që tregon pozitën e lartë, domosdoshmërinë dhe vështirësitë

që paraqet durimi për shpirtin njerëzor. Për këtë, Allahu xh.sh. në ajetin e fundit të sures El-Ahkaf, ka thënë: “Ti (Muhamed) duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta...” (El-Ahkaf, 35)

Në suren Kaf: “Po ti (Muhamed) me durim përballo atë që ata thonë, para lindjes së diellit dhe para perëndimit madhëro me falënderim Zotit tënd.” (Kaf, 39)

Në ajetin e parafundit të sures Et-Tur, i cili në vete përmban edukim, përforsim, qetësim dhe kënaqësi për të Dërguarin a.s.. Ajo që i përmban gjitha këto është pjesa e ajetit “... se ti je nën mbikëqyrjen Tonë...”, e ai që gjendet nën mbikëqyrjen e Allahut, padyshim se është prej të shpëtuarve dhe nuk do të jetë prej të humburve.² “Ti bën durim në vendimin e Zotit tënd, se ti je nën mbikëqyrjen Tonë dhe kur të ngrihesh madhëroje me falënderim Zotit tënd.” (Et-Tur, 48)

Në suren El-Kalem: “Po ti bëhu i durueshëm ndaj caktimit të Zotit tënd, e mos u bë si ai i peshkut në kohën kur pat thirrur (Zotin) dhe ishte i mllëfosur.” (El-Kalem, 48)

Në suren El-Mearixh: “Ti pra duro, me një durim pa ankesë (të mirë).” (El-Mearixh, 5)

Në suren El-Muzzemil: “Dhe kij durim ndaj asaj që të thonë dhe largohu atyre i matur.” (El-Muzzemil, 10)

Kjo shprehje në Kuranin fisnik përmendet në katër vende, gjë që tregon se fjalët dhe ofendimet drejtuar Pejgamberit a.s., siç ishin i marrë, magjistar, gënjeshtar... etj., kishin lënë gjurmë të thella në zemrën e tij.

Në suren El-Mudethir: “Dhe për hir të Zotit tënd duro.” (El-Mudethir, 7).

Sipas Jusuf Kardavit, ky ajet ka dy domethënie, e para se njeriu duhet të ketë durim deri në përcaktimin dhe gjykimin e Allahut, dhe e dyta që duhet të jemi të durueshëm për Allahun, e

jo për ndonjë tjetër apo diç tjetër, që do të thotë se kërkohet sinqeritet në durim, duke e bërë atë vetëm për Allahun.³

Pejgamberët, sinonim të durimit

Gjatë misionit të tyre fisnik, të gjithë të dërguarit ishin të sprovuar me sprovë të ndryshme. Në Kuranin fisnik, Allahu i Madhëruar përmend disa nga pejgamberët të cilët në misionin e tyre hasën në vështirësi të ndryshme.

Ejubi a.s.

Emri i Ejubit a.s. është një ndër emrat më të njohur të cilët lidhen me durimin. Lirisht mund të thuhet se emri i tij është një sinonim për fjalën durim. Durimi i tij lidhet me sëmundjen e rëndë që ai kishte, si dhe me humbjen e anëtarëve të familjes së tij. Allahu i Madhëruar përshkruan ngjarjen e tij në suren El-Enbija, ku thotë: “(Përkujto) Edhe Ejubin kur iu drejtua Zotit të vet me lutje: “Më gjeti belaja, e Ti je më Mëshiruesi ndër Mëshiruesit. Ne iu përgjigëm atij nga mëshira Jonë, ia hoqëm ato vështirësi që i kishte, i dhamë familjen e tij dhe aq sa ishin ata, dhe e bëmë përkujtim për të devotshmit. (Përkujto) Edhe Ismailin, Idrisin dhe Dhulkifin, që të gjithë ishin të durueshëm.” (El-Enbija, 83-85)

Në suren Sad, Allahu i Madhëruar, duke shprehur nderimet më të larta për pejgamberin e Tij, Ejubin a.s., i drejtohet Muhamedit a.s. me fjalën

**Emri i Ejubit,
a.s., lirisht mund
të thuhet se është
një sinonim për
fjalën durim.**

“përkujto”:⁴ “Përkujto edhe robin tonë Ejubin, kur me lutje iu drejtua Zotit të vet: ‘Djali më ka goditur me mundim e dhembje.’ Bjeri me këmbën tënde tokës. Ky është (ujë) i ftohtë, lahesh dhe pi. E nga mëshira Jonë dhe mësim për ata që kanë të menduar, Ne ia falëm familjen e tij dhe po aq sa ishin ata. E merre me dorën tënde një deng thupra dhe bjeri me të, e mos e thyej besimin. Vërtet, Ne e gjetëm atë të durueshëm. Sa rob i mirë ishte ai dhe i kthyer te Zoti.” (Sad, 41-44)

Jakubi a.s.

Ndër pejgamberët e përmendur për durim gjatë vështirësive të tij, Allahu xh.sh. përmend edhe Jakubin. Atë, Allahu e përshkruan në një ajet kuranor së bashku me Ibrahimin dhe Is’hakun a.s.: “Përkujto robërit tanë, Ibrahimin, Is’hakun, Jakubin që ishin të fortë në zbatimin e detyrave dhe largpamës në fe.” (Sad, 45)

Jakubi a.s. u sprovua nga Allahu xh.sh. me ndarjen nga i biri i tij, Jusufi a.s., të cilin e donte më tepër se sa bijtë e tjerë. Por, përveç kësaj ndarje, ai u sprovua edhe me ndarje nga Bunjamini. Në suren Jusuf, Allahu i përshkruan këto ndarje dhe durimin e Jakubit a.s.: “... Halli im është durimi i mirë. Allahu është nga i Cili kërkohet ndihmë për këtë që përshkruani ju.” (Jusuf, 18); “... (mua nuk më ka mbetur tjetër) Durim i mirë është shpresë që Allahu do të m’i sjellë të gjithë, Ai është më i dijshti, më i urti.” (Jusuf, 83)

Edhe pse Jakubi a.s. premtoi se do të jetë prej durimtarëve, prapëseprapë ndarja me të birin e tij, Bunjaminin, solli tek ai dhimbjen për Jusufin, duke e shoqëruar më pas pikëllimi, butësia dhe malli.

Jusufi a.s.

Nga shembujt lakmues të durimit, të përmendura në Kuranin fisnik, është edhe shembulli i Jusufit a.s., jeta e të cilit ishte e mbushur me sprovë. Sa dilte nga njëra sprovë e gjente tjetra, ndonëse shpeshherë sprovë e dytë ishte edhe më e rëndë



se e para. Ai u sprovua me pozitën e ministrit, me vetminë, me largimin nga familja etj., por në durimin e tij, ai asnjëherë nuk kishte luhatje. Për këtë, Allahu në Kuranin fisnik thotë: “Dhe kështu Ne Jusufit i dhamë pozitë në vend (në Egjipt) zinte vend aty ku dëshironte. Ne e pajisim me të mirat tona atë që duam, e Ne nuk ua humbim shpërblimin punëmireve.” (Jusuf, 56)

Devotshmëria dhe durimi e ngritën Jusufin a.s. në grada të larta. Ai u gjend para dy sprovave, sprovës në fe, e ajo ishte t'i dorëzohej imoralitetit dhe të bëhej i pamoralshëm, dhe sprovës së kësaj bote, e që ishte burgosja. Ai i dha përparësi sprovës së dytë, duke e sakrifikuar këtë botë për shkak të fesë dhe për shkak të bindjes së tij. Zoti për këtë në Kuran ka thënë: “Ai (Jusufi) tha: “O Zoti im, burgu është më i dëshiruar për mua, se sa atë që ma ofrojnë ato mua dhe nëse Ti nuk largon prej meje dredhinë e tyre, unë mund të anoj te ato e të bëhem injorant.” (Jusuf, 33)

Ibën Kajjimi për këtë, transmeton fjalët e Ibën Tejmijes, i cili thotë: “Me të vërtetë, durimi i Jusufit a.s. ndaj asaj që ishte hedhur në pus, pastaj ndaj aktit të shitjes dhe ndarjes nga babai i tij, ishte durim i detyruar, sepse aty nuk kishte rrugëdalje tjetër, përveç se të durojë.”⁵

Ismaili a.s.

Për këtë të dërguar të Allahut, është karakteristikë shembulli i durimit, përmes së cilit vërehet nënshtrueshmëria ndaj Allahut, pa marrë parasysh rreziqet dhe sakrificat në jetë. Ëndrra e Ibrahimit a.s., që ta therë kurban të birin e tij, Ismailin a.s., ishte kuptuar si porosi nga ana e Ibrahimit a.s., kjo pasi që ëndrrat e pejgamberëve janë shpallje. Për këtë, Allahu në Kuran na rrëfen ngjarjen e Ibrahimit a.s. kur i kishte treguar për ëndrrën të birit të tij, Ismailit: “... O djali im, unë kam parë ëndërr (jam urdhëruar) në

ëndërr të të pres ty. Shiko pra, çka mendon ti?” (Es-Safat, 102).

A thua se si ishte qëndrimi i të riut Ismail a.s., karshi kësaj kërkesë, që ta vendos kokën e tij në tehun e thikës? Ai, pa kurrfarë dyshimi ia shprehu qëndrimin babait të tij, duke u radhitur kështu te të dërguarit durimtarë dhe shembull për besimtarët: “... Ai tha: “O babai im, punojë atë që urdhërohesh, e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve.” (Es-Safat, 102)

Durimi i pejgamberëve të vendosur

Shembulli i të dërguarve të vendosur është shembulli më i mirë i durimtarëve, për shkak se ata përfaqësojnë durimin në vështirësi gjatë thirrjes në rrugën e Allahut. Nga pejgamberët e vendosur janë: Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhamedi a.s., të cilët njihen ndryshe edhe me emrin “Ulul Azmi”, që ka kuptimin e përqendrimit dhe vendosmërisë në një çështje. Se këta pejgamberë ishin shembull që duheshin ndjekur edhe nga Muhamedi a.s., e vërtetë edhe porosia e Allahut drejtuar atij që t'i ketë si shembull këta për durim: “Ti (Muhamed), duro, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta...” (El-Ahkaf, 35)

Për Ismailin, a.s., është karakteristikë shembulli i durimit, përmes së cilit vërehet nënshtrueshmëria ndaj Allahut, pa marrë parasysh rreziqet dhe sakrificat në jetë.

Këta të dërguar, ishin më të ballafaqarit me vështirësi gjatë thirrjes së tyre. Nuhu a.s. e thirri popullin e tij në besim për 950 vjet, thirri ditën dhe natën, hapur dhe fshehurazi, mirëpo vazhdimisht ballafaqohej me njerëz të cilët mohonin atë dhe zemrat e tyre ishin të vulosura. Për këtë, Allahu në Kuran na rrëfen: “Ai tha: “O Zoti im, unë e thirra popullin tim natën e ditën. Por thirrja ime vetëm ua shtoi ikjen. Dhe sa herë që unë i thërrisja ata për t’u falur Ti atyre mëkatet, ata i vënin gishtat e tyre në vesh dhe i mbulonin kokat me teshat e tyre dhe vazhdonin në atë të tyren me një mendjemadhësi të fortë.” (Nuh, 5-7)

Ibrahimi a.s. u shqua për durim të fortë gjatë thirrjes që ai ia bëri babait dhe popullit të tij për besimin në Zotin Një. Për këtë rrëfen Kurani fisnik: “Ai (babai) tha: “A ti Ibrahim i refuzon zotat e mi? Nëse nuk ndalesh (së fryeri ndaj zotave të mi), unë do të gurëzoj, ndaj largohu prej meje për një kohë të gjatë.” (Merjem, 46)

Edhe përkundër këtyre fjalëve, Ibrahimi a.s. prapë vazhdoi thirrjen dhe durimin e tij të mrekullueshëm. Ai po ashtu përveç kësaj, u sprovua edhe me hedhje në zjarr, mirëpo edhe këtu, Allahu e mori përsipër mbrojtjen e tij, duke e bërë kështu zjarrin e ftohtë dhe shpëtues.

Musai a.s. lindi në një periudhë në të cilën mbisundonte frika dhe çrregullimet të cilat i shkaktonte Faraoni dhe njerëzit e tij. Për shkak të frikës për jetën e Musait a.s., nëna e tij u inspirua nga Allahu që fëmijën e saj ta hedhë në lumë. Allahu deshi që ky fëmijë të rritej në pallatin e Faraonit. Pasi që Allahu e dërgoi si peygamber Musain a.s., Faraoni filloi talljen me fjalët e Musait. “Ai (Faraoni) tha: “A nuk të rritëm ty si fëmijë në mesin tonë, ku i kalove disa vjet të jetës sate. Dhe ti e bërë punën tënde që e bërë, pra ti je mohues (i të mirave që t’i bëmë).” (Esh-Shuara, 18-19). Derisa Musai a.s. po transmetonte fjalët e Allahut, si i dërguar që ishte, Faraoni e kërcënoi

Shembulli i të dërguarve të vendosur është shembulli më i mirë i durimtarëve, për shkak se ata përfaqësojnë durimin në vështirësi gjatë thirrjes në rrugën e Allahut.

me mbytyje atë dhe pasuesit e tij. Musai a.s. duroi gjatë gjithë këtyre sprovave dhe sulmeve që atij iu bënin. Ai gjithnjë kërkonte e këshillonte popullin e tij që të kërkojnë ndihmë vetëm nga Allahu i Madhëruar. Ai duroi edhe në sprovën tjetër, me të cilën ndoshta asnjë peygamberët nuk u sprovua më parë në këtë mënyrë, e që ishte vrazhdësia e popullit të tij. Nga shembujt e padëgjueshmërisë dhe të vrazhdësisë e kemi edhe refuzimin e tyre që të hyjnë në “tokën e shenjtë”, pasi për një gjë të tillë, Musai a.s. kishte marrë urdhër nga Allahu xh.sh.: “Ata thanë: “O Musa, ne kurrë nuk hyjmë në të derisa ata janë aty, shko pra ti dhe Zoti yt e luftoni, ne po rrimë këtu.” (El-Maide, 24)

Shembujt të tillë, Allahu në Kuranin fisnik, na sjellë në shumë ajete, sa që edhe Peygamberi a.s. e përkujtonte atë që kishte duruar vëllai i tij me popullin e tij të vrazhdë.

Isai a.s. u dërgua peygamber te populli në të cilin më parë kishte fuar Musai a.s.. Ndonëse iu drejtua popullit të tij me fjalët më të bukura dhe me shembujt më të mirë, ai hasi në vesh të shurdhër e në zemra të mbyllura. Ata refuzuan ta pranojnë Isain a.s. si peygamber, e pos kësaj, ata ndaj tij dhe nënës së tij, Merjemes, shpifën intriga dhe gënjeshtër të ndryshme. Për këtë, Allahu na rrëfen

në suren En-Nisa ngjarjen e tij: “Edhe për shkak të mosbesimit dhe të thënies së tyre shpifëse kundër Merjemes. Madje për shkak të thënies së tyre: “Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut.” Po ata as nuk e mbyten as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhdë), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytyjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytyje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbyten atë.” (En-Nisa, 156-157).

Kjo ishte rruga e thirrjes së të dërguarve të Allahut, kështu ata gjatë rrugës së tyre peygamberike u sulmuan me sulmet më të rënda dhe më të vrazhda. Mirëpo, ata duruan dhe qëndruan në thirrjen drejt së vërtetës.

Allahu i Madhëruar e njoftoi të Dërguarin e Tij, Muhamedin a.s., me përvojën e të dërguarve të mëparshëm që ata kishin me popujt e tyre, duke sjellë kështu mësim të Muhamedi a.s., pasi që ai barti porosinë e Allahut që nuk ishte e kufizuar për një popull, për një krahinë, por ishte për gjithë njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit.

Ibën Ebi Hatimi transmeton në tefsirin e tij nga Mesruki, e ai nga Aisheja r.a. se i Dërguari i Allahut pasi kishte agjëruar kishte thënë: “Kjo botë nuk i takon Muhamedit e as familjes së Muhamedit. Oj Aishe, Allahu ishte i kënaqur me të dërguarit e vendosur (Ulul-Azmi) me durimin e tyre ndaj gjërave të papëlqyera, si dhe ndaj gjërave të dashura, më pastaj, Ai është i kënaqur që edhe mua të më ngarkojë me gjërat që i ngarkoi ata. “O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besoni atij! Ai iu falë mëkatet tuaja dhe ju shpëton prej një dënimi plot vuajtje.” (El-Ahkaf, 31). Pasha Zotin, unë kam për të duruar me tërë mundin, ashtu siç duruan ata, dhe s’ka fuqi përveçse me Allahun.”

1. Jusuf Kardavi, *Durimi në Kuranin fisnik*, 2002, fq. 24. 2. *Ibid*, fq. 28.3. *Ibid*, fq. 31.4. *Ibid*, fq. 84. 5. *Ibën el-Kajjimi*, *Medarixhu es-Salikin*, 2/157.

Ibrahim Iljazi

Junusi a.s., simbol i dënimit dhe i faljes hyjnore

Junusi a.s. rrjedh prej familjes së profetit Ibrahim a.s.. Emri i tij është Junus ibnu Meta. Tregimi i tij përmendet në disa sure të Kuranit, siç janë: El-Enam, Junus, El-Enbija, Safat. Ai ishte dërguar te populli Nejneva, në njërin prej regjioneve të Mosulit, në veri të Irakut të sotëm.

Lidhur me profetësinë e tij, Zoti në Kuran ka thënë: "Junusi ka qenë gjithashtu njëri nga të dërguarit."¹

Banorët e Nejnevas ishin të shumtë në numër, gjë e cila ceket dhe në një ajet të Kuranit: "Pastaj e dërguam atë te njëqindmijë e më tepër njerëz."²

Edhe Junusi a.s., si të gjithë profetët, ishte një njeri i zgjedhur i Zotit. Ai, e këshillonte popullin e tij ditë e natë, duke e ftuar në rrugën e drejtë. Iu kujtonte atyre Ditën e Gjykimit, u tregonte sa vend i keq është Xhehenemi për ata që nuk besojnë e bëjnë vepra të këqija, u shpjegonte për mrekullitë e Xhenetit, të cilat i presin besimtarët e sinqertë dhe të drejtë, i ftonte pa pushim për të bërë vepra të mira dhe ua përsëriste shumë e shumë herë se duhej t'i besonin Një Zoti të vetëm, Zotit të gjithësisë. Po gjithë ky mund që bëri për popullin e tij, ishte i kotë. As edhe një person i vetëm nga populli i tij nuk e besonte.

Junusi a.s. i paralajmëroi se ndëshkimin i Zotit, kishte për të qenë i vështirë. Ndërkaq, ata duke qeshur e duke u tallur me këtë paralajmërim i thanë: "Po që se do të na vjen ndëshkimi për hatër të një njeriu e do të na shkatërrojë, urdhëro, le të na vjen!"³

Junusi a.s. u hidhërua shumë për këtë kokëfortësi të popullit të tij në mohim dhe u largua nga populli i tij. Zoti i kishte dhënë leje që t'ju tregonte mbi afatin tre ditorë, por

nuk i kishte dhënë leje të largohej nga qyteti. Zoti në Kuran ka thënë: "(Kujtoje) Dhun-Nunin (Junusin) kur iku i zemëruar..."⁴

Pendimi dhe falja

Ndërkohë, shenjat e para të ndëshkimit filluan të shfaqeshin në Nejneva. Një re e madhe dhe e zezë plot me shkreptima filloi t'u afrohej banorëve të qytetit. Kur e panë renë në ditën e parë, banorët e kuptuan se po u afrohej ndëshkimi, ashtu siç i kishte paralajmëruar Junusi a.s.. Duke qenë se ishin afër popullit të Lutit, ata e dinin se çfarë i kishte ngjarë atij populli. Të frikësuar, paria e Nejnevasë u mblodhën të diskutojnë mbi hapat e mëtejshëm. Ata vendosën që t'i mblidhnin të gjithë njerëzit e qytetit dhe u thanë: "Kjo që po na ndodh është pikërisht paralajmërimi i Junusit a.s.. Sot nuk kemi shpëtim tjetër veçse të pendohemi dhe të pranojmë fenë e Junusit a.s.." Kështu të gjithë banorët e qytetit, njëqind e njëzet mijë, pranuan besimin monoteist, ndërkohë që Junusi a.s. nuk ndodhej aty. Veç kësaj, ata veshën rroba plot arna, si shenjë përluljeje ndaj Zotit, i ndanë nënat nga foshnjat e tyre që të qajnë të dyja palët, u ngjitën në kodra dhe filluan të luteshin dhe të përgjëroheshin. Kjo ndodhi, derisa reja e zezë ende po qëndronte sipër kokave të tyre. Për tre ditë ata u lutën me përgjërime, derisa Zoti ua pranoi

Nuk ekziston fshat dhe qytet tjetër që të kenë besuar të gjithë siç besoi populli i Junusit a.s..

(Ibën Kethiri)

lutjet dhe e largoi ndëshkimin e Tij. Zoti në Kuran thotë: "Përse nuk pati ndonjë qytet, banorët e të cilit të besonin e t'u bënte dobi besimi i tyre, përveç popullit të Junusit? Kur ata besuan, Ne ua larguam dënimin e poshtërimin në jetën e kësaj bote dhe i lamë të kënaqeshin edhe njëfarë kohe."⁵

I vetmi popull që ka shpëtuar pasi është penduar, megjithëse e ka bërë hak ndëshkimin për shkak të mosbesimit është populli i Junusit a.s.. Ibnu Kethiri ka thënë: "Vetë ajeti tregon se nuk ekziston fshat dhe qytet tjetër që të kenë besuar të gjithë siç besoi populli i Junusit a.s.." Në çdo fshat dhe qytet, do të gjejmë besimtarë dhe jobesimtarë, kurse populli i Junusit a.s. të gjithë, pa përjashtim, përqafuan fenë e vërtetë, Islamin.

Junusi a.s. i hidhëruar nga populli

Ndërkohë që Junusi a.s. ndodhej në errësirën e barkut të balenës, errësirën e detit dhe të natës, ai vazhdoi të shprehte pendesë e të lutej.

i tij shkoi drejt brigjeve të lumit Tigër për t'u larguar nga populli i tij dhe hipi mbi një anije që ishte me njerëz dhe mallra. Për këtë, Zoti në Kuran ka thënë: "Ai nxitoi drejt një anijeje të mbushur plot e përplot."⁶

Gjatë lundrimit, filloi një stuhi e madhe, e cila rrezikonte anijen bashkë me njerëzit. Të frikësuar nga mundësia e mbytjes, njerëzit filluan të hidhnin në det të gjithë ngarkesën e anijes, por dallgët e detit nuk u ndalën dhe filluan polemikat ndërmjet njerëzve se cili nga këta

është mëkatarë. Ata ranë dakord që të hidhnin short, kujtdo që i binte shorti që të hidhej në det, do të hidhej derisa të lehtësohej anija. Kur hodhën shortin, të parit që të hidhej në det i qëlloi Junusit a.s.. Të tjerët thanë: "Jo, ky është një djalë i ri dhe ka shenja ndershmërie. Le ta falim këtë herë dhe të hedhim sërish short." Edhe për herën e dytë, shorti i ra Junusit a.s.. Po ashtu edhe herën e tretë. Zoti në Kuran thotë: "...dhe hodhi short (me detarët se kush duhej të hidhej) dhe Junusi humbi."⁷

Atëherë të gjithë ranë dakord që ta hidhnin në det. Me të hedhur në det Junusin a.s., stuhia pushoi dhe deti u qetësua. Kështu që balena e gëlltiti Junusin a.s.. Zoti në Kuran thotë: "Pastaj atë e gëlltiti një balenë, se ai kishte bërë diçka të gabuar."⁸

Zoti e urdhëroi balenën që të mos ia thyente eshtrat dhe që mos t'ia dëmtonte mishin. Junusi a.s. e kuptoi se kjo i ndodhi për shkak se u largua nga populli i tij pa lejen e Zotit. Sipas disa transmetimeve, thuhet se Junusi a.s. qëndroi në barkun e balenës për tri ditë. Ndërkohë që në disa transmetime të tjera thuhet se qëndroi dyzet ditë.

Ndërkohë që Junusi a.s. ndodhej në errësirën e barkut të balenës, errësirën e detit dhe të natës, ai

vazhdoi të shprehte pendesë e të lutej. Kur engjëjt e morën vesh gjendjen e tij, ndërhyrën te Zoti për falje për të. Pas përsëritjes së shumtë të shprehjes pendestare nga Junusi a.s., ai i vetëm në barkun e balenës, filloi të lutej me përgjërëm.

Zoti në Kuran thotë: "Andaj thërriti nga errësirat: "S'ka Zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!"⁹

Po ashtu, Zoti ka thënë: "Ne iu përgjigjëm atij dhe e shpëtuan nga brengosja. Kështu, Ne i shpëtojmë besimtarët."¹⁰

Në një hadith të transmetuar nga Imam Ahmed, Nesai, Tirmidhiu dhe të tjerë Pejgamberi Muhamed a.s. ka thënë: "Lutja e Dhununit (Junusit) në barkun e balenës ishte: "S'ka Zot tjetër, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!" Nuk ka besimtar që e lut Zotin me këtë lutje, veçse Ai do t'ia pranojë lutjen."

Pasi Zoti ia pranoi lutjen, balena e afroi pranë bregut dhe e nxori jashtë. Zoti në Kuran thotë: "Por Ne e hodhëm atë në një breg të shkretë, duke qenë i sëmurë."¹¹

Vendi ku e nxori balena ishte një vend i shkretë pa bimë dhe pemë dhe nuk kishte asgjë për t'u ushqyer, e as rroba për ta mbuluar trupin e tij. Në këtë çast ndodhi një mrekulli tjetër, ku pranë tij mbin një kungull, gjethet e të cilit janë të mëdha dhe bëjnë hije. Zoti në Kuran ka thënë: "Dhe bëmë që sipër tij të mbinte një bimë kungull."

Historia e Junusit a.s. është një mësim për të gjithë ata që ftojnë njerëzit në rrugën e Zotit, që të mos i humbasin shpresat. Në çastin që Junusi a.s. i këputi shpresat ndaj popullit të tij dhe u largua, ata besuan. Sikur Junusi a.s. të mos kishte qenë një rob që përmendte e i lutej Zotit, ai do rrinte në barkun e balenës deri në Ditën e Mbramë.

1. *Es-Safat*, 139. 2. *Es-Safat*, 147. 3. Osman Nuri Topbash "Vargu i profetëve", Stamboll, 2005, f. 135. 4. *El-Enbija*, 87. 5. *Junus*, 98. 6. *Es-Safat*, 140. 7. *Es-Safat*, 141. 8. *Es-Safat*, 142. 9. *El-Enbija*, 87. 10. *El-Enbija*, 88. 11. *El-Safat*, 145.



Bajram Zeqiri

Dituria, stoli e besimtarit

“...Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” Vërtet, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Ez-Zumer, 9)

Dituria është dhuntia më e madhe që Allahu na e ka dhënë neve. Allahu xh.sh. e ka lavdëruar dijen, i ka nderuar bartësit e dijes, u ka dhënë atyre shpërblime të mëdha, ua ka ngritur shkallët në këtë dhe botën tjetër. Kjo ngase dituria është udhëzim, është mëshirë, dritë, mbrojtje, lartësi dhe ngritje. Për këtë, Allahu xh.sh. ka thënë: “...Allahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. Allahu është i njohur mirë me atë që punoni.” (El-Muxhadele, 11)

Se dituria ka vlerë dhe rëndësi të madhe, flet më së miri edhe shpallja e Kuranit fisnik. Ai filloi me ajetet e para me urdhrin për të kërkuar

Dituria është gjëja e vetme që mund ta ngopë, ta bëjë të lumtur dhe ta kënaq njeriun.

Dituria është pjesë përbërëse e natyrës së njeriut.

Nëpërmjet fitimit të diturisë, njeriu fiton epërsi ndaj krijesave të tjera.

dituri: “Lexo me emrin tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (El-Alak, 1-5)

Islami i ka dhënë diturisë një vend të posaçëm, kjo mjafton me faktin se vetëm në Kuranin fisnik, ajo përmendet me qindra herë. Në vende të caktuara të shpalljes hyjnore, kur flitet për diturinë, ajo lartësohet tej mase, duke i trajtuar kështu dijetarët si njohësit më të mirë dhe ata të vetmit të cilët ia kanë frikën Zotit. Allahu i Lartësuar për këtë ka thënë: “...Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët, Allahu



është mbi gjithçka është mëkatfalës.” (Fatir, 28)

Meqenëse dituria ka një vlerë dhe nder të madh tek Allahu xh.sh., Ai e mësoi Pejgamberin a.s., e nëpërmjet tij edhe neve që ta kërkojmë atë. Muhamedi a.s. është mësuesi më i mirë që njohu njerëzimi. Ai nuk e kishte lutur Zotin e Madhëruar që t'i shtonte diç, ashtu siç e kishte lutur Zotin që t'ia shtonte diturinë. Allahu zbriti edhe ajet kuranor për një gjë të tillë: “... thuaj: “Zoti im, më shto diturinë!” (Ta Ha, 114) Nuk ka se si të mos kërkonte një gjë të tillë i Dërguari i Allahut, kur atij i ishin zbritur vargje rreth penës e dijës, madje edhe vetë Allahu i Madhëruar ishte betuar në lapsin, që nënkupton dijen:¹ “Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë.” (Kalem, 1)

Dituria është qëllimi më i mirë për të cilin njeriu duhet të lodhet dhe të brengoset. Flijimi në rrugën e diturisë është një qëndrim me vullnet i çdo njeriu, por, në këtë rrugë në të cilën hyhet me vullnet, nevojitet që të braktisen edhe një numër i madh kënaqësish të kësaj bote, dhe të përballesh me siklete dhe brenge të ndryshme. Në këtë kontekst, rruga që të çon drejt diturisë, jo vetëm asaj fetare, por te të gjitha llojet e diturisë është tejet e vlefshme. Në të vërtetë, njeriu lartësohet përmes dijës. Sexhdeja e melaqeve ndaj Ademit a.s. është bërë pikërisht për shkak të dijës së tij. Gjithashtu edhe respekti i tyre karshi njerëzve në përgjithësi është në saje të dijës.²

Dituria është gjëja e vetme që mund ta ngopë, ta bëjë të lumtur dhe ta kënaq njeriun. Dituria është pjesë përbërëse e natyrës së njeriut. Nëpërmjet fitimit të diturisë, njeriu fiton epërsi ndaj krijesave të tjera. Për këtë Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “Allahu ia mësoi Ademit emrat e gjërave. Pastaj këtë ua paraqiti engjëjve dhe u tha: M’i tregoni emrat e tyre, nëse ajo që e thoni është e vërtetë!” “Qofsh i lavdëruar!” – thanë ata. Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i

Kërkimi i diturisë kërkon durim dhe qëndrueshmëri. Zaten, prej mejdaneve më të mëdha që kërkohet durimi është në kërkimin e diturisë.

Gjithëdijshmi, i Urti.” (El-Bekare, 31-32)

Kërkimi i diturisë në Islam konsiderohet si një përpjekje në rrugën e Allahut. Këtë e ka theksuar edhe Pejgamberi a.s.: “Ai që nisat për të nxënë dituri është në rrugën e Allahut derisa të kthehet.”³

Ashtu siç na është mësuar se engjëjt kanë shtrirë krahët e tyre për t'i ndihmuar besimtarët në luftën e Bedrit:⁴ “...A nuk është mjaft për ju që Zoti juaj t'ju vazhdojë ndihmën me tre mijë engjëjt e zbritur?” (Ali Imran, 124), njashu engjëjt shtrinë krahët e tyre të mëshirës për kërkuesin e diturisë. Transmetohet nga Kajs ibën Kethiri të ketë thënë: “Erdhi një person nga Medina ta vizitonte Ebu Derdanë në Damask. Ebu Derdaja e pyeti: “Ç’e mirë të sollti, o vëlla?” Ai u përgjigj: “Një hadith që ti e ke përcjellë nga Pejgamberi a.s.” Si rrjedhojë, Ebu Derdaja i tha: “E dëgjova Pejgamberin a.s. duke thënë: “Atij që nisat në rrugën e dijës, Allahu ia lehtëson rrugën e Xhenetit. Engjëjt, të gëzuar, i shtrojnë flatrat e tyre para tij. Çdo gjë në qiell e në tokë, madje deri edhe peshqit në det i luten Allahut xh.sh. që ta falë atë. Epërsia e dijetarit mbi të devotshmin është si epërsia e hënës ndaj yjeve. Nuk ka dyshim se dijetarët janë trashëguesit e pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi as ar dhe as argjend; trashëgimia e vetme e tyre është dija. Kush e merr atë, ka marrë një hise prej tyre.”⁵

Njeriu asnjëherë nuk duhet të mjaftohet me dituri. Për diturinë këmbënguli edhe Musai a.s., ashtu siç na transmetohet nga Katadeja r.a., i cili thotë se po të mjaftohej ndokush me dituri, atëherë do të mjaftohej Musai a.s., por ai i tha Hidrit a.s.: “A pranon të vijë me ty, që të më mësosh nga ajo që je i mësuar ti: dituri të drejtë dhe të vërtetë?” (El-Kehf, 66). Dituria nuk fitohet brenda një kohe të shkurtër, por ajo kërkon durim dhe punë graduale. Kush dëshiron mirëqenie në këtë botë, le të mësojë, kush dëshiron paqe në botën tjetër edhe ai le të mësojë dhe kush dëshiron të dy botët, atëherë le të merret me dituri.⁶

Virtytet e një nxënësi të suksesshëm

Pasi që më parë shpjeguar për vlerën dhe rëndësinë që ka dituria, tani duhet të përmendim disa nga virtytet që duhet t'i posedojë një nxënës (kërkues i diturisë) që ai të jetë i suksesshëm në nxënien e diturisë. Mungesa e këtyre virtyteve sjell edhe mungesë të suksesit të plotë. Prej virtyteve të para që duhet t'i ketë nxënësi është sinqeriteti. Është kjo gjëja e parë që kërkohet në çdo adhurim, e edhe në kërkimin e diturisë që është një adhurim i veçantë kërkohet sinqeritet. Allahu xh.sh. për këtë ka thënë: “E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij,...” (El-Bejine, 5) Edhe Pejgamberi a.s. në një hadith ka thënë: “Veprat shpërblehen sipas njetit.” (Buhariu dhe Muslimi)

S’ka dyshim se të mësuarit kërkon sinqeritet të madh, sepse për këtë ka shpërblime të mëdha tek Allahu i Madhëruar, përndryshe nijeti i pasaktë e privon të zotin e diturisë nga sukcesi dhe bëhet prej atyre që të parët do të hynë në Xhehenem në Ditën e Kiametit.⁷

Devotshmëria është gjëja e dytë që duhet të ketë një kërkues i diturisë në

Nxënësi në raport me mësuesin e tij duhet të jetë si toka e butë dhe me rrëzë e cila absorbon tërëshiun e rrënë nga qielli.

zembrën e tij. Kjo ngase ata që e njohin më së shumti Allahun, ata edhe ia kanë frikën më së shumti Atij. Me devotshmëri dijetari e shton dijen, kurse me dije shtohet devotshmëria. Allahu xh.sh. ka thënë: "...Kini frikë Allahun se Allahu ju dhuron dituri (të jashtëzakonshme), Allahu është i gjithëdijshëm për çdo send." (El-Bekare, 282)

Në kërkimin e diturisë, nxënësi duhet të ketë një ambicie të lartë, si dhe duhet ta japë tërë mundin e tij për të fituar dituri. Prej shembujve të të parëve, të cilët kishin ambicie të larta për kërkimin e diturisë është edhe Ebu Jusufi, i cili qëndroi me mësuesin e tij Ebu Hanifen për shtatëdhjetë vjet në kërkim të diturisë. Stolisja me këtë etikë eliminon shpresat dhe veprat e parëndësishme dhe çrrënjës nga zemra pemën e poshtërimit, degradimit, lajkatimit dhe mashtrimit.⁸

Kujdesi për kohën, e cila është një dhunti hyjnore për të cilën ne duhet ta falënderojmë Allahun pa ndërprerë. Pejgamberi a.s. në një hadith ka thënë: "Dy dhunti shumica e njerëzve i përbuzin: shëndeti dhe koha e lirë."⁹ Andaj, myslimani duhet që këto dhunti t'i shfrytëzojë në gjëra të dobishme dhe të mira, ngase për këto do të pyetemi në Ditën e Gjykimit: "Nuk do të lëvizin këmbët e njeriut përderisa mos të pyetet për katër gjëra, për jetën ku e

ka harxhuar, për rininë ku e ka kaluar, për pasurinë ku e ka fituar dhe për dijen se çfarë ka bërë me të."¹⁰

Kërkimi i diturisë kërkon durim dhe qëndrueshmëri, përndryshe është shumë e vështirë që të merret dituria nëse mungon ndonjëra prej tyre. Zaten, prej mejdaneve më të mëdha që kërkohet durimi është në kërkimin e diturisë. Nxënësi nuk duhet të dorëzohet asnjëherë, sepse dituria është një deti pa fund. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kërkojeni diturinë prej djepi e gjer në varr."

Prej gjërave që nxënësi duhet të ketë parasysh gjatë kërkimit të diturisë, është që atë çfarë e ka mësuar ta përsërisë, si dhe të shkruaj atë çfarë e ka mësuar, në mënyrë që ta regjistrojë në trurin e tij. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Lidheni dijen duke e shkruar atë."¹¹

Prej virtyteve të fundit që do të përmendim është edhe të vepruarit me dijen e mësuar. Ashtu siç duhet të jemi serioz në kërkimin e diturisë, ashtu duhet të jemi serioz edhe gjatë zbatimit dhe praktikimit të saj.

Përhapja e diturisë llogaritet zekat. Dijetari duhet ta dijë se është e drejtë e Allahut që ai ta përhapë diturinë e tij dhe t'i mësojë njerëzit për gjërat që ata nuk i dinë.¹² Allahu xh.sh. i ka qortuar ata që nuk kanë vepruar me diturinë e tyre, duke i krahasuar ata me gomarin i cili bart libra dhe nuk ua di vlerën: "Shembulli i atyre që janë obliguar me Tevrat, dhe nuk e zbatojnë atë, është si shembulli i ndonjë gomari që bart libra. Shembulli i keq është shembulli i popullit që përgënjeshtroi ajetet e Allahut, e Allahu nuk udhëzon në rrugën e drejtë popullin jobesimtar." (El-Xhuma, 5)

Obligimet e nxënësit gjatë kërkimit të diturisë

Në veprën Ihja ulumu ed-din, Ebu Hamid el-Gazaliu, përmend disa obligime që duhet t'i ketë një nxënës, në mënyrë që ai të ketë sukses në misionin e kërkimit të diturisë.¹³



Obligimi i parë që përmend ai është se nxënësi duhet të jetë i pajisur me pastërti shpirtërore, ngase dituria është adhurim i zemrës me të cilën ne i afrohem Allahut xh.sh. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Islami bazohet në pastërti.”¹⁴ Që një nxënës të jetë i suksesshëm, ai obligohet që të jetë më pak i preokupuar me dynja dhe me gjëra të cilat e largojnë nga përqendrimi për të kërkuar dituri. Dituria kërkon përkushtim të plotë, e dynjaja është prej atyre gjërave që njeriut nuk ia mundëson përqendrimin e plotë ndaj shkencë-diturisë. Në Kuranin fisnik thuhet: “Allahu nuk krijoi dy zemra në gjoksin e asnjë njeriu.” (El-Ahzab, 4).

Ndër obligimet që kërkohet nga nxënësi është që ai mos të mburret mbi mësuesin e tij, por që të dëgjojë me vëmendje këshillat e tij, ashtu siç i sëmuri i dëgjon këshillat e mjekut. Ai duhet të jetë i përgjitur ndaj mësuesit të tij dhe të ndihet i nderuar e i kënaqur që është nën përkujdesjen e tij. Pejgamberi ynë i dashur ka thënë: “Lajkat dhe miklimi nuk i lejohen besimtarit, përveç se në kërkimin e diturisë.”¹⁵ Nxënësi në raport me mësuesin e tij duhet të jetë si toka e butë dhe me rërë e cila absorbon tërë shiun e rënë nga qielli. Nxënësi në çdo rast duhet dëgjuar dhe pasuar mësuesin e tij. Nxënësi obligohet që ta respektojë mësuesin e tij, të mos flasë vetëm kur ai i jep leje. Ai duhet të jetë modest ndaj tij, t’ia hapë derën, të ecën pas tij, ta ndihmojë në veshmbathje etj.¹⁶

Nxënësi obligohet që të ketë kujdes dhe të mos lëshohet në polemika dhe ndarje të ndryshme, qoftë në fushën e shkencave të dynjasë apo edhe në ato të Ahiretit, sepse kjo mund t’ia zvogëlojë entuziazmin dhe mund t’ia dëmtojë mendjen dhe intelektin. Prej obligimeve të tjera përmendim edhe atë se nxënësi duhet të zotërojë sa më shumë dituri të ndryshme, kjo ngase dituritë janë të ndërlidhura mes vete. Nga nxënësi kërkohet që lëmit të caktuar mos t’i përkushtohet në tërësi, por të ketë kujdes për renditjen d.m.th. të studiojë atë që është më e

rëndësishme dhe më e vlefshme. Nga nxënësi kërkohet që mos t’i hyjë shqyrtimit të një shkence, nëse paraprakisht nuk e ka zotëruar materien që i paraprinë asaj. Nxënësi kërkohet që të njohë shkaqet për të cilat shkencat e caktuar është shkencë e nderuar.

Nga ai kërkohet që me diturinë e tij të ketë për qëllim pastrimin shpirtëror dhe afrimin tek Allahu, që të jetë në fqinjësi me ata që Allahu do t’u dhurojë nderimet më të larta. Ai xh.sh. thotë: “... Allahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituria...” (El-Muxhadele, 11). Si obligim të fundit përmendim atë që nxënësi i suksesshëm është ai që dinë t’i vlerësojë shkencat parësore, ato me të cilat arrihet qëllimi themelor, e natyrisht se qëllimi është i lidhur edhe me këtë botë, por edhe me Ahiretin.

Mësuesi, shembull dhe udhërrëfyes për nxënësin

Mësuesi, para së gjithash, duhet ta ketë në mendje se punën e tij e kryen në emër të kënaqësisë së Allahut. Mësuesin duhet ta stolisin cilësitë e mira, virtyti i lëvdar dhe karakteri i butë, ashtu siç ka porositur Allahu. Atë duhet ta shoqërojë modestia, bujaria, bamirësia, vlerat etike, çiltërsia e fytyrës, butësia, trimëria, devotshmëria, qetësia, dinjiteti, modestia, përlësia etj.¹⁷

Mësuesi duhet të tregojë dashuri, simpati dhe të kujdeset për të mirën e nxënësit të tij, ashtu siç kujdeset për fëmijët e tij. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Marrëdhënia ime ndaj jush është sikur marrëdhënia e prindit ndaj fëmijëve të tij.”¹⁸

Ata të cilët me diturinë e tyre dëshirojnë ndikimin e kësaj bote, hyjnë në kontekst të mesazhit kuranor: “Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të sinqertë në miqësi.” (Ez-Zuhruf, 67).

Nga mësuesi kërkohet që të pasohet shembulli i Pejgamberit a.s., në mënyrë që të arrihet kënaqësia e Allahut xh.sh.. Për këtë, ai duhet ta presë shpërblimin vetëm nga Allahu xh.sh.: “O populli im, unë për këtë nuk kërkoj prej jush ndonjë pasuri. Shpërblimi im është vetëm tek Allahu.” (Hud, 29)

Mësuesi duhet që nxënësit t’i japë gjitha këshillat e nevojshme dhe të tregojë maturi dhe kujdes të stërholluar në tregimin e gabimeve të nxënësit. Çdo sjellje jo të denjë nga ana e nxënësit, mësuesi duhet ta gjejë mënyrën që ta ndalojë atë. Ai nuk duhet të kërkojë nga nxënësi diçka jashtë mundësive të tij.¹⁹

Mësuesi duhet të jetë shembull për nxënësin e tij. Veprat e tij duhet të jenë në përputhje me fjalët dhe kurrsesi nuk duhet të bien ndesh me to. Nëse vepra e mësuesit është në kundërshtim me mësimet e tij, aty nuk ka udhëzim. Për këtë Allahu xh.sh. ka thënë: “A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni...?” (El-Bekare, 44).

1. Ejup Haziri, *Dituria formë e edukimit, ngritjes dhe avancimit, Takvimi 2019, fq. 251* 2. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, *Islami nëpërmjet haditheve I, fq. 388* 3. Tirmidhiu, 2647 4. Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, *Islami nëpërmjet haditheve I, fq. 388* 5. Tirmidhiu, 2682 6. Jakup Asipi, *Për diturinë, fq. 122*, 7. Abdulaziz en-Neda, *Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave islame, Shkup, 2010, fq. 493* 8. Bekër ebu Zejd, *Stolia e kërkuesit të diturisë, Prishtinë, 2010, fq. 63* 9. Buhariu dhe Muslimi 10. Tirmidhiu 11. Taberaniu 12. Abdulaziz en-Neda, *Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave islame, Shkup, 2010, fq. 500* 13. *Ihja ulumu ed-din, Ebu Hamid el-Gazali, Prishtinë, 2010, fq. 195* 14. *Ibën Hibani, Taberaniu 15. Ibën Adij nga Muadhhi dhe Ebi Umame 16. Abdulaziz en-Neda, Enciklopedia e sjelljeve dhe rregullave islame, Shkup, 2010, fq. 496* 17. Ahmed Ferid, *Deti i kthjellët i devotshmërisë, Shkup, 2012, fq. 53* 18. *Ebu Davudi, Nesai, Ibën Madhe dhe Ibën Hibani. 19. Ihja ulumu ed-din, Ebu Hamid el-Gazali, Shkup, 2010, fq. 215.*

Prof. dr. Xhenana Efendiq - Semiz¹

Reforma dhe kolonizimi agrar serb në vitin 1918²

Rrallëherë në botë një popull ka arritur të zgjerojë territorin e tij shtetëror në 150 vjetët e fundit dhe të dëbojë popujt jo serbë, ashtu siç kanë arritur serbët. Është interesante të përmendet se suksesi i tyre nuk bazohet në fitoret luftarake, por në tryezat e negociatave, me mbështetjen e aleatëve të tyre të luftës.

Serbia, e cila përfshinte Pashallëkun e Beogradit, pas Luftërave Ballkanike të viteve 1912 dhe 1913, u zgjerua territorialisht në Kosovë, pjesë të Sanxhakut dhe të ashtuquajtur Maqedoninë Jugosllave. Gjatë luftës së parë ballkanike, trupat serbe kryen krimin e gjenocidit kundër shqiptarëve, boshnjakëve dhe maqedonasve në ato zona. Ata u vunë zjarrin vendbanimeve të tëra, duke vrarë popullsinë civile në mënyrën më primitive, me thika, sëpata dhe çekiçë të prerë prej druri. Një krim i tillë nuk është regjistruar në Evropë që nga migrimi i popujve. Përndjekja e popullatës jo serbe vazhdoi pas vendosjes së sundimit serb, duke çuar në emigracion masiv, i cili çoi në një

Gjatë luftës së parë ballkanike, trupat serbe kryen krimin e gjenocidit kundër shqiptarëve, boshnjakëve dhe maqedonasve në ato zona. Ata u vunë zjarrin vendbanimeve të tëra, duke vrarë popullsinë civile në mënyrën më primitive, me thika, sëpata dhe çekiçë të prerë prej druri.

ndryshim në strukturën demografike dhe zba-timin e kolonizimit serb në pronën e vjedhur e të përndjekurve.

Zgjerimi i parë i përmendur i territorit serb, mbi të cilin u krye kolonizimi, paraqet fillimin e realizimit të programit politik, i cili u përcaktua në “Naçertanje” e vitit 1844, nga Ilija Garashanin.

Ideologjia serbe e pushtimit të territoreve

Programi kombëtar serb në “Naçertanje” i vitit 1844 filloi nga rinovimi i perandorisë së Dushanit nga shek. XIV, me disa ndryshime që ishin pasojë e ngjarjeve politike në mesin e shekullit të kaluar. Në fakt, “Naçertanje” është bërë sinonim i hegjemonisë së madhe serbe në lidhje me popujt fqinjë.

Programi kombëtar bazohet në faktin se serbët nuk mund të jenë të kënaqur me fitimet nga Kryengritja e Parë dhe e Dytë Serbe dhe se ata do të vazhdojnë luftën për të marrë epërsinë në Ballkan. Në “Naçertanje” përmenden vendet në të cilat Serbia duhet të organizojë punë propagandistike dhe të inteligjencës, në mënyrë që të përgatitet për aneksimin e këtyre vendeve në shtetin e saj. Prandaj, ky program nuk u botua deri në



Reforma agrare u krye në një mënyrë gjenocidale kundër pronarëve myslimanë që jetonin në Maqedoni, Kosovë dhe Metohi, Sanxhak e Mal të Zi. Atyre iu konfiskuan gjithsej 231.098 hektarë tokë, të cilat ishin ndarë në pronësi të 48,267 familjeve serbe.

vitin 1906. Programi kombëtar parashikon bashkimin e Bosnje dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Malit të Zi, Shqipërisë së Veriut, Srijemit, Banatit dhe Baçkës. Për herë të parë në territorin kombëtar serb përhshihen zonat e Bosnje-Hercegovinës dhe të Vojvodinës, të cilat nuk u përfshinë në perandorinë e Dushanit. Më vonë, “Naçertanje” do të bëhet ideologjia serbe jo vetëm e dinastive Obrenović dhe Karagjorgjeviq, por edhe e të gjitha programeve të Serbisë së Madhe me ato të çetnikëve gjenocidë Stevan Moleviq dhe Drazhe Mihailoviq, si dhe Memorandumin e ASSHA të vitit 1986.

Prandaj, politika hegjemonike e “Serbisë së Madhe” nuk ka ndryshuar në 150 vitet e fundit, pasi qëllimi i saj kryesor është pushtimi i territoreve, depërtimi i Perëndimit përmes Drinës, përndjekja dhe shkatërrimi i popujve jo serbë për të krijuar një Serbi të Madhe dhe se “të gjithë serbët të jetojnë në një shtet”. Prandaj, struktura etnike po ndryshohet duke kolonizuar territoret e pushtuara. Në mënyrë që të zbatohet politikën e programit, ata

bëjnë luftëra dhe kryejnë reforma agrare në zonat e pushtuara në mënyrë që të kolonizojnë strukturën etnike me kolonizimin e territoreve të çliruara. Në mënyrë që të zbatohet politikën e programit, ata zhvilluan luftëra dhe kryen reforma agrare në zonat e pushtuara në mënyrë që t'i kolonizojnë me popullsinë serbe. Në shqyrtimin tonë, do të shohim disa aspekte të reformës agrare dhe kolonizimit në vitin 1918.

Ndryshimet në pronësinë e tokës në vitin 1918

Për një pasqyrë më të mirë të gjendjes së pronësisë së tokës para reformës agrare të viteve 1918 dhe 1919 në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku ajo u krye në mënyrën më drastike, ne do të përdorim regjistrimin e fundit të pronësisë së tokës dhe popullsisë sipas përkatësisë fetare, të kryer në vitin 1910 në Austro-Hungari.

Sipas këtij regjistrimi, myslimanët boshnjakë kishin 91.1 %, ortodoksët serbë 6.0 %, katolikët kroatë 2.6 % dhe “të tjerët” 0.3 % të pronësisë së tokës.

Pas themelimit të Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene, populli boshnjak erdhi në një pozitë vartëse, sepse ata morën statusin e një pakice fetare, kështu që ata u privuan nga autonomia politike dhe kulturore. Reforma e parë agrare e viteve 1918 dhe 1919 kreu në mënyrë perfide gjenocidin ndaj boshnjakëve duke konfiskuar pronësi të tokës, me një kompensim simbolik, i cili nuk u pagua kurrë plotësisht. Brenda natës, shumë familje të pronarëve të pasur të tokave u bënë problem shoqëror, pa mjete jetese. Disa familje madje u privuan nga ndërtesat e ndërthuara dhe oborret e shtëpive. Filloi procesi i varfërimit masiv të popullit boshnjak dhe eksodi për në Turqi.

Toka e rrëmbyer e familjeve boshnjake iu dha familjeve serbe nga Bosnja dhe Hercegovina, Krahina

Kroate, Serbia dhe Mali i Zi. Ata u regjistruan në librat e tokës si pronarë që nuk paguanin asgjë për pronën e fituar. Ky ishte shpërblim për ata, sepse i përkisnin një kombi të privilegjuar. Gjëja kryesore ishte të kryhej një ndryshim i dhunshëm në strukturën demografike, me kolonizimin serb, në përputhje me programin nga “Naçertanje”. Gjegjësist, me çdo kusht, ata përpiqen ta paraqesin Bosnjën dhe Hercegovinën si një vend serb, i cili duhet t'i bashkohet “Serbisë së Madhe” në një moment të favorshëm historik.

Raporti i gjenocidit ndaj boshnjakëve mund të ilustruhet nga treguesit e një ndryshimi në strukturën pronësore të pronësisë së tokës, e cila u mor nga reforma e parë agrare në vitin 1918 dhe 1919. Një total prej 1,175,305 hektarë tokë bujqësore dhe pyjore iu konfiskua boshnjakëve- myslimanëve. Nga shoqëritë aksionare, bankat dhe institucionet e tjera u konfiskua 110,922 hektarë tokë. Prandaj, u konfiskua gjithsej 1,286,227 hektarë tokë bujqësore dhe pyjore.

E gjithë toka e konfiskuar pas reformës së parë agrare në vitin 1918 dhe 1919 iu nda 249,518 familjeve serbe, duke përfshirë kolonët, kolonizuesit jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe veçanërisht “Selanikasve”. Nëse kemi parasysh se secila familje kishte mesatarisht katër anëtarë, atëherë rrjedh se pothuajse një milionë banorë të kombësisë serbe u bënë pronarë dhe posedues të tokave dhe u bënë dukshëm më të pasur. Teju i reformës agrare në vitin 1918 dhe 1919 u drejtua kryesisht kundër anëtarëve të besimit islam, në mënyrë që të ringjallet ideologjia e Savës së Shenjtë, sintagma së cilës është - një popull i një feje në një shtet. Prandaj, reforma agrare u krye në një mënyrë gjenocidale kundër pronarëve myslimanë që jetonin në Maqedoni, Kosovë dhe Metohi, Sanxhak e Mal të Zi. Atyre iu konfiskuan gjithsej 231.098 hektarë tokë, të cilat ishin ndarë në pronësi të 48,267 familjeve serbe. Duke zbatuar metodologjinë e mësipërme, se secila familje kishte një mesatare prej katër

anëtarësh, rrjedh se pothuajse 200 mijë anëtarë të familjeve serbe morën tokë, e cila ndryshoi ndjeshëm pronësinë dhe strukturën etnike të popullsisë. Procesi i emigrimit nga ajo zonë vazhdoi për në Turqi, paralelisht me kolonizimin e popullatës serbe, nga Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Dalmacia, Lika, Banija dhe Korduni.

Në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, reforma agrare e viteve 1918 dhe 1919 u krye në një formë shumë më të butë në Kroaci dhe Slloveni, krahasuar me zonat e banuara nga myslimanët. Ajo u aplikua mbi pronarët e tokave dhe relativisht më pak tokë u konfiskua prej tyre, e që sipas treguesve statistikorë përfaqëson rreth 1/4 e tokës totale të konfiskuar në shtet. Kjo arrin në 406.981 hektarë tokë, e cila është e ndarë në 316.762 familje serbe, të cilat janë kryesisht të kolonizuara nga zonat pasive. Kështu, në atë zonë, pothuajse 1,200,000 anëtarë të familjes morën tokë në pronësi dhe posedim.

Reforma agrare e viteve 1918 dhe 1919 nuk u krye vetëm në Serbi, brenda kufijve të ish-Pashallëkut të Beogradit deri në vitin 1912, e që është provë e pozitës së privilegjuar të pronarëve serbë në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.

Analiza e mësipërme tregon se reforma e parë agrare e viteve 1918 dhe 1919 konfiskoi 1,924,307 hektarë tokë nga ish-pronarët e

tokave në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve dhe e ndau atë në 614,603, kryesisht familje serbe. Duke zbatuar metodologjinë e aplikuar, se një familje ka një mesatare prej katër anëtarësh, rezultojnë se rreth 2,450,000 anëtarë të familjes morën pronësinë dhe posedimin e tokës pa paguar asgjë për të. Nga pikëpamja historike, reforma agrare kontribuoi në kolonizimin më të madh të popullit serb në zonat përtej Drinës në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Ky ishte plan i konceptuar politikisht për zgjerimin territorial serb në kushtet e pasluftës. Viktimat më të mëdha ishin pasuesit e besimit islam, boshnjakët, shqiptarët, turqit dhe maqedonasit, sepse prej tokës totale të konfiskuar nën reformën agrare, 3/4 u konfiskua nga posedimi dhe pronësia e tyre.

Historikisht, Banja Lluca nuk është qytet serb

Përveç reformës agrare të viteve 1918 dhe 1919, e cila u konfiskoi boshnjakëve toka në bazë të ligjit diskriminues, u përdorën edhe metoda terroriste, siç ishte i famshmi “Marshi i vdekjes” në vitin 1919 kundër boshnjakëve nga “Lijeve Polje” afër Banja Llukës. Pesëdhjetë mijë boshnjakë jetonin në zonat

pjellore fushore të “Lijeve Polje”, prej të cilëve disa mijë pronarë tokash u vranë nga terroristët serbë me rastin e “Marshit të vdekjes”, dhe pjesa tjetër e popullsisë civile u dëbua nga vatrat shekullore. Një kolonë e gjatë e viktimave marshoi në këmbë drejt kampeve të përqendrimit në Kosovë dhe Sanxhak, nga ku u transferuan për në Turqi dhe u vendosën në Anadoll. Në atë kohë, boshnjakët humbën tokën e tyre në komunën e Banja Llukës në mënyrën më brutale, me gjenocid. Familjet serbe, njerëzit pa tokë dhe selanikët u vendosën në shtëpitë e tyre dhe pushtuan tokën e konfiskuar të boshnjakëve. Erdhi deri te ndryshimi i papritur në strukturën demografike dhe të pronësisë në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Si ilustrim, jepen indikatorë statistikorë se deri në vitin 1878, asnjë familje serbe nuk kishte pronësi të tokës në “Lijeve Polje” afër Banja Llukës.

Vetëm pas reformës agrare në vitet 1918 dhe 1919 bëhet intensifikimi i vendosjes dhe kolonizimit të popullsisë serbe në komunën e Banja Llukës. Sipas regjistrimit të parë të popullsisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjatë kohës së Austro-Hungarisë, në vitin 1879, sipas përkatësisë fetare në qytetin e Banja Llukës, myslimanët boshnjakë ishin shumica absolute e popullsisë prej 67,71 %; dhe nga viti 1895 deri në



vitin 1991 përqindja e tyre ishte në rënie të vazhdueshme, kurse sot ajo ka rënë në 19.35 %. Numri i kroatëve katolikë në vitin 1879 ishte 10.52 %, i cili numër rritej gradualisht dhe në vitin 1931 arriti në 29.26 %. Në këtë nivel mbeti deri në vitin 1953, kur ishte 28.34 %. Më pas, pati një rënie të ndjeshme të numrit të kroatëve në popullsinë e përgjithshme, duke ulur numrin e tyre në 10.97 % në vitin 1991. Popullsia ortodokse përfshin serbë dhe malazezë, kështu që në kohën e regjistrimit të popullsisë në vitin 1879, kishte 19.80 %. Që nga ajo kohë, pjesa e tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë është rritur, dhe në vitin 1931 ky numër arriti në 30.53 %, dhe një rritje më intensive ndodhi në vitin 1948 kur arriti në 34.78 %, ashtu që në vitin 1991 arriti në 49.3 %.

Nga treguesit e mësipërm, mund të konkludohet se Banja Luka nuk është qyteti historik serb, siç pretendoi kriminel i luftës Radovan Karaxhiq, sepse popullata serbe filloi të vendoset në atë qytet në shekullin e XIX. Rritja e madhe e popullsisë serbe ndodhi pas reformës agrare të viteve 1918 dhe 1919, kur serbët morën tokën nga boshnjakët dhe pas tërmetit katastrofik në vitin 1969, kur shumica e tyre morën punë dhe apartamente të ndërtuara rishtas. Përveç kësaj, rritja e përqindjes së popullsisë serbe në qytetin e Banja Llukës u kontribua nga korpuset e JNA/UPJ-së prej 25 mijë ushtarësh dhe 700 oficerësh, nga togerë deri te gjeneralë, të cilët ishin përgjithësisht nga Serbia e Mali i Zi.

Historia përsëritet në një mënyrë. Gjatë agresionit serb, nga viti 1992 e deri më sot, agresori serb kryen gjenocid ndaj kroatëve dhe boshnjakëve në qytetin e Banja Llukës. Sipas statistikave nga regjistrimi i popullsisë i vitit 1991, kishte dymbëdhjetë vendbanime me një shumicë etnike të pastër kroate në afërsi të Banja Llukës, por pothuajse të gjithë kroatët u dëbuan gjatë agresionit serb, kurse shpëtitë dhe toka e tyre u pushtua nga familjet

serbe. Procesi i ndryshimit të dhunshëm të strukturës demografike dhe pronësisë së tokës është kryer në mënyrë sistematike që nga themelimi i Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (MSKS), dhe zgjati për gati 80 vjet, por deri në vitin 1992 serbët nuk përbënin shumicën absolute të popullsisë në Banja Llukë.

Kompensim simbolik për tokën e rrëmbyer

Anëtar i Parlamentit - Asambleja Kombëtare e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve dr. Stjepan Radiq, në fjalimet dhe shkrimet e tij, duke i rezistuar hegjemonisë, kritikoi, ndër të tjera, mënyrën në të cilën u krye reforma agrare në vitet 1918 dhe 1919, e cila ua rrëmbeu me forcë tokën myslimanëve (nga agallar dhe bejlerë). Kjo është arsyeja pse deputeti radikal Punisha Raçiç bëri krim duke qëlluar deputetët kroatë në vendet e tyre, duke vrarë Pavle Radiqin dhe Xhuro Basariçek dhe duke plagosur Stjepan Radiqin, Ivan Pernarin dhe Ivan Grangjin, kështu që dr. Stjepan Radiq vdiq nga plagët e rënda më 6 gusht 1928.

Më vonë u vendos që myslimanëve boshnjakë t'u kompensohet për pronën e konfiskuar, kështu që shteti pranoi se kishte pasur "parregullsi" në zbatimin e reformës agrare. Ligjet u miratuan për likuidimin financiar të kompensimit për tokën e konfiskuar pas vitit 1928, me të cilat filloi të rregullohet pagesa e tokës. Toka atëherë u vlerësua me 60 % më pak se vlera reale e tregut dhe pagesa u bë me para dhe obligacione për një periudhë 50 vjeçare me katër % interes në vit. Pagesa bëhej dy herë në vit duke filluar nga viti 1923 dhe zgjaste deri në vitin 1971. Myslimanëve boshnjakë iu pagua kompensimi për tokën e konfiskuar në dy baza, për tokën e agallarëve (me marrëdhënie skllavërie) dhe tokën bejlerëve (me marrëdhënie

qiraje). Deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, ish-pronarët mblodhën 125 milionë dinarë në para të gatshme për tokën e agallarëve, ose 49 %, dhe 36 % në obligacion, që është 46.8 milionë dinarë e shprehur në terma monetarë. U mblodhën gjithsej 171 milion dinarë ose 67.4 %, dhe pjesa e mbetur e pa mbledhur 83.2 milionë dinarë ose 32.6 %. Ndryshe nga kompensimi i pronarit për tokën e agallarëve, kompensimi për tokën e rrëmbyer të bejlerëve ishte planifikuar ekskluzivisht në obligacione, me një periudhë pagese deri në 50 vjet. Nga gjithsej 650 milionë dinarë të planifikuar në 36 kështe gjashtëmujore, vetëm katër janë paguar në vlerë prej 139.5 milionë dinarë, ose më pak se 1/4, përkatësisht 21.5 %. Prandaj, 510.5 milionë dinarë, ose 78.5 %, nuk ishin paguar fare.

Nga treguesit e mësipërm, është e qartë se toka e konfiskuar kurrë nuk u ishte paguar plotësisht ish-pronarëve të tokave (agallarëve dhe bejlerëve), kështu që nuk mund të bëhej pronë e serbëve dhe as nuk mund t'u transferohej ligjërisht pasardhësve të tyre. Sipas ekspertëve ligjorë, e drejta për tokë të papaguar nuk vjetrohët kurrë dhe dokumentacioni i tokës mbi reformën agrare të zbatuar është ruajtur në arkivat e qytetit të Sarajevës dhe Vjenës.

Përktheu nga gjuba boshnjake:

Dr. Azmir Jusufi

1. Xhenana Efendiç-Semiz ishte një profesoreshë e njohur dhe e respektuar. Ajo ishte jo vetëm profesoreshë dhe shkencëtare e njohur, por edhe një humaniste e patriotë e madhe boshnjake. Një nga gratë e para boshnjake që arriti kulmin në qarqet shkencore. Lindi më 2 qershor të vitit 1934 në Trebinje (Bosnje dhe Hercegovinë). Diplomoi në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Zagrebit në vitin 1957, kurse doktoroi në vitin 1968. 2. Prof. dr. Dženana Efendiç Semiz, „Srpska agrarna reforma i kolonizacija 1918. godine“, Medunarodni znanstveni skup (JUGOISTOCNA EUROPA 1918.-1995.), Botues: Hrvatska matica iseljenika i Hrvatski informativni centar, Boton: TARGA, Zagreb, 1996. Ose lexoni në mënyrë elektronike në ueb-faqe të internetit: <http://www.bic.hr/books/jugoistocna-europasemiz.htm#srpska%20agnarna%20reforma>.

Agron M. Rexhepi, MD, PhD

Morfologjia e kokës (2)

Gjerësia e kokës

Kjo ndryshore paraqet distancën ndërmjet dy pikave më të largëta laterale të kokës. Gjerësia e kokës së njeriut është ndryshore biparietale e jo bitemporale.

Shpërndarja e meshkujve të matur në bazë të gjerësisë së kokës është e përafërt me shpërndarjen e së njëjtës populatë në bazë të gjatësisë së kokës. Nga numri i përgjithshëm i të maturve, 49.7% të entiteteve radhitën në grupin me kokë të gjerë, 31.7% në grupin me kokë të mesme, ndërsa 15.2% të entiteteve me kokë shumë të gjerë (Tabela 4).

Pjesa dërmuese e femrave të matura, 50.8% karakterizohen me kokë të mesme, ndërsa 25.9% me kokë të gjerë, dhe 19.7% me kokë të ngushtë (Tabela 4).

Në tabelën 5, janë paraqitur vlerat mesatare, minimale dhe maksimale të gjerësisë së kokës për entitetet e matura të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore. Vlera mesatare e gjerësisë së kokës tregon se në përgjithësi meshkujt e testuar kanë kokë të gjerë, (157.71 mm me variacione 116–191 mm), ndërsa femrat kokë të mesme (152.61 mm me variacione 138–168 mm).

Nga të dhënat e tabelës 6, mund të konstatojmë se entitetet e matura nga Kosova dhe nga Shqipëria e jugut bëjnë pjesë në popullatat që kanë gjerësi të kokës më të madhe.

Lartësia e kokës

Lartësia e kokës tregon distancën nga muri i sipërm i kanalit të jashtëm të veshit deri në pikën më të lartë të kokës (*vertex*). Ky parametër është i rëndësishëm në përcaktimin e indeksit cefalik vertikal (ICV) dhe të

Gjerësia e kokës	Lebzelter-Saller	Meshkujt		Femrat	
Kokë shumë e ngushtë	> 139	5	0.9%	1	0.5%
Kokë e ngushtë	140 – 147	14	2.5%	38	19.7%
Kokë e mesme	148 – 155	178	31.7%	98	50.8%
Kokë e gjerë	156 – 163	279	49.7%	50	25.9%
Kokë shumë e gjerë	164 <	85	15.2%	6	3.1%

Tabela 4. Klasifikimi në bazë të gjerësisë së kokës sipas shkallës Lebzelter-Saller

Tabela 5. Përcaktimi i kufijve minimal dhe maksimal, si dhe i vlerës mesatare të gjerësisë së kokës

Lartësia e kokës	Meshkujt	Femrat
Vlera minimale	104 mm	96 mm
Vlera maksimale	143 mm	134 mm
Vlera mesatare	121.52 mm	114.67 mm

Popujt	Meshkuj	Femra	Autorët
Kosova (shqiptarët)	157.71 mm	152.61 mm	A. Rexhepi
Shqipëria e Jugut	161 mm	-	Po Kun
Franca	158 mm	-	Po Kun
Gjermania	158 mm	-	Braig
Serbia	154.5 mm	-	Po Kun
Rumunia transilvane	158 mm	152 mm	Reiner
Bullgaria	153.78 mm	149.9 mm	M. Popov
Maqedonia	153.76 mm	149.33 mm	M. Popov

Tabela 6. Gjerësia e kokës ndër popuj të ndryshëm

Lartësia e kokës	Routil	Meshkujt		Femrat	
Shumë e ultë	< 109	29	5.2%	46	23.8%
E ultë	110 – 117	129	23.0%	79	41.0%
Mesatare e lartë	118 – 125	258	46.0%	59	30.6%
E lartë	126 – 133	115	20.5%	8	4.1%
Shumë e lartë	134 <	30	5.3%	1	0.5%

Tabela 7. Klasifikimi në bazë të lartësisë së kokës sipas shkallës Routil



indeksit cefalik transversal (ICT). Edhe pse gati të të gjitha krijesat ekziston pjesa ballore (frontale) e kokës, te njeriu kjo pjesë është shumë më e shprehur dhe ka të bëjë me zhvillimin e pjesës frontale të trurit.

Me kokë mesatarisht të lartë karakterizohen 46% të meshkujve të matur, përderisa me kokë të ultë 23% dhe të lartë 20.5%; ndërkaq te femrat kemi një shpërndarje tjetër: 41% i entiteteve të matura i takojnë grupit me kokë të ultë, 30.6% me kokë mesatare të lartë dhe 23.8% me kokë shumë të ultë (Tabela 7).

Nga të dhënat e tabelës 7 dhe 8 mund të konstatojmë se në përgjithësi, meshkujt e testuar kanë kokë mesatarisht të lartë (121.52 mm me variacione 104–143 mm), ndërsa femrat kokë të ultë (114.67 mm me variacione 96–134 mm).

Gjerësia e fytyrës

Duke u mbështetur në shpërndarjen e numrit të entiteteve në bazë të gjerësisë së fytyrës (dimensioni bizigomatik), kemi bërë klasifikimin e fytyrave sipas shkallës Lebzelter-Saller, duke paraqitur numrin e entiteteve dhe përqindjen e tyre

Tabela 8. Përcaktimi i kufijve minimal dhe maksimal, si dhe vlerës mesatare të lartësisë së kokës

Gjerësia e kokës	Meshkujt	Femrat
Vlera minimale	116 mm	138 mm
Vlera maksimale	191 mm	168 mm
Vlera mesatare	157.71 mm	152.61 mm

Gjerësia e fytyrës	Lebzelter-Saller	Meshkujt		Femrat	
		Numri	Përqindje	Numri	Përqindje
Shumë e ngushtë	< 127	93	16.6%	115	59.6%
E ngushtë	128 – 135	146	26.0%	64	33.2%
Mesatare e ngushtë	136 – 143	229	40.8%	14	7.2%
E gjerë	144 – 151	89	15.9%	0	0
Shumë e gjerë	152 <	4	0.7%	0	0

Tabela 9. Klasifikimi në bazë të gjerësisë së fytyrës

Tabela 10. Përcaktimi i kufijve minimal dhe maksimal, si dhe vlerës mesatare të gjerësisë së fytyrës

Gjerësia e fytyrës	Meshkujt	Femrat
Vlera minimale	109 mm	105 mm
Vlera maksimale	155 mm	142 mm
Vlera mesatare	135.87 mm	125.35 mm

brenda gjinisë së njëjtë (Tabela 9). Në bazë të të dhënave të tabelës 9, mund të konstatojmë se meshkujt karakterizohen me fytyrë mesatare të ngushtë (40.8%), në të ngushtë (26%) dhe tregojnë një shpërndarje normale të rezultateve por paksa me një shmangie në të majtë. Për dallim nga meshkujt femrat karakterizohen me kokë kryesisht shumë të ngushtë

shpërndarja e rezultateve tregon një shmangie të plotë në të majtë.

Vlera mesatare e gjerësisë së fytyrës e llogaritur në numrin e përgjithshëm të entiteteve tregon vlerën 135.87 për meshkuj dhe 125.35 për femra (tabela e më sipërme).

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)



Amire Prebreza – Sopjani

Shtatori i dytë

Një vit shkollor, ku shumë mësime dhe prindër u prekën nga virusi korona, e që me raste prekte edhe fëmijët. Një vit shkollor që u mbyll me shumë probleme në rezultate, me shumë kritika dhe pakënaqësi, shumë herë të pavende dhe të padrejta.

Edhe këtë vit, ashtu sikurse vitin që e lamë pas, shtatori po na gjen në një gjendje pasigurie. Vetvetiu na lind pyetja, do të fillohet apo jo?

Do të jemi në gjendje të fillojmë vitin e ri shkollor në rrethana normale, apo do të vazhdojmë me skenarët A, B dhe C.

Ndonëse më tepër se nxënësit, kjo situatë po i rëndon prindërit dhe mësime dhe, duke pasur parasysh faktin që kaluam një vit e gjysmë shkollor në një gjendje pandemie. Edhe përkundër mundit dhe përpjekjeve për të mbajtur mësim, fillimisht në platformën online për të gjitha nivelet arsimore, për më shumë se tre muaj, rezultatet nuk ishin të kënaqshme. Madje, kjo ishte edhe e pritshme, sepse jo të gjithë mund të qaseshin në mësimin online.

Janë një mori faktorësh që do ta pengonin një gjë të tillë, duke filluar nga pamundësia e kushteve, e deri te mos interesimi për pjesëmarrje. Nëse marrim parasysh gjendjen socio-ekonomike në vendin tonë, nivelin e lartë të papunësisë dhe varfërinë në vend, do të shohim se kemi fëmijë që mezi ia dalin të sigurojnë lapsat dhe fletoret e tyre, e jo më të kenë një telefon apo një laptop për të ndjekur mësimet online.



Këta fëmijë nuk janë të paktë, sepse jo vetëm fëmijët shqiptarë janë pjesë e sistemit arsimor në Kosovë, por edhe fëmijët e të gjitha komuniteteve, e në veçanti fëmijët e komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali, ku pjesa dërmuese e tyre nuk kanë pasur qasje në mësimin online.

Nëse do të merreshim me statistika se sa ka qenë numri i atyre të cilët kanë qenë të qasshëm, atëherë do të shohim se mbetet shumë për të dëshiruar. Duke u nisur nga kjo, lirisht mund të themi se mësimi online nuk i ka përmbushur as për së afërmi nevojat e nxënësve.

Duhet përsëritur munda i mësimeve, të cilët janë munduar me gjithë kapacitetet e tyre që ta kryejnë detyrën në mënyrën më të mirë. Por, edhe në anën tjetër, prindërit janë munduar që në njëfarë mënyrë ta luajnë rolin e mësuesit në shtëpitë e tyre, e që për pjesën dërmuese nuk ka qenë fare e lehtë. Ishte goxha sfiduese menaxhimi i kohës së mësimit.

Ne si prindër, por edhe mësime dhe, luteshim që kjo situatë të përmirësohet, ky virus të zhdukej dhe që viti i ri shkollor 2020/21, t'i gjente fëmijët tanë në bankat shkollore. Luteshim që procesi arsimor të fillonte në gjendje të rregullt dhe si i tillë të vazhdonte. Kishim shpresë që shtatori i vitit 2020, t'i gjente fëmijët në shkollë duke vijuar mësimin në kushte normale. Shtatori erdhi dhe situata ishte pothuajse e njëjtë.

Fëmijët nuk filluan mësimin ashtu siç e prisnin, shkollat filluan me vonesë dhe me kushte jonormale.

Një orar i shkurtuar do t'i përcillte një gjysmëvjetor të tërë, madje disa nga shkollat e përfunduan tërë vitin me nga dy orë mësim në ditë. Në shumicën e shkollave të vendit, mësimi, për një pjesë të nxënësve, përsëri do të zhvillohej online. Disa të tjerë do të vazhdonin një javë në shkollë dhe dy të tjera në shtëpi.

Prapë një vit i vështirë, me mund dhe sakrificë.

Një vit shkollor, ku shumë mësime dhe prindër u prekën nga virusi korona, e që me raste prekte edhe fëmijët. Një vit shkollor që u mbyll me shumë probleme në rezultate, me shumë kritika dhe pakënaqësi, shumë herë të pavende dhe të padrejta. Nuk duhet harruar se kjo periudhë nuk ishte e vështirë vetëm për fëmijët, nuk ishin vetëm ata që po i vuanin pasojat e këtij virusi që pamundësoi zhvillimin normal të tyre në aspektin shkollor, por ishte periudhë e vështirë për secilin nga ne, si prindër dhe si mësime dhe.

Nuk ishte e lehtë për mësuesit që të punojnë në distancë me nxënësit e tyre, e aq më tepër të bënin një vlerësim real. Në anën tjetër, as për prindërit nuk ishte e lehtë, duhej goxha mund t'i mbanin fëmijët e tyre të motivuar për mësim. Vështirësitë shtoheshin kur në familje kishte më tepër se një fëmijë që duhej t'i ndjekte mësimet, madje jo rrallëherë edhe orari mund të qëllonte në të njëjtën kohë.

Duhej mund dhe sakrificë për të arritur sadopak që fëmijët të mos mbesin prapa. Ky vit shkollor do të mbetet përherë në kujtimet e këtyre fëmijëve, për maskat e bartura gjatë gjithë kohës, për termometrin në hyrje të dyerve të shkollës, për distancën me shokë e shoqe, si dhe për pamundësinë e përqafimit të mësuesve të tyre në ditën e parë të vitit shkollor, e që vazhdoi edhe për një vit të tërë.

Do të mbetet edhe në kujtimet e prindërve dhe mësuesve puna, angazhimi dhe bashkëpunimi i ndërsjellë për të arritur rezultate. Dhe ja ku jemi, në prag të shtatorit të dytë, duke na gjetur sërish në kohë pandemie, e me shifra që rriten çdo ditë.

Prandaj, natyrshëm lind pyetja sikurse vitin e kaluar.

Intervistë me farmacisten Mr. Ph Laureta Berisha Kosumi

Dita Botërore e Farmacistëve - 25 shtator

Dita Botërore e Farmacistëve shënohet çdo vit më 25 shtator për të nderuar farmacistët për rolin që ata luajnë në përmirësimin e shëndetit global. Qëllimi i Ditës Botërore të Farmacistëve është që të inkurajojë aktivitetet që promovojnë dhe avokojnë për rolin e farmacistit në përmirësimin e shëndetit në çdo cep të botës. Tema e këtij viti, e zhvilluar nga Federata Ndërkombëtare Farmaceutike (FIP), është “Farmacia, gjithmonë e besuar për shëndetin tuaj”. Tema u zgjodh për të nxjerrë në pah rëndësinë e besimit në kujdesin shëndetësor dhe praktikën e farmacisë në mjedise të ndryshme klinike.

Sipas Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike, besimi është një pjesë qendrore e të gjitha marrëdhënieve njerëzore dhe një element themelor i kapitalit shoqëror. Besimi është gjithashtu thelbësor për kujdesin shëndetësor, ekziston një lidhje e rëndësishme ndërmjet besimit në profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe rezultateve shëndetësore për pacientët.

Farmacistët thonë se kur pacientët kanë besim më të lartë te profesionistët e kujdesit shëndetësor, ata i përgjigjen më mirë trajtimit dhe tregojnë sjellje më të dobishme mjekësore me më pak simptoma, duke çuar në një cilësi të përgjithshme më të mirë të jetës.

E nderuar, a mund ta bëni një prezantim të shkurtër për veten?

Përshëndetje, unë jam Laureta Berisha Kosumi, e lindur në Pejë, kam përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Mjekësisë- dega Farmaci në përdhën kohore 2006-2011, duke marrë titullin magjistër i Farmacisë, titull dhe profesion i cili bartë ndjeshmëri dhe përgjegjësi të lartë ndaj të gjithë qytetarëve tanë, duke ofruar shërbim të denjë e këshillues, ashtu që të gjithë ata pacientë që na qasen të ndjehen shumë të sigurt kur marrin barin nga duart tona. Jam bashkëshorte dhe nënë e tri vajzave.

Si është të ushtrosh profesionin e farmacistit në Kosovë?

Të jesh farmacist në Kosovë është mjaft sfiduese, me faktin se përfundon një fakultet aspak të lehtë dhe tejet kyç për shëndetin e qytetarëve tanë, marrë parasysh stereotipet e krijuara te populli se farmacisti është vetëm "shitës" i barit dhe qëllimi i tij është të krijojë sa më shumë të hyra në vendin e punës.

Është e vërtetë që ne jemi dora e fundit e dhënies së barit, dora e fundit e lëshimeve të paqëllimshme nga ana e mjekëve, dora e fundit e dhënies së kurajës dhe ndihmës, dora e fundit e dhënies së buzëqeshjes dhe urimit me “shërim të shpejtë”, përkundër që na quajnë “shitës”, prapëseprapë jemi krenarë që nga duart tona vjen deri te marrja e drejtë e terapisë, duke pasuar me mjekimin



Ph Laureta Berisha Kosumi

dhe shërimin e pacientëve tanë.

Sa kohë jeni duke ushtruar këtë profesion?

Profesionin e ushtrroj që 10 vjet, që nga diplomimi në vitin 2011 e gjer më sot.

Cilat janë sfidat që keni hasur dhe ato që ju presin në vazhdimësi?

Sfidë e vazhdueshme është përshkrimi i barnave me emra fabrikues (tregtarë) dhe kushtëzimi nga ana e mjekut që të merren po ato prodhime që i ka përshkruar, duke mos na lënë hapësirë që të bëjmë lehtësime në popull në marrjen e barnave paralele që janë më profitabile për pacientët, sepse shpeshherë kthehen pa marrë barnat adekuate për shkak të çmimit dhe mungesës së mjeteve materiale. Sfidë tjetër e vazhdueshme është edhe mos nivelizimi i çmimit të barnave, këso forme do të dëshmohej profesionisti i vërtetë dhe populli do kishte qasje në çmime të njëjta të barnave në çdo barnatore.

A keni raste të shumta të kërkimit të barnave pa udhëzim të mjekut, dhe si reagoni në këto raste?

Kërkesat për marrjen e barnave pa udhëzim të mjekut janë të shumta, aq më tepër për marrjen e antibiotikëve, marrja e të cilëve bartë pasoja të mëdha. Marrja e antibiotikëve pa recetë rritë mundësinë e rezistencës në trajtimin e infeksioneve që mund të jenë edhe jetike në të ardhmen. Është më se normale të kemi baktere në trupin tonë, ku shumica prej tyre janë të padëmshme, madje luajnë edhe rol kyç në ruajtjen e shëndetit të organizmit tonë. Kur merren antibiotikë, ata "vrasin" shumicën e baktereve, duke përfshirë edhe ato të dobishmet (florën normale bakteriale të organizmit), në shumicën e rasteve një numër i madh i baktereve mbijetojnë duke u bërë rezistentë dhe duke zhvilluar një infeksion të ri.

Infeksionet rezistente janë edhe shumë të kushtueshme, me kujdes të shtuar mjekësor dhe në shumicën e

rasteve duhen trajtuar në kushte spitalore. Kërkesë tjetër e shpeshtë është edhe marrja e barnave qetësuese pa recetë, të cilat mund të shkaktojnë varshmëri dhe ndërveprime me barnat tjera.

Cilat nga barnat kërkohen më së shumti në Kosovë nga shoqëria jonë pa udhëzim e që janë të dëmshme për përdoruesit?

Barnat më të shpeshta që kërkohen janë analgjetikët, antibiotikët dhe barnat qetësuese (barnat që veprojnë në sistemin nervor).

Përveç që përdorimi i tyre pa recetë bartë pasoja, janë në pyetje edhe shumë ndërveprime të tjera, që mund të ndodhin me barnat tjera që i kanë me recetë. Andaj, asnjëherë nuk duhet kërkuar barna pa përshkrimin e mjekut dhe me këmbënguljen se unë e paguaj dhe kam të drejtë ta marrë.

Sa i përket efikasitetit, a ka dallim një paracetamol ose një antibiotik në Kosovë me një paracetamol ose antibiotik në një vend tjetër të Evropës?

Barnat te ne në Kosovë janë mjaft efikase, kanë kontrolle të cilësisë pranë Agjencionit Kosovar të Barnave, madje kemi prodhues kosovarë mjaft cilësorë, ajo që na dallon nga vendet e rajonit është mos nivelizimi i çmimeve dhe diferencat e mëdha në çmime ndërmjet barnatoreve në vendin tonë.

A janë të kontrolluara barnat sa duhet në Kosovë, dhe sa janë të sigurta të përdoren?

Barnat kanë kontrolle cilësie dhe janë të sigurta për përdorim, mirëpo suplementet që hyjnë në vendin tonë (cilësohen si ushqime) dhe nuk kanë kontrolle cilësie të mjaftueshme, përshkrimi i të cilave është në masë të madhe, andaj i këshilloj popullin të marrin prodhuesin që ju konvenon në çmim, e jo të këmbëngulin vetëm në prodhimet e përshkruara nga mjeku.

A keni njohuri, a mbahen

trajtime për farmacistët e rinj?

Nuk ka mjaftueshëm trajtime për farmacistë të rinj, shpresojmë në të ardhmen të kemi organizime më të shpeshta dhe t'ju japim më shumë mundësi punësimi e krijimi të përvojës.

Cili është mesazhi që mund t'i jepni të gjithë farmacistëve dhe shoqërisë në përgjithësi?

Farmacistët janë edukues shëndetësorë të popullit, janë ata nga duart e të cilëve jepet drejt terapia, i këshilloj që të ngrenë nivelin profesional për rolin e farmacistëve në vendin tonë, të jenë ndihmues dhe këshillues të denjë, e nëse secili nga ne kontribuojmë përmes profesionit tonë në të mirë të popullit tonë, përveç që do të ndihemi të plotësuar, do të ndërrojmë edhe idenë e krijuar se kemi për qëllim vetëm shitjen e barit.

Profesionistët mjekësorë duhet të jenë vlerë morale e profesionale nga të cilët varet shëndeti i popullit, duhet të jenë mjekues të zemrave dhe largues të brengave të atyre që ua besojnë mjekimin, asnjëherë nuk duhen vendosur gjërat materiale para atyre profesionale e njerëzore, sepse kur bëhet tregti me shëndetin e pacientëve tanë të varfër e të përvojatur, nuk ka më respekt dhe besim ndër ne, e nuk ka më vend për të veshur përparësi të bardhë.

Popullin e këshilloj që t'ju besojë profesionistëve farmacistë, mos të kërkojnë barna pa recetë, sepse këso forme ruajnë shëndetin e tyre dhe largojnë mundësinë e shfaqjes së shumë ndërveprimeve dhe efekteve anësore të barnave.

Intervistoi: Mr. Muzaqete Kosumi:

<https://www.pharmaexperts.com/news/ld-pharmacists-day/>. (28.09.2021)

Elez Osmani

Në vend të lamtumirës!

Përkujtim për dr. Rexhep ef. Bojën

Para disa ditësh, së bashku me ju dr. Boja, ne vizituam në Spitalin Amerikan një shok të sëmurë. Disa ditë më vonë, ne, me ish të sëmurin dhe me Myftiun Tërnavë ju vizituam ju në të njëjtin spital ku edhe ndërruat jetë. Nuk u trishtuam. E pranua vdekjen si të natyrshme, sepse vdekja të gjen aty ku edhe e ka caktuar i Madhi Zot. Por, ti vdiqe për t'u bërë i paharrueshëm. U largove me vitet, veprat, përgjegjësit më të ndritshme dhe më të frikshme, përgjegjësinë e ndërgjegjes ndaj besimtarëve për të paralajmëruar dhe të korrigjuar, nderimin ndaj kombit dhe atdheut. U largove i bekuar. I bekuar nga e kaluara për të ardhmen, për rrethin dhe shoqërinë. Inshallah do të mëshirohesh edhe nga i Madhi Zot!

Ju kishit një mision dhe e përmbushët atë. Ishte caktim, padyshim falë vullnetit suprem, i cili manifestohet dukshëm në ligjet e fatit individual (të ardhmes) në punë dhe aktivitete, ashtu edhe në ato të realitetit objektiv. Shtatëdhjetë e pesë vjet që jetuat, përfshijnë intervalin kohor, që përkon sundimin nga dy shtete. Njërin që e luftove dhe që nuk u pajtove kurrë me të, dhe tjetrin që u përpoqe tërë jetën për të, për Kosovën e dashur. Sa jeni i gëzuar që arkivoli juaj arriti të shohë rrezet e fundit të fronit të madh të bërjes së Kosovës shtet.

Ne jemi këtu për të mbajtur një qëndrim qytetar dhe fetar. Ne jemi këtu për të pohuar progresin, për të mirëpritur mirëbërjen e filozofisë

politike, fetare, për të nderuar luftëtarët madhështorë dhe shërbëtorët e atdheut, për të nderuar përpjekjen fisnike të popullit tonë, të atyre që marshuan guximshëm përpara për ta çimentuar lirinë njerëzore, me një fjalë, për ta lavdëruar paqen, këtë vullnet sublim universal. Këtu e kanë vendin ulemaja si vazhdimësi e fjalës profetike. Paqja është virtyt hyjnor,

virtyt i civilizimit. Por te ju ishte një fuqi e brendshme, e ngulitur thellë, ishte vetëdija në shërbim të atdheut dhe mendja në shërbim të së vërtetës. Kishit një mendje të ndritur dhe një zemër të madhe.

Nuk të frikësuan kërcënimet, as persekutimet, as shpifjet e regjimit të kaluar. Ishe i palodhshëm dhe i palëkundur për të mirën e fesë dhe atdheut. Në sa e sa raste e munde



dhunën me buzëqeshje, despotizmin me sarkazmë, pagabueshmërinë me ironi, kokëfortësinë me këmbëngulje, injorancën me të vërtetën.

Por, në këtë fillim shekulli ndjehesh më i qetë, më i buzëqeshur. Dukeshë si ndriçim agimi. Ke çmuar të vërtetën, të drejtin, të mirën, të ndershmen dhe të dobishmen. Nuk të lëkundën erërat dhe fërfëllizat e reja, sepse ua njihje mirë burimin (jo real). Natyrisht se shpesh të zemëronin dhe të mërzisnin. Mbetë erudit, tradicional, popullor, pse jo edhe diplomat i shkëlqyer. Fatmirësisht në këtë ecje nuk ishit vetëm, sepse njerëzit e mëdhenj rrallëherë janë vetëm, e ju ishit i tillë, ndaj edhe ju nuk ishit vetëm. Kjo është madhështorja, sepse pemët e mëdha duken më të mëdha kur dominojnë në pyll. Kurani i ka mësuar njerëzit të jenë të arsyeshëm, arsyetimi i mirë sjell veprimin e mirë, korrektësia në mendje bëhet drejtësi në zemër. Mbi këtë parim, ju mbyllët të kaluarën dhe hapët horizonte të reja drejt të ardhmes në Bashkësinë Islame të Kosovës.

Me Ju filloi një cikël i ri në sendërtimin e BIK-ut. Ne e ndienim

se në këtë fillim shekulli, Kryesia e BIK-ut si forcë drejtuese, e kryesuar nga Ju, do ta ketë parimin islam, arsyen dhe traditën. Jo rastësisht, ju keni kryer detyrat fetare, kombëtare dhe ndërkombëtare. Kujtimet dhe vështirësitë nuk do të harrohen kurrë dhe do të lënë mbresa dhe përshtypje të qëndrueshme tek ata me të cilët ti bashkëpunove. Të gjithë ndjehen krenar që kanë pasur një person kaq të mirë dhe një mik kaq të mrekullueshëm. Por, siç thotë një autor i panjohur: “Ajo që lëvizë nëpër ne është një heshtje, një pikëllim i qetë, një dëshirë për një ditë më shumë, një fjalë më shumë, një prekje më shumë. Ne mund të mos e kuptojmë pse u larguat nga kjo tokë kaq shpejtë, ose pse u larguat para se të ishim gati për të thënë lamtumirë, por, pak nga pak, ne fillojmë të kujtojmë jo vetëm që keni vdekur, por që keni jetuar. Dhe se jeta juaj na dha kujtime shumë të bukura për të mos i harruar.”

Unë ndihem më mirë që të njoha, më mirë se të çmova, më mirë që të kam takuar dhe më mirë që kam bashkëpunuar me ty. Qofsh i mëshiruar nga Allahu në jetën tjetër, miku

im! Zoti na bashkoftë në botën tjetër, ashtu siç ishim tok në punë, mendime dhe ideale në këtë botë kalimtare! Në kuptimin tonë fetar, ne e dimë se shpirti nuk vdes, ai jeton në berzah, por do të shtoja se shpirti jeton edhe në kujtimet e atyre që e donin.

P.S.

Nuk ishte rastësisht këshilltar i ministrit të Shëndetësisë së Kosovës, koordinator zyrtar për aktivitete bamirëse dhe njerëzore në shtetet arabe, anëtar në Këshillin e Lartë Botërore për Xhamitë në Ligën e Botës Islame, dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Republikën e Kosovës, ish-kryetar i Bashkësisë Islame dhe ish-myfti i Republikës së Kosovës, ish-anëtar në Këshillin Transitor Kosovar të formuar nga OKB-ja, ish-anëtar i Kryesisë Fetare në Sarajevë, ish-anëtar në Këshillin Shura për Euro-Azi, i cili udhëhiqet nga Turqia, ish i ngarkuar me punë i Republikës së Kosovës në Riad, më 8 maj 2012 u emërove ambasador i Republikës së Kosovës në Riad dhe në fund këshilltar i zëvendës-kryeministrit etj.



Myftiu Tërnavë priti në takim ministrin e Shëndetësisë z. Arben Vitia



Më 1 shtator, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim ministrin e Shëndetësisë në Republikën Kosovës, z. Arben Vitia, ku temë diskutimi ishte parandalimi i pandemisë globale COVID-19.

Myftiu Tërnavë shprehu mbështetjen e plotë të Bashkësisë Islame të Kosovës ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë për respektimin e masave për

parandalimin e përhapjes së virusit.

Ai më tej tha se edhe ne si BIK në kuadër të marrjes së masave preventive me qëllim ruajtjen e shëndetit publik, si dhe në përputhje me masat e reja anti-covid të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kemi marrë vendim dhe kemi njoftuar imamët e të gjitha xhamive që të respektohen masat e reja të Qeverisë dhe me këtë rast kryerja e riteve fetare me xhemat në objektet fetare dhe hapësirat përreth

tyre, të bëhet në përputhje të plotë me Manualin për mbrojtje nga përhapja e COVID-19.

Në anën tjetër, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, vlerësoi lart kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në këtë kohë pandemie, por edhe bashkëpunimin e shkëlqyer me Ministrinë e Shëndetësisë dhe ka apeluar që të bëhet vaksinimi dhe mos të ketë hezitim nga popullata për marrjen e vaksinave. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim gjeneralin Jeton Dreshajn

Më 6 shtator, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim shefin e stafit në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, gjeneral brigade Jeton Dreshajn.

Myftiu Tërnavë e njohu gjeneralin me aktivitetet dhe organizimin e BIK-ut, si dhe me përpjekjet që është duke i bërë ky institucion për parandalimin e virusit Covid-19. Ai po ashtu e njohu edhe me masat e fundit të ndërmarra nga Bashkësia Islame e Kosovës për parandalim të këtij virusi.

Nga ana e tij, gjenerali Dreshaj, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për mundin e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës për luftën kundër virusit Covid-19. Ai, në emër të Forcës së



Sigurisë së Kosovës, dhuroi për Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës 5000 maska, për çka Myftiu Tërnavë e falënderoi atë dhe gjithë FSK-në për këtë ndihmë.

Të dyja palët u shprehën të gatshme që edhe në të ardhmen të shtohet edhe më tej bashkëpunimi në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve tanë. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim z. Akin



Më 9 shtator, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim këshilltarin për çështje fetare në Ambasadën e Turqisë z. Nevzat Akin. Myftiu Tërnavë fillimisht e falënderoi për vizitën duke potencuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e shkëlqyer që ka

me Dijanetin e Turqisë dhe shprehu dëshirën që edhe më tej të vazhdojë ky koordinim me qëllim që t'i kontribuojmë zhvillimit të jetës fetare e kulturore në Kosovë përmes projekteve të përbashkëta. Nga ana e tij, këshilltari Nevzat Akin falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen duke

shprehur bindjen dhe gatishmërinë që edhe më shumë të intensifikohet bashkëpunimi me

Bashkësinë Islame të Kosovës, që Kosova të jetë një oazë paqeje ku të gjithë jetojnë në siguri e harmoni. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim kryetarin e xhamisë "El Aser" z. Safet Shabanin



Më 13 shtator, kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori i Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, pritën në takim Safet Shabanin, kryetar i xhamisë "El Aser" në Igolstadt të Gjermanisë. Në këtë takim, Myftiu Tërnavë

përhëndeti dhe falënderoi te gjithë mërgimtarët për kontributin e tyre dhe shprehu gatishmërinë e tij si Myfti, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, që edhe më tutje të vazhdojë bashkëpunimi i shkëlqyer që kanë BIK dhe diaspora. Nga ana e tij, Safet

Shabani, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për diasporën në përgjithësi. Me këtë rast drejtori Simnica i dorëzoi z. Shabanit botimet e Kryesisë së BIK-ut, për qendrën e tyre. (R.S.)

Myftiu Tërnavë dërgoi letër ngushëllimi me rastin e vdekjes së dr. Rexhep ef. Bojës



Më 14 shtator, kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka dërguar një letër ngushëllimi për familjen Boja, me rastin e kalimit në Ahiret të udhëheqësit, drejtuesit, pedagogut e ambasadorit tonë të shquar, dr. Rexhep ef. Bojës. Në letrën e ngushëllimit thuhet se me këtë rast bashkëndejmë dhembjen me ju dhe njëkohësisht lusim Zotin e madhërishtëm që ish-myftiun ta marrë në mëshirën e Tij. Kalimi në Ahiret i Rexhep ef. Bojës është humbje jo vetëm për ju si familje, por edhe për të gjithë ne. Rahmetliu tërë jetën ia kushtoi ngritjes dhe avancimit të jetës fetare te ne sikur që ka dhënë një kontribut të paçmuar për shtetësimin e Kosovës. Lusim Allahun Fuqipotë që dr. Rexhep ef. Bojën ta shpërblejë me të mirat e Tij të pakufishme në Xhenet dhe shpirtin e tij ta bashkojë me shpirtat e pejgamberëve e dëshmorëve, ndërsa familjes, miqve e farefisit t'i falë durim. (R.S)

Kryesia e BIK-ut mbajti mbledhje të jashtëzakonshme me rastin e kalimit në Ahiret të ish-myftiut të Kosovës, dr. Rexhep ef. Bojës



Më 15 shtator, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme me rastin e kalimit në Ahiret të ish-kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, dr. Rexhep ef. Bojës. Mbledhja u hap me një këndim të sures Fatihë për shpirtin e rahmetliut. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë. “Kalimi në Ahiret i doktor Rexhep

efendi Bojës është caktim i Zotit, dhe s’do mend se caktimin e Zotit ne e pranojmë me bindje si të tillë dhe më të pajtohemi, porse po ashtu e pranojmë se vdekja e doktor Rexhep efendi Bojës nuk është vetëm një humbje për familjen, nuk është vetëm një humbje e kolegut për ne hoxhallarët, është më shumë se kaq, është humbje e një njeriu meritues të shoqërisë sonë. Mungesa e doktor Bojës me urtësinë e tij, me qetësinë,

mençurinë e këshillat e tij, do të lë një boshllëk të madh. Ngushëllimi më i madh në këto çaste të vështira të ndarjes mbetet fakti se ai do të vazhdojë të jetojë nëpërmjet veprës dhe trashëgimisë së tij të begatë dhe të respektit tonë për të. Rahmetliu tërë jetën ia kushtoi ngritjes dhe avancimit të jetës fetare te ne sikur që ka dhënë një kontribut të paçmuar për shtetësimin e Kosovës dhe kalimi i tij në Ahiret, na lënë ne mërzhitur e të



pikëlluar dhe duke lënë një zbrazëti e boshllëk në mesin tonë. Mirëpo, caktimit të Allahut ne i themi vetëm amin dhe atë e pranojmë me plotë besim, nënshtrim dhe durim të thellë, sepse me urdhrin dhe caktimin e Allahut besimtari duhet të pajtohet plotësisht”- tha ndër tjera, Myftiu Tërnavë. Ai më pas evokoi kujtime me të, duke shprehur se: “Me doktor Bojën kam pas

fatim që një pjesë të gjatë të jetës ta kalojmë së bashku duke qenë në forumet dhe institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës, nga ku

kam njohur, ndier e përjetuar urtësinë, vizionin, përkushtimin, përgjegjësinë dhe vendosmërinë e tij, ndaj dhe e kam të vështirë që më këtë rast të zgjedh nga të filloj të flas për kontributin e dr. Rexhep ef. Bojës për Bashkësinë Islame dhe institucionet e saj, sikundër nuk di nga t’ia nisi që të përmendi angazhimin e tij për çështjen kombëtare në përgjithësi dhe çështjen e Kosovës në veçanti. Kjo sepse kontributi i dr. Bojës është i shumanshëm dhe shumë-dimensional, ndaj dhe nuk mund të pasqyrohet, aq më pak një rast dhe në

një vend si ky ku jemi tubuar sot. Për kontributin dhe veprën e doktor Bojës do të flitet në të ardhmen, pasi që për shumicën prej nesh rruga jetësore dhe vepra e doktor Bojës është e njohur. Në fund të gjithë anëtarët e Kryesisë së BIK-ut lutën Allahun xh.sh., që dr. Rexhep ef. Bojën ta shpërblejë me të mirat e Tij të pakufishme në Xhenet dhe shpirtin e tij ta bashkojë me shpirtin e pejgamberëve e dëshmorëve, ndërsa familjes, miqve e farefisit t’i falë durim. (R.S.)

Biografi

Rexhep Boja lindi më 20 qershor 1946 në fshatin Kërrnicë të Klinës. Studimet universitare i ka kryer në Universitetin Islamik të Medinës, në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Po në Medinë i kreu edhe studimet post-diplomike - magjistroi më 1981 me temën “Shqiptarët (Arnautët) dhe Islami”, ndërsa më 1985 doktoroi me temën “Myslimanët në Jugosllavi”. Pas përfundimit të doktoratës, më 1986 është kthyer në Kosovë, ku filloi punën si imam në Pejë, e në të njëjtën kohë angazhohet edhe si pedagog në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë deri më 1990. Në 1991 zgjidhet kryetar (Myfti) i Bashkësisë Islame të Kosovës, funksion të cilin e ushtroi për tri mandate rresht deri më 2003. Rexhep Boja është ndër themeluesit e

Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, ku ka ligjruar lëndët: Fikh dhe Dave. Gjithashtu, ka qenë dekan i këtij fakulteti në periudhën 1992-2011.

Gjatë kohës sa ishte në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës ka marrë pjesë në mbi 150 konferenca, simpoziume e takime të niveleve ndërkombëtare ku ka dhënë një kontribut të çmuar. Ka kryer edhe një varg detyrash të tjera fetare e shtetërore me rëndësi, si bie fjala: këshilltar i ministrit të Shëndetësisë të Kosovës; koordinatori zyrtar për aktivitetet bamirëse dhe njerëzore në shtetet arabe; anëtar në Këshillin e Lartë Botëror për xhamitë në Ligën e Botës Islame; anëtar në Këshillin Transitor kosovar të formuar nga

OKB-ja; anëtar i Rijasetit në Sarajevë në Federatën jugosllave; anëtar në Këshillin Shura për Euroazi.

Rexhep Boja është autor i shumë studimeve në fusha të ndryshme, me të cilat është paraqitur në konferenca e simpoziume dhe i artikujve të shumtë që janë botuar në gazeta e revista vendore e ndërkombëtare në gjuhën shqipe, arabe e angleze. Gjithashtu është edhe autor i dy librave: “Shqiptarët (Arnautët) dhe Islami - Myslimanët në ish-Jugosllavi”, botim në gjuhën arabe, “Për një të nesërme më të mirë”, në gjuhën shqipe.

Rexhep Boja, nga data 2012-2018, ishte ambasador i Republikës së Kosovës në Arabinë Saudite.

Telegrame ngushëllimet me rastin e vdekjes së dr. Rexhep ef. Bojës

- *Telegram ngushëllimi nga Qendra Islame Kulturore Shqiptare në Staten Island, Nju Jork: Dr. Rexhep Boja do kujtohet përherë si shembull se si duhet atëdheu, si punohet me sakrificë për të, si duhet të përdoret energjia e besimit në të mirën e mirëqenjes së popullit shqiptar. Lusim Allahun e madhërishtëm që Dr. Rexhep Bojen ta shpërbej me të mirat e Tij të pakufishme dhe shpirtin e tij ta bashkoj me shpirtat e Pejgamberëve, Ulemave e Dëshmorëve që flijuan jetën në shërbim të fjalës së Allahut!*

Kryetari i Qendres Islame Kulturore Shqiptare
në Staten Island, Nju Jork . Hfz. Dr.
Dhulkarnejn Ramadani

- *Telegram ngushëllimi nga Qendra Islame Shqiptaro-Amerikane në Queens: Shprehim ngushëllimet tona të thella BIK-ut me hijerësinë Tuja në krye, dhe përmes jush, familjarëve të të ndjerit si dhe mbarë popullit të Kosovës dhe shqiptarisë. Gjithë neve pa përjashtim kemi humbur një profesor, teolog, intelektual, diplomat dhe mbi të gjitha një njeri të veçantë. Sa na përket neve, ne do të kujtojmë përherë me krenari dhe mallëngjim nderim që ia bëri komunitetit tonë me prezencën, fjalët, këshillat, zemërgjerësinë dhe dashamirësinë e vet me rastin e inaugurimit të qendrës sonë në vitin 2002. Për të gjitha këto dhe për shumë më tjera dr. Boja do t'i mungojë komunitetit tonë më tepër se fjalët mund ta shprehin.*

Me dhembshuri, Imamët dhe Këshilli i
Qendrës.

- *Telegram ngushëllimi nga Meshihati i Bashkësisë Islame Serbi-Sanxhak: Kryetari i Meshihatit të Bashkësisë Islame të Serbisë-Sanxhak, dr. Mevlud ef. Dudiq ka dërguar telegram ngushëllimi Kryetarit të*

Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë. Në këtë telegram përpos tjerash, Kryetari Dudiq shpreh ngushëllimet e tij në emër të myslimanëve të Sanxhakit dhe në emrin e tij personal duke lutur Allahun xh.sh., që dr. Rexhep Bojen ta shpërbej me xhenet ndërsa familjes t'i dhuroj durim.

Kryetari i Meshihatit të Bashkësisë Islame të
Serbisë-Sanxhak, dr. Mevlud ef. Dudiq

- *Telegram ngushëllimi nga Rijaseti i BFI së Maqedonisë së Veriut: Kryetari Fetai në emër të institucione të BFI të Maqedonisë së Veriut dhe në emrin e tij personal shpreh ngushëllimet tona më të përzemërta fillimisht Kryesisë së BIK-ut dhe përmes Juve familjarëve të rahmetlisë dhe të gjithë besimtarëve të Kosovës të cilëve Dr. Rexhep Boja u shërbeu gjatë gjithë jetës si Kryemufti i BIK-ut, profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, udhëheqës u respektuar fetar dhe ambasador i Republikës së Kosovës.*

Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetai

- *Bashkësia Islame në Bosnjës e Hercegovinës: Me pikëllim të thellë morëm lajmin për kalimin në ahiret të anëtarit të dalluar të Bashkësisë Islam të Kosovës, dr. Rexhep ef. Boja. Jemi të vetëdijshëm se kjo është një humbje e madhe sepse dr. Boja ishte shume aktiv në promovimin e vlerave islame dhe me sukses ushtroi shumë detyra të rëndësishme me përgjegjësi të plotë. Me shkuarjen e tij edhe ne kemi humbur një mik të mirë dhe të sinqertë. Familjes së rahmetliut dhe Bashkësisë Islame të Kosovës i shprehi ngushëllime të sinqerta. Duke lutur Allahun xh.sh. që dr. Bojen ta shpërbej me të mirat e xhenetit. Të Allahut jemi dhe tek Allahu do të kthehemi!*

Reis Ulemaja i Bashkësisë Islame në Bosnje e
Hercegovinë Husein ef. Kavazović

- *Presidenca e Republikës së Turqisë Kryesia e Çështjeve Fetare: Me keqardhje të madhe mësuam se, më datën 14 shtator 2021, ka ndërruar jetë, z. Rexhep Boja i cili ka kryer funksionin e kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, ambasadorit dhe dekanit të Fakultetit të Studimeve Islame. Me këtë rast, i lutemi Zotit që ta mëshiroj dhe falë të ndjerin Rexhep Boja që i ka shërbyer me vite Islamit dhe myslimanëve në Kosovë! Ndërsa familjes së tij të pikëlluar, anëtarëve të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe bashkatdhetarëve tanë dhe bashkëfetarëve që jetojnë në Kosovë i urojmë durim. Ju përshendes me selam.*

Kryetari i Diyanet-it të Turqisë, Prof. Dr. Ali
Erbash.

- *Komuniteti musliman Shqiptar në Zcicer: Me pikëllim të madh sot morëm lajmin e kalimit për në botën e përtejme të ish-myftiut, dekanit, ambasadorit dhe profesorit tonë të dashur, dr. Rexhep Boja. Kosova sot humbi një njeri me vlerë të mëdha fetare dhe kombëtare. Dr. Boja ishte njeri i urtë, i dashur me të gjithë, intelektual, patriot dhe udhëheqës i shkëlqyer, i cili gjithë jetën etij e vuri në shërbim të fesë dhe të atdheut. Me këte rast ngushëlloj famniljen Boja, myftiun Tërnavë, hoxhallarët, miqtë, familjarët, studentët dhe gjithë popullin e Kosovës. Allahu i Madhëruar e mëshiroftë hoxhën dhe mësuesin tonë, dr. Rexhep Bojen dhe e shpërbleftë me Xhenetin Firdeus.*

Hfz. Mehas Alija, kryetar, Komuniteti
musliman Shqiptar në Zcicer:

Varroset ish-myftiu i Kosovës dr. Rexhep ef. Boja (1946-2021)

Më 15 shtator 2021, në varrezat e fshatit Kërnice të Klinës me pjesëmarrjen e familjarëve, autoriteteve më të larta të Bashkësisë Islame të Kosovës në krye me Myftiun Naim ef. Tërnavën me bashkëpunëtorë, kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h.fz. Shaqir ef. Fetait, përfaqësuesve të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, klerit katolik, autoriteteve politike lokale dhe qendrore, miqve, hoxhallarëve e xhematlinjve dhe në respektimin e masave COVID-19 u bë varrimi i dr. Rexhep ef. Bojës. Në fjalën e tij, Myftiu Tërnavë, vlerësoi lart punën dhe kontributin fetar dhe kombëtar të dr. Rexhep ef. Bojës. Ai fillimisht citoi ajetin kuranor ku Allahu xh.sh na thotë: “Allahu është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën për t’ju provuar, se cili prej jush është më vepërmirë.” (El-Mulk, 3). Me këtë ajet kuranor, na bëhet me dije se jeta dhe vdekja janë të krijuara nga Zoti i Madhërrishëm, dhe njashtu sikurse janë të krijuara ato janë edhe të paracaktuara nga Ai, dhe po të mos ishte njëra nuk do të ekzistonte tjetra; nuk ka vdekje pa jetë dhe nuk ka amshueshmëri pa kalim në botën tjetër. Sot, jemi tubuar në këtë vend për ta përcjellë në përjetësi, në Ahiret, imamin, pedagogun, profesorin, kolegun dhe udhëheqësin tonë të shquar, ish-Myftiun e Kosovës, dr. Rexhep efendi Bojën, për të cilin, e lusim Zotin xh.sh. që ta vendos në xhenetet e Tij... Myftiu Tërnavë, duke e lutur Allahut xh.sh., që dr. Rexhep ef. Bojën ta shpërblejë me të mirat e Tij të pakufishme në Xhenet dhe shpirtin e tij ta bashkojë me shpirtat e peqamberëve e dëshmorëve, ndërsa familjes, miqve e farefisit t’ falë durim.

Një fjalë rasti mbajti edhe reisi i BFI-së së Maqedonisë së Veriut, Shaqir ef. Fetai, ku në emër të besimtarëve dhe të BFI-së së Maqedonisë së Veriut shprehu ngushëllimet familja-



rëve, myftiut Tërnavë dhe gjithë popullit të Kosovës. “Ishte një personalitet i lartë që la gjurmë të pashlyeshme

jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha trojet shqiptare, në Ballkan e më gjerë. Ne jemi të dëshmojmë para të Madhit Zot se e jetoj jetën mu ashtu siç kërkohet nga një personalitet i pastër, në shërbim të Zotit, besimit, familjes, kombit dhe vatinit, andaj lusim Zotin që ta mëshirojë dr.

Bojën”-tha reisi Fetai. Në emër të familjes të gjithë të pranishmit i përshëndeti Fitim ef. Boja duke i falënderuar për pjesëmarrjen dhe ngushëllimet me rastin e vdekjes së dr. Bojës dhe vlerësoi se ndjehemi të nderuar si familje me pjesëmarrjen tuaj. Namazit të xhenazes i priu Myftiu Naim ef. Tërnavë, ndërsa duanë e xhenazes e bëri kryetari i BFI-së së Maqedonisë së Veriut h.fz. Shaqir ef. Fetai. (R.S.)

Myftiu Tërnavë priti në takim imamin e Xhamisë Shqiptare në Londër, Bahri ef. Bojën



Më 25 shtator, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, pas namazit të xhumasë pritën në takim imamin e Xhamisë Shqiptare në Londër, Bahri ef. Bojën, njëherësh njërin prej themeluesve të kësaj Qendre. Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje në Bashkësinë Islame, dhe njëherësh shfrytëzoi nga rasti që edhe një herë t'i shprehë

ngushëllime të shoqëruara me lutje tek Zoti i Madhëruar pas kalimit në botën tjetër të dr. Rexhep ef. Bojës, njëkohësisht babai i Bahri efendiut. Në të njëjtën kohë, Myftiu Tërnavë falënderoi atë për punën dhe angazhimin e tij dhe Qendrës që përfaqëson për mirëqenien e shqiptarëve në Diasporë, veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar. Në anën tjetër, Bahri ef. Boja shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për shtrirjen edhe më të

gjerë të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të aktiviteteve me Bashkësinë Islame, respektivisht me Drejtorinë për Diasporë në kuadër të BIK-ut. Ai vlerësoi punën e deritanishme të Bashkësisë Islame, dhe potencoi se për të mirën e të gjithëve, e në veçanti të mërgatës sonë, duhet koordinim i ndërsjellë me Bashkësinë Islame në të gjitha aspektet kontribuuese, kombëtare apo fetare qofshin ato. (E.S)

Myftiu Tërnavë inspektoi dhe përcolli punimet në ndërtimin e disa xhamive

Më 25 shtator, kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga një pjesë e kabinetit të tij, inspektoi dhe përcolli punimet në ndërtimin e xhamive në disa lokacione në këshilla të ndryshme në Kosovë. Ata fillimisht inspektuam punimet në ndërtimin e xhamisë në fshatin Grackë të Komunës së Lipjanit, për të vazhduar më pas me inspektimin e punimeve në xhaminë e fshatit Davidovc të Shtimes, të cilat tashmë janë afër finalizimit. Më pas, Myftiu Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij panë parcelën tokësore të dhuruar nga Imer Lami, e cila do të shfrytëzohet për ndërtimin e xhamisë së re në fshatin Kaçanik i Vjetër. Myftiu Tërnavë falënderoi për zemërsisht Imer Lamin për këtë parcelë, duke



lutur Zotin e Madhëruar që ta shpërblejë me mirësitë e Tij të pafundme për këtë sadaka.

Krejt në fund, u vizitua edhe xhamia e lagjes Dushkajë, në Kaçanik,

e cila është në ndërtim e sipër. Edhe këtu, Myftiu Tërnavë, falënderoi edhe njëherë familjen Dema nga fshati Bob për dhurimin e parcelës për ndërtimin e kësaj xhamie.

Myftiu Tërnavë priti në takim ish-Reisul Ulema i BFI-së së Maqedonisë së Veriut, h.fz. Arif ef. Eminin



Më 27 shtator, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm i BIK-ut, Ahmet ef. Sadriu, si dhe nga drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, pritën në takim ish-Reisul Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, h.fz. Arif ef. Eminin. Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje

në Bashkësinë Islame, dhe më pas e njohu atë për punën dhe angazhimin e BIK-ut dhe e falënderoi ish-Reisul Uleman h.fz. Eminin për punën dhe angazhimin e tij dhënë për mirëqenien dhe jetës fetare të shqiptarëve në Maqedoni e Veriut dhe jo vetëm, ku vlen të përmendet se Arif ef. Emini gjatë luftës së Kosovës kishte sistemuar mbi 20 mijë refugjatë kosovarë. Ish-Reisul

Ulema i BFI-së së Maqedonisë së Veriut h.fz. Arif ef. Emini falënderoi Myftiun Tërnavë për mikpritjen dhe vlerësoi punën dhe kontributin që është duke dhënë BIK në të mirë të jetës fetare dhe mirëqenies shoqërore të vendit si dhe njëherësh i shprehu ngushëllime të shoqëruara me lutje tek Zoti i Madhëruar pas kalimit në botën tjetër të dr. Rexhep ef. Bojës. (R.S.)

Dhurohen 43 ari truall vakëf për KBI-në e Malishevës



Më 7 shtator, Këshilli i Bashkësisë Islame të Malishevës ka pranuar 43 ari truall vakëf për nevojat e këtij Këshilli. Kjo traditë e mirë e lënies së tokës vakëf për nevojat e Bashkësisë Islame është vazhduar edhe nga vëllezërit Berisha, të cilët dhuruan 36 ari truall, si dhe nga Milazim Hamëz

Hoti, i cili dhuroi 7 ari truall. Me këtë rast, kryetari i KBI-së së Malishevës Sead ef. Paçarizi me bashkëpunëtorë kanë falënderuar vakëflënësit, duke lutur Allahun xh.sh. që ky hajrat të pranohet si sadaka e rrjedhshme (sadakatul xharije) për katër vëllezërit dhe familjen e tyre. Shembujt e

personave që po lënë tokën vakëf dita-ditës janë duke u shtuar, për çka Bashkësia Islame është tejet mirënjohëse dhe falënderuese. Lusim Allahun e Madhëruar që vëllezërit Berisha dhe gjithë bamirësit t'i shpërblejë me mirësitë e Tij të pafundme! (B.Z)

Drejtori Simnica priti në takim z. Afrim Berishën

Më 8 shtator, drejtori i Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim kryetarin e Qendrës Kulturore “Shtëpia e Paqes” të Zvicrës, z. Afrim Berishën. Drejtori Simnica falënderoi z. Berishën dhe nëpërmes tij tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-ut dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje. Në këtë takim gjithashtu u bisedua rreth shtimit të koordinimit me këtë qendër, por edhe me qendrat e tjera në Zvicër.



Në shenjë mirënjohje për kontributin e kësaj Qendre dhënë për kurbanë dhe për sadakatul-fitër, drejtori

Simnica ndau një mirënjohje për z. Afrim Berishën dhe për Qendrën “Shtëpia e Paqes”. (R.S.)

Telegram ngushëllimi për tragjedinë në Tetovë

Prishtinë, 09/09/2021

Me dhimbje e pikëllim mora lajmin për tragjedinë e mbrëmshme në spitalin e modular për Covid-19 në Tetovë, ku nga shpërthimi i zjarrit pësuan tragjikisht dhe humbën jetën pacientë e personel mjekësor.

Në këto momente të vështira për vëllezërit tanë në Tetovë, shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjarët e viktimave, për të cilët lusim Zotin që t’ju japë durim në përballimin e dhimbjeve për humbjen e më të dashurve të tyre. Me këtë rast, Bashkësia Islame e Kosovës me të gjitha institucionet e saj, bashkëndejmë dhembje dhe mërzë, e në këto momente të vështira jemi pranë familjeve të viktimave. Zoti i mëshiroftë shpirtrat e atyre që pësuan në këtë tragjedi! Zoti i shëroftë sa më shpejtë të lënduarit, dhe dhashë Zoti që të mos ketë më tepër viktima!

*Me dhembshuri,
Myftiu i Kosovës
Naim ef. Tërnavë*



Mbahet Konferenca shkencore “Një shekull nga botimi i përkthimit të Kuranit prej Ilo Mitkë Qafëzezit



Më 21 shtator, organizuar nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame (IHSI), që vepron në kuadër të BIK-ut, u mbajt Konferenca shkencore me titull: “Një shekull nga botimi i përkthimit të Kuranit prej Ilo Mitkë Qafëzezit.” Në këtë Konferencë morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Bujar ef. Spahiu, Reisi i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, h.fz. Shaqir ef. Fetahu, studiues, akademik, hulumtues e dashamirës të shkencës nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut.

Në emër të Këshillit organizativ të Konferencës, foli Vedat ef. Sahti, i cili tha se kjo Konferencë po mbahet në shënimin e 100 vjetorit të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga rilindësi ynë i shquar Ilo Mitkë Qafëzezit, ku përmes kësaj Konference nga IHSI-ja, si asnjëherë deri tani, ri sjell për studiuesit e fushave të ndryshme nismën e parë serioze për përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe.

Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri Bajgora, theksoi se në kuadër të objektivave dhe punës së IHSI-së, bënë pjesë edhe organizimi i konferencave të këtilla shkencore siç është kjo Konferencë e sotme “Një

shekull nga botimi i përkthimit të Kuranit nga Ilo Mitkë Qafëzezi”. Ç’është e drejta, kjo Konferencë, do të synojë që ta trajtojë sa më gjithanshëm aspekte të ndryshme të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi. “Gjithsesi 100 vjet të nismës dhe botimit të parë të Kuranit në gjuhën shqipe është një ngjarje që meriton të shënohet e të analizohet me qëllimin e përbashkët që të ofrohen përgjigje sa më të qëndrueshme lidhur me këtë nismë dhe me këtë botim të parë të Kuranit në gjuhën shqipe. Popujt e qytetëruar kanë ecur përpara në saje të vëmendjes që kanë treguar për të kaluarën e tyre dhe mirënjohjes për kontributin e pararendësve të tyre. Duke dashur që fjalën për çështjet që lidhen me përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitkë Qafëzezi, t’ua le studiuesve kompetentë pjesëmarrës në këtë Konferencë, më lejoni që edhe një herë t’ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe po ashtu t’ju ftojë të gjithëve që t’i dilni krahu punës dhe mbarëvajtjes shkencore të Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame” - tha Bajgora. Kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mbajti një fjalë përshëndetëse, ku pos të tjerash tha se ky aktivitet i kushtohet një përvjetori të rëndësishëm për kulturën dhe historinë tonë. “Me këtë rast, falënderoj Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame, që kanë

ndërmarr këtë hap për të shënuar 100 vjetorin e daljes në dritë të përkthimit të pjeshëm të Kuranit nga rilindësi ynë i shquar Ilo Mitkë Qafëzezi, në formën më të mirë, duke organizuar Konferencë shkencore kushtuar kësaj veprë. Vepra e Qafëzezit, e botuar dhe realizuar në një kohë delikate e plot kthesa për popullin tonë, një veprë e realizuar nga një bashkëkombës yni ortodoks për vëllezërit e tij myslimanë, për çudi as në të kaluarën e as sot, nuk ka marrë vëmendjen e merituar të studiuesve që merren me historinë e literaturës shqipe. Ai përmendi se ndonëse një veprë e tillë në fushën e përkthimeve të Kuranit në gjuhën shqipe tashmë është tejkaluar, ajo pa diskutim mbetet një ndër veprat më të rëndësishme për kohën kur është botuar dhe për qëllimin që ka mbartur si vazhdimësi e frymës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, andaj mbetet detyrë e studiuesve tanë që këtë veprë ta trajtojnë shkencërisht dhe me kompetencë.

Fjalë përshëndetëse mbajtën edhe kryetari i KMSH-së, Bujar ef. Spahiu, si dhe reisi i BFI-së në RMV, h.fz. Shaqir ef. Fetahi.

“Përkthimi i Kuranit është një nevojë e myslimanëve në mbarë botën. Nisur nga kjo, edhe në gjuhën shqipe kemi përpjekje në këtë drejtim. Për shqiptarët, si edhe për popujt e tjerë, që nuk e

kanë arabishten gjuhë të folur, ishte një nevojë urgjente përkthimi i

Kuranit në gjuhët e veta amtare. Megjithatë në mënyrë të pjesshme, shikojmë një interesim të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ilo Mitko Qafëzezi, një shqiptar i krishterë ortodoks nga Korça. Ai në vitin 1921 bëri përkthimin e parë dhe të pjesshëm të Kuranit në gjuhën shqipe, duke iu referuar përkthimit të Kuranit nga George Sale, në gjuhën angleze. Megjithatë, është fakt se edhe para këtij përkthimi të Ilo Mitko Qafëzezi, në vitin 1894, pjesë dhe sure nga Kurani, i përktheu edhe shkrimtari i famshëm shqiptar Naim Frashëri me titull: "Thelb i Kuranit", botuar në librin e tij "Mësime", në Bukuresht – tha ndër tjera, kryetari i KMSH-së, Bujar ef. Spahiu.

Në fjalën e tij përshëndetëse, reisi i BFI-së, Shaqir ef. Fetaj, tha se: "Përkthimi i Kuranit famëlartë para plot 100 vjetësh, është një gjurmë e madhe faktografike për interesimin e shqiptarëve për t'ju ofruar sa më afër kuptimin e Fjalës së Zotit dhe domethënies e tij, për të ngritur vetëdijen e tij në kohë dhe hapësirë. Andaj, ky përkthim i Kuranit famëlartë nga I. M. Qafëzezi, hapi edhe më tepër dyert e përkthimit dhe kuptimit të fjalës kuranore dhe mbeti

inspirim i gjallë për të ardhmen drejt përkthimeve që vijuan më pastaj nga Hafiz Ali Korça, Hafzi Ibrahim Dalliu, akademik Fetiu Mehdiu, H. Sherif ef. Ahmeti, H. Hasan ef. Nahi dhe shumë të tjerë."

Më pas, Konferenca vazhdoi punimet, ku referuesit pasqyruan me studimet e tyre këtë ngjarje historike dhe fetare të kombit shqiptar.

Seanca e parë u kryesua nga Feti Mehdiu, Qazim Qazimi, Hysen Matoshi, ndërsa me kumtesa u paraqitën: Ramadan Shkodra: "Përkthimi i Kuranit nga Qafëzezi-akt i rëndësishëm për literaturën shqipe", Sadik Mehmeti: "Ilo Mitko Qafëzezi – përkthyesini (histori e identitet)", Zeqirja Ibrahim: "Përkthimi i Kuranit të I. M. Qafëzezi – ngjarje e rëndësishme e kulturës dhe e filologjisë shqiptare", Selim Sylejmani: "Ilo Mitko Qafëzezi -përkthyes i parë i Kuranit në shqip", Ziber Lata: "Vonimi i përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe", Azmir Jusufi: "Përkthimi i parë i Kuranit në gjuhën shqipe dhe në gjuhët sllave" dhe Muhamed Mustafi: "Përkthimi i përkthimit". Ndërsa seanca e dytë u kryesua nga Rahim Ombashi, Islam Hasani, Ziber Lata. Referuesit: Sabri

Bajgora: "Leksiku islam në përkthimin e Qafëzezi". Qazim Qazimi: "Gjuha e përkthimit të Kuranit nga Ilo M. Qafëzezi". Abdurrahim Maxhuni: "Një vështrim gjuhësor përkthimit të Kuranit nga I.M. Qafëzezi". Rahim Ombashi: "Sprova shekullore nga I. M. Qafëzezi si qasje kulturore në ngjizjen e ndërgjegjes kombëtare". Isa Memishi: "George Sale dhe Ilo Mitko Qafëzezi: Përkthimi i Kuranit në kontekstin historik". Elez Osmani: "Ndikimi i përkthimit të George Sales në përkthimin e Ilo Mitko Qafëzezi". Seanca e tretë u kryesua nga Isa Memishi, Elez Osmani Sadik Mehmeti. Referuesit: Feti Mehdiu: "Kurani (Këndimi) i Ilo Mitko Qafëzezi në burime të shkruara". Hysen Matoshi: "Ilo Mitko Qafëzezi-Rilindës". Islam Hasani: "Ajetet që trajtojnë çështje ekonomike në përkthimin e Qafëzezi". Fahrush Rexhepi: "Veprimtaria krijuese dhe botuese e Ilo Mitko Qafëzezi". Besnik Jaha: "Diskursi retorik dhe diskursi letrar në përkthimin e Kuranit të Ilo M. Qafëzezi". Bashkim Mehani: "Aspekte teknike dhe estetike në botimin e përkthimit të Kuranit prej I. M. Qafëzezi" (R.S.)

Koordinatorët e shoqatës "Bereqeti" morën pjesë në seminarin e organizuar në Konja të Turqisë

Nga data 11 deri më 17 shtator, me organizim të Shoqatës Humanitare Bamirëse "Bereqeti", koordinatorët e kësaj shoqate morën pjesë në një seminar në Konja të Turqisë.

Këta kanë filluar këtë seminar me vizitën në Shoqatën "IHH", në të cilën u mirëpritën nga kryetari i kësaj shoqate z. Hasan Hysejn.

Më pas, këta vazhduan vizitën në shoqatën "İki Doğu iki batı - Dy Lindje dhe dy Perëndime", në të cilën u mirëpritën nga z. Murat Arslan, kryetar i kësaj shoqate.

Në fund, të këtij seminari, ata vizituan shoqatën "Dost Eli", në të cilën u mirëpritën nga kryetari i kësaj shoqate z. Mehmet Seçer.

Gjatë këtij seminari, koordinatorët



u njohën me punët dhe aktivitetet që zhvillojnë këto shoqata. Ata shkëmbyen përvojat e tyre dhe u dakorduan që në të ardhmen të

vazhdojnë bashkëpunimin e tyre.

Pas Konjës, koordinatorët e "Bereqetit" vazhduan vizitën dhe trajnimet në Stamboll.

Çu prej gafleti oj zemër

Çu prej gafleti,
oj zemër, çu mos ba isjan
Meno xhevapin që n'divan t'Hakkut ki
me dhanë
Çu prej gafleti, oj zemër, çeli sytë e
mrendise
Shiqajet mos ba, po diji shyyqyr Perenisë
Çu prej gafleti, oj zemër, këqyr me sy
t'bukunisë
Hamd çoji Hakkut tan, që t'përkryne
t'ka jaratise
Çu prej gafleti, oj zemër, prej derteve
mos loto
Çoji durhtë drejt madhnisë t'Tij, e pa
nal banë dua
Çu prej gafleti oj₃-Vahide, mos
t'mungon ziqri n'gubën
tane, e tovbe pa nal ba
Jo veç ditën po edhe natën, thuej me
tanë xhanin tan, ja
Hakk Elhamdulilah

Ja Resulullah

Ja Resulullah,
për ty muhtaç jem na
Ja Habibullah, për ty zemra mall ka
Jem ymet i joti, ja Resulullah
Jem ashik t'tu, ja Habibullah
Jeton n'zemrat tona, ja Resulullah
Dua bajmë që n'Xhenet me t'pa, ja
Habibullah
Me kanë kojshi me ty, o, nur i dy
rrokullive
Ti që je shembulli ma i mirë i t'tana
mirësive
Ti që je zani e fryma e Hakkut
Ti që je udhërrëfyesi ma i mirë i t'riut
e plakut
Ti që je ma i pastër se fleta e bardhë
Ti që kurrë nuk des, n'zemra tona je i
gjallë
Ti që mjaltë e ke ba edhe pelimin
Ti që t'dashtun e ke ba edhe
përmallimin
Ti që edhe mallin e ke zbukuru
Se zemrat na gjallnohen salavate tuj
t'çu
Na fal neve, ja Resulullah, se lajik
udhës tane nashta s'ju
kem ba
Na fal neve, ja Habibullah, se pasqyrë
e bukur për
muminin nashta s'jena ba
Na i ba kabull salavatet, ja Resulullah
Që me zemër ashiku, ty, t'i çojna na...

Me pas sabrin e pishës

Me pas sabrin e pishës
Që katër stinëve ju banë ballë
A thu, hallin qysh e kishim pas?
A thu, udha ku na kish dalë?
Me pas sabrin e pishës
E me duru si ajo n'borë e n'shi
A thu, nefsin qysh e kishim pas?
A kishim me dal galib
n'fund t'udhës na ndaj tij
Me pas sabrin e pishës
Acarit edhe dillit fort me i qëndru
A thu, n'cilat makame nrri kishim
A thu, n'fund, udha neve na kish gzu
Me pas kanë si pisha e fortë
N'sabër, ashk e imtihan
A thu n'abiret
Afër kujt kishim me kanë